



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 24 qershor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar

Prokurori i Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Simon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtësit të Jakup

Krasniqit

Venkateswari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(2), 23(1), 35(2)(f) dhe 39(1) dhe (11) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe të rregullës 80(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit (përkatësisht “z. Thaçi”, “z. Selimi”, z. Krasniqi dhe “z. Veseli”, ose bashkërisht “të akuzuarit”).²

2. Më 3 dhjetor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti parashtrime lidhur me informacionin konfidencial dhe kontaktet me dëshmitarët (“Parashtrimet e ZPS-së”).³

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik i saj u dorëzua më 30 Nëntor 2020, F00026/RED. Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar me parashtrimin F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020, publike; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më Pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Një version i korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, ZPS-ja paraqiti një version konfidencial, të korrigjuar, me edhe më pak redaktime të Aktakuzës së Konfirmuar, F00647/A01. Aktakuza e Ndryshuar e konfirmuar u dorëzua më 29 prill 2022 (“Aktakuza e Konfirmuar”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidenciale (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05).

³ KSC-BC-2020-06, F00594, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë*, 3 dhjetor 2021, publik.

3. Më 10 dhjetor 2021, Mbrojtësi i Viktimave iu përgjigj parashtrimeve të ZPS-së (“Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave”).⁴
4. Më 15 dhjetor 2021, ekipet e Mbrojtjes të të akuzuarve (përkatësisht “Mbrojtja e Thaçit”, “Mbrojtja e Selimit”, “Mbrojtja e Krasniqit” dhe “Mbrojtja e Veselit”, bashkërisht “Mbrojtja”) iu përgjigjën parashtrimeve të ZPS-së (përkatësisht “Përgjigjja e Thaçit”, “Përgjigjja e Selimit”, “Përgjigjja e Krasniqit” dhe “Përgjigjja e Veselit”, bashkërisht “Përgjigjet e Mbrojtjes”).⁵
5. Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja dorëzoi, si shtojcë të Dosjes Paraprake, listën e dëshmitarëve të saj (“Lista e Dëshmitarëve të ZPS-së”).⁶
6. Më 21 janar 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Administratoren të dorëzonte parashtrime në lidhje me aspekte që buronin nga Parashtrimet e ZPS-së, Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave dhe/ose nga Përgjigjet e Mbrojtjes (“Urdhri i 21 Janarit 2022”).⁷
7. Më 3 shkurt 2022, Zyra Administrative dorëzoi parashtrimet në pajtim me Urdhrin e 21 Janarit 2022 (“Parashtrimet e Zyrës Administrative”).⁸

⁴ KSC-BC-2020-06, F00605, Mbrojtësi i Viktimave, *Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë*, 10 dhjetor 2021, publike.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00625, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë*, 15 dhjetor 2021, publike; F00626, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë*, 15 dhjetor 2021, publike; F00627, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë*, 15 dhjetor 2021, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 17 dhjetor 2021, F00627/RED); F00628, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë*, 15 dhjetor 2021, publike.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00631RED/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Versionit të Redaktuar Publik të Parashtrimet të Dosjes Paraprake, me Listat e Dëshmitarëve dhe të Proovave*, KSC-BC-2020-06/F00631 të datës 17 dhjetor 2021, 17 dhjetor 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 21 Dhjetor 2021 dhe u korrigjua më 23 maj 2022, F00631RED/A02/COR/CONF/RED).

⁷ KSC-BC-2020-06, F00650, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër drejtuar Administratores për Parashtrime*, 21 janar 2022, publik, para. 5-7.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00679, Administratorja, *Parashtrime të Administratores mbi Protokollin e Propozuar për Interoistat me Dëshmitarë*, 3 shkurt 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 shkurt 2022, F00679/RED).

8. Më 14 shkurt 2022, Mbrojtësi i Viktimave ("Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave"),⁹ ZPS-ja ("Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së"),¹⁰ dhe Mbrojtja ("Përgjigjja e Mëtejshme e Selimit", "Përgjigjja e Mëtejshme e Thaçit", "Përgjigjja e Mëtejshme e Veselit" dhe "Përgjigjja e Mëtejshme e Krasniqit")¹¹ iu përgjigjën Parashtrimeve të Zyrës Administrative në pajtim me Urdhrin e 21 Janarit 2022 (bashkërisht "Përgjigjja e Mëtejshme").

9. Më 15 shkurt 2022, Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj Përgjigjes së Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave ("Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj Mbrojtësit të Viktimave").¹²

10. Më 16 shkurt 2022, në vijim të kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit¹³ së cilës iu bashkuan dhe ekipet e tjera të Mbrojtjes,¹⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi

⁹ KSC-BC-2020-06, F00690, Mbrojtësi i Viktimave, *Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave lidhur me Kornizën e ZPS-së për Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë gjatë Hetimeve*, 14 shkurt 2022, publike.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00693, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë lidhur me Parashtrimet e Administratores mbi Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë*, 14 shkurt 2022, publike.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00691, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë*, 14 shkurt 2022, publike; F00692, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë*, 14 shkurt 2022, publike; F00694, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë*, 14 shkurt 2022, publike; F00695, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë*, 14 shkurt 2022, publike. Më 17 shkurt 2022, Mbrojtja e Krasniqit kërkoi nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të riklasifikonte përgjigjen e Krasniqit si publike, *shih* KSC-BC-2020-06, F00701, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Riklasifikimin e Parashtrimin KSC-BC-2020-06/F00695*, 17 shkurt 2022, publike ("Kërkesa e Mbrojtjes së Krasniqit për Riklasifikim").

¹² KSC-BC-2020-06, F00697, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave lidhur me Kornizën e ZPS-së për Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë gjatë Hetimeve*, 15 Shkurt 2022, publik, para. 1, 16, 18.

¹³ Përgjigjja e Thaçit, para. 4, 42, 43; KSC-BC-2020-06, Transkripti, 4 shkurt 2022, publik, f. 861, rreshtat 7-15; Përgjigjja e Mëtejshme e Thaçit, para. 1, 12-15.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 4 shkurt 2022, publik, f. 862, rreshtat 23-24, f. 863, rreshtat 15-21, f. 864, rreshtat 2-3; Përgjigjja e Mëtejshme e Veselit, para. 16-17.

datën për mbajtjen e një seance për diskutimin e aspekteve që buronin nga Parashtrimet e ZPS-së (“Vendimi i 16 Shkurtit 2022”).¹⁵

11. Më 21 shkurt 2022, Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj Përgjigjes së Mëtejshme të ZPS-së (“Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së”).¹⁶

12. Më 22 shkurt 2022, u zhvillua seanca e lartpërmendur (“seanca e 22 shkurtit 2022”).¹⁷

13. Më 21 mars 2022, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi parashtrime plotësuese lidhur me Parashtrimet e ZPS-së (“Parashtrimet Plotësuese të Thaçit”).¹⁸ ZPS-ja u përgjigj më 28 mars 2022 (“Përgjigjja e ZPS-së ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit”).¹⁹ Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj më 1 prill 2022 (“Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit”).²⁰

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00698, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Mbajtjen e një Seance*, 16 shkurt 2022, publik. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu urdhëroi: (i) Administratoren t'i riklasifikonte Përgjigjen e Mëtejshme të Selimit dhe Përgjigjen e Mëtejshme të ZPS-së si publike; dhe (ii) Administratoren dhe Mbrojtjen e Krasniqit që të dorëzonin versione të redaktuara publike përkatësisht të Parashtrimeve të Zyrës Administrative dhe të Përgjigjes së Mëtejshme të Krasniqit, ose të njoftonin se këto parashtrime mund të riklasifikoheshin si publike. Në vijim, Administratorja dorëzoi, sikurse u përmend, versionin e redaktuar publik të Parashtrimeve të Zyrës Administrative dhe, pas Kërkesës së Mbrojtjes për Riklasifikim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Administratoren ta riklasifikonte Përgjigjen e Mëtejshme të Krasniqit si publike.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00705, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Parashtrimet e Administratores mbi Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë*, 21 shkurt 2022, publike.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 22 shkurt 2022, publik (“Transkripti i 22 shkurtit 2022”), f. 956-1062.

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00741, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime Plotësuese të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Kornizën e Propozuar të ZPS-së për Kontaktet me Dëshmitarë*, 21 mars 2022, publike.

¹⁹ KSC-BC-2020-06, F00754, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Kornizën e Propozuar të ZPS-së për Kontaktet me Dëshmitarë*, 28 mars 2022, publike.

²⁰ KSC-BC-2020-06, F00758, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit në Mbështetje të Parashtrimeve Plotësuese lidhur me Kornizën e Propozuar të ZPS-së për Kontaktet me Dëshmitarë*, 1 prill 2022, publike.

II. PARASHTRIME

A. PARASHTRIMET E ZPS-SË

14. Duke mbajtur parasysh nenet 21(4), 23, 35, 38, dhe 39(1) të Ligjit, rregullat 80 dhe 95(2) të Rregullores, dhe nenet 6, 12, 14, dhe 17 të Kodit të Etikës Profesionale ("Kodi i Etikës"),²¹ ZPS-ja propozon një kornizë për: (i) kontaktimin e dëshmitarëve; dhe (ii) trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve ("korniza e propozuar").²² Sipas ZPS-së, rregulla 80(1) e Rregullores i jep Gjykatësit të Procedurës Paraprake kompetencë të urdhërojë masat e duhura për mbrojtjen e dëshmitarëve, me kusht që ato të jenë në pajtim me të drejtat e të akuzuarve, si dhe rregulla mbi përdorimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontaktet e palës kundërshtare me dëshmitarët.²³

15. Në lidhje me informacionin konfidencial, ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të urdhërojë masat e mëposhtme ose masa të barasvlershme me to:

- a. Palët dhe pjesëmarrësit kanë detyrimin e përgjithshëm që të mos nxjerrin informacion konfidencial për palë të treta.
- b. Pala ose pjesëmarrësi mund të nxjerrë identitetin e dëshmitarit për një palë të tretë vetëm nëse nxjerrja është drejtpërdrejt dhe posaçërisht e domosdoshme për përgatitjen dhe paraqitjen e provave të veta. Në qoftë ka dijeni se një dëshmitar është zhvendosur me ndihmën e DHSK/ZPS-së, pala ose pjesëmarrësi e informon paraprakisht Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") për të dhënat e vendit, kohës dhe, aq sa është e mundshme, për llojet e organizatave, institucioneve dhe, nëse janë të disponueshme, të dhënat e personit (personave) të cilit (të cilëve) synon t'ua bëjë të njohur identitetin e dëshmitarit, si dhe konsultohet me ZMMD-në lidhur me masat konkrete që mund të jenë të nevojshme. Nëse dëshmitari është i mbrojtur nga ZMMD-ja, pala ose pjesëmarrësi e informon ZMMD-në për nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit sa më shpejt që është e mundshme, por gjithsesi, përpara se të bëhet nxjerrja.

²¹ Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-07-Rev1, 28 prill 2021.

²² Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 3, 7.

²³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 4.

- c. Pavarësisht nga nënparagrafi i mësipërm, palët dhe pjesëmarrësit nuk u zbulojnë palëve të treta përfshirjen e një dëshmitari të mbrojtur në veprimtarinë e DHSK-së [Dhomave të Specializuara të Kosovës]/ZPS-së, apo llojin e përfshirjes.
- d. Materiali pamor dhe/ose pa tekst që përshkruan ose identifikon dëshmitarët, i tregohet palës së tretë vetëm kur nuk ka asnjë mundësi hetimore alternative të përshtatshme. Për të zvogëluar rrezikun e zbulimit të përfshirjes në veprimtarinë e DHSK/ZPS-së të personit të treguar ose pasqyruar, pala ose pjesëmarrësi përdor vetëm materialet pamore dhe/ose pa tekst që nuk përmbajnë elemente që mund të zbulojnë përfshirjen e personit të përshkruar në veprimtarinë e DHSK/ZPS-së. Kur përdoret fotografia e një dëshmitari, ajo tregohet vetëm bashkë me fotografi të tjera të njëjtit lloj. Pala e tretë nuk mban kopje të materialit pamor në kuadër të kësaj dispozite, përveç nëse kjo autorizohet posaçërisht nga Dhoma.
- e. Në qoftë nuk është e sigurt nëse një veprimtari hetimore e propozuar mund të çojë në nxjerrjen e identitetit të një dëshmitari të mbrojtur për palë të treta, pala ose pjesëmarrësi kërkon këshillën e ZMMD-së.
- f. Pala ose pjesëmarrësi sjell në vëmendje të ZMMD-së sa më shpejt që të jetë e mundur çdo dyshim të arsyeshëm se një dëshmitar i mbrojtur mund të jetë i rrezikuar për çfarëdo arsye, përfshirë dyshimin e arsyeshëm se angazhimi i një dëshmitari me DHSK/ZPS-në ose vendndodhja e mbrojtur e tij u janë bërë të njohura palëve të treta.
- g. Në qoftë se ka nxjerrë gabimisht informacion konfidencial ose ka marrë dijeni për ndonjë shkelje tjetër të konfidencialitetit të dokumenteve apo informacionit, apo nëse zbulon se një palë e tretë është në dijeni të informacionit konfidencial, pala ose pjesëmarrësi informon marrësin për natyrën konfidenciale të informacionit dhe e udhëzon të mos e nxjerrë më tej atë. Gjithashtu, pala ose pjesëmarrësi informon menjëherë ZMMD-në.

16. Gjithashtu, ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të urdhërojë masat e mëposhtme në lidhje me kontaktimin e dëshmitarëve të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë – të cilat përputhen në përgjithësi me ato të miratuara nga Trupi Gjykues II në çështjen gjyqësore Gucati dhe Haradinaj (“Urdhri në Çështjen Gucati dhe Haradinaj”) dhe janë të nevojshme për të shmangur ritraumatizimin e viktimave-dëshmitarë dhe për të mbrojtur privatësinë, dinjitetin dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike të tyre.²⁴

²⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

- a. Përveç sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim, palët dhe pjesëmarrësit nuk kontaktojnë apo intervistojnë dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësit tjetër para dhënies së dëshmisë, në qoftë se palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë u është njoftuar synimi për të thirrur dëshmitarin për të dhënë dëshmi ose për t'u mbështetur në deklaratën e tij, apo kur ky synim është ndryshe krejt i qartë.
- b. Në qoftë se dëshiron të intervistojë një dëshmitar të palës apo të pjesëmarrësit tjetër, pala ose pjesëmarrësi kundërshtar informon palën thirrëse dhe Njësinë e Administrimit të Gjykatës ("NJAGJ") së paku dhjetë ditë përpara intervistës së synuar. Pala thirrëse verifikon me ndershmëri nëse dëshmitari jep pëlqimin të intervistohet nga pala kundërshtare dhe e informon dëshmitarin për mundësinë e pranisë në intervistë të përfaqësuesit të palës thirrëse, përfaqësuesit ligjor të dëshmitarit dhe/ose përfaqësuesit të ZMMD-së. Pala thirrëse e informon palën kundërshtare dhe NJAGJ-në nëse dëshmitari e jep pëlqimin. Gjithashtu, në rast se beson se siguria e dëshmitarit mund të jetë të rrezikuar, ose për arsye të tjera legjitime, pala thirrëse mund t'i kërkojë panelit ta lejojë të jetë e pranishme në takimet mes palës kundërshtare dhe dëshmitarit, pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit. Procedura e kësaj pjese nuk zbatohet për intervistat e kryera nga ZPS-ja me dëshmitarë të palës kundërshtare lidhur me çështje të tjera gjyqësore, përveçse kur ZPS-ja planifikon që në ato intervista të bëjë pyetje që janë relevante për akuzat në këtë çështje gjyqësore.
- c. Nëse pala ose pjesëmarrësi kontakton dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësit kundërshtar në mënyrë të paqëllimshme apo gjatë takimeve të kortezisë të organizuara prej ZMMD-së, ajo nuk e diskuton me të çështjen gjyqësore dhe nuk kërkon në asnjë rrethanë pëlqimin e dëshmitarit për t'u intervistuar drejtpërdrejt. Marrja e pëlqimit të dëshmitarit për t'u intervistuar mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurës së përcaktuar në nënparagrafin e mësipërm.
- d. Pala kundërshtare që kryen intervistën ("pala intervistuese"):
 - i. siguron që intervista të kryhet në mënyrë efektive dhe të shpejtë;
 - ii. përgatit kopje të të gjitha dokumenteve që do t'i tregohen dëshmitarit në një gjuhë që dëshmitari e kupton, së bashku me përkthimin në anglishte që do t'i jepet palës thirrëse;
 - iii. nuk bisedon me dëshmitarin jashtë kuadrit të intervistës dhe të incizimit me video, në mënyrë që të gjitha deklaratat dhe çdo gjë që thuhet të evidentohen si duhet;
 - iv. nuk ndërmerr asnjë veprim që mund të konsiderohet kërcënues apo provokues; dhe
 - v. respekton urdhrat e lëshuar nga paneli.

- e. Zyra Administrative, nëpërmjet NJAGJ-së, mundëson përgatitjen dhe kryerjen e intervistave sipas kësaj pjese. Komunikimet midis palës thirrëse apo palës intervistuese dhe NJAGJ-së bëhen përmes adresës elektronike CMUCourtOfficers@scp-ks.org. Këto komunikime protokollohen si korrespondencë në dosjen e çështjes gjyqësore, në përputhje me Udhëzuesin e Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (DHSK-BD-15).
- f. Pasi dëshmitari ka pranuar të intervistohet, pala thirrëse i jep NJAGJ-së informacionin e mëposhtëm:
- i. datat e preferuara për intervistën dhe kohëzgjatjen e parashikuar të saj;
 - ii. nëse në lidhje me dëshmitarin janë urdhëruar, kërkuar apo do të kërkoen masa mbrojtëse në bazë të rregullës 80 dhe nëse dëshmitari ka nevoja të veçanta sipas përcaktimeve në rregullën 146, ose për të kërkoen masa të posaçme, të renditura në rregullën 80(4)(c);
 - iii. formularin e përditësuar të informacionit mbi dëshmitarin;
 - iv. gjuhën që dëshmitari pritet të përdorë gjatë intervistës;
 - v. informacion lidhur me personat që pritet të jenë të pranishëm në intervistë, si edhe informacion nëse për dëshmitarin mund të nevojitet prania e një përfaqësuesi të palës thirrëse, një përfaqësuesi të ZMMD-së, apo e një përfaqësuesi ligjor; dhe
 - vi. çfarëdo informacioni tjetër që mund të ndihmojë përgatitjen e intervistës, që kërkoet nga NJAGJ-ja apo ZMMD-ja.
- g. NJAGJ-ja mund të kërkojë informacion shtesë, nëse nevojitet për mundësimin e përgatitjes së intervistës. Paneli vendos në lidhje me çdo mosmarrëveshje të pazgjidhur midis palëve dhe ZMMD-së apo NJAGJ-së, në lidhje me masat e rekomanduara nga palët dhe/ose nga ZMMD/NJAGJ-ja.
- h. Zyra Administrative mundëson kryerjen e procesit nëpërmjet:
- i. ofrimit të vendit për kryerjen e intervistës dhe të pajisjeve për incizimin me audio dhe video;
 - ii. ofrimit të përkthimit, kur nevojitet;
 - iii. sigurimit që gjatë intervistës të jetë i pranishëm një sekretar i gjykatës apo një përfaqësues tjetër i caktuar i Zyrës Administrative; dhe
 - iv. sigurimit të pranisë në vendin ku do të kryhet intervista të një përfaqësuesi për mbështetjen e dëshmitarit, në rastet kur ZMMD-ja e gjykon të nevojshme.
- i. Para fillimit të intervistës, sekretari i gjykatës ose një përfaqësues tjetër i caktuar i Zyrës Administrative e informon dëshmitarin se:

- i. nuk e ka të detyrueshme pjesëmarrjen në intervistë dhe se mund të vendosë ta ndërpresë intervistën në çdo moment;
 - ii. mund të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve, veçanërisht nëse mendohet se mund të jenë vetinkriminuese;
 - iii. mund të kërkojë pushim në çdo moment; dhe
 - iv. mund të kërkojë takim me një përfaqësues të ZMMD-së në çdo moment gjatë intervistës.
- j. Gjatë intervistës, sekretari i gjykatës apo një përfaqësues tjetër i caktuar i Zyrës Administrative:
- i. siguron që janë të pranishëm vetëm personat e autorizuar;
 - ii. verifikon identitetin e dëshmitarit;
 - iii. siguron që të gjithë personat e pranishëm të prezantohen për incizimin;
 - iv. siguron që intervista të incizohet me audio dhe video;
 - v. garanton sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarit; dhe
 - vi. siguron që elementët proceduralë të intervistës të kryhen në përputhje me Ligjin, Rregulloren dhe çdo urdhër, vendim konstatim apo rekomandim vijues të panelit.
- k. Sekretari i gjykatës mund t'i japë fund intervistës në qoftë se konsideron se pala intervistuese nuk ka përmbushur detyrimet sipas këtij urdhri. Zyra Administrative e informon menjëherë panelin për rrethanat që çuan në përfundimin e intervistës.
- l. Palët respektojnë asnjëherë e Zyrës Administrative dhe nuk i kërkojnë përfaqësuesit të saj të përfshihet në procedurë. Nëse dëshmitari do të ketë nevojë të këshillohet me një përfaqësues ligjor gjatë intervistës, intervista pezullohet për ta mundësuar këtë. Zyra Administrative informon Zyrën e Mbrojtjes, me qëllim që të merren të gjitha masat e nevojshme për t'i caktuar dëshmitarit një mbrojtës.
- m. Nëse pala intervistuese synon t'i tregojë dëshmitarit dokumente konfidenciale apo rreptësisht konfidenciale, me përjashtim të deklaratave të vetë dëshmitarit, ajo i paraqet kërkesë panelit.
- n. Pas përfundimit të intervistës, Zyra Administrative përgatit:
- i) një memorandum mbi procesin (ku të shënohet koha, vendi, personat e pranishëm, klasifikimi – d.m.th., publik, konfidencial, ose rreptësisht konfidencial – dhe çdo rrethanë tjetër relevante), të cilin ua dorëzon palëve dhe panelit; dhe
 - ii) incizimin me audio dhe video të intervistës, kopje të të cilit ua dorëzon palëve dhe panelit.
- o. As incizimi i intervistës dhe as materialet e përdorura gjatë intervistës nuk bëhen pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore, përveç nëse

paneli i pranon si prova *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, kur përmbushen kushtet për pranimin e tyre sipas Rregullores. Kur bëhet kërkesë për pranimin si provë të incizimit me video, NJAGJ-ja dorëzon gjithashtu edhe transkriptin e intervistës.

B. PËRGJIGJJA E MBROJTËSIT TË VIKTIMAVE

17. Mbrojtësi i Viktimave pajtohet me kornizën e propozuar, me përjashtim të paragrafit 6(a) të Parashtrimeve të ZPS-së.²⁵ Mbrojtësi i Viktimave parashtron se, për të përfaqësuar në mënyrë të njëmendtë dhe efektive interesat dhe të drejtat e viktimave pjesëmarrëse në proces, është thelbësore që komunikimi midis viktimave dhe ekipit të Mbrojtësit të Viktimave të jetë konfidencial, i papenguar dhe i pakushtëzuar.²⁶ Mbi këtë bazë, Mbrojtësi i Viktimave propozon këtë ndryshim (me shkronja të pjerrëta) në poshtëshënimin 17 të Parashtrimeve të ZPS-së: “Në kuadër të këtij paragrafi, kjo përfshin mbrojtësit, klientët e tyre, dhe ekipet e tyre sipas përcaktimeve të në nenit 2 të Kodit të Etikës, por nuk përfshin kontaktet midis ekipit të Mbrojtësit të Viktimave dhe dëshmitarëve me status të dyfishtë”.²⁷

C. PËRGJIGJET E MBROJTJES

1. Përgjigjja e Thaçit

18. Mbrojtja e Thaçit kërkon që korniza e propozuar të hidhet poshtë.²⁸

19. Sa i takon terminologjisë, Mbrojtja e Thaçit parashtron se me termin dëshmitar duhet të përkufizohet vetëm personi të cilin pala ose pjesëmarrësi synon ta thërrasë, apo në deklaratën e të cilit pala ose pjesëmarrësi synon të mbështetet, në rast se synimi i palës ose pjesëmarrësit për të thirrur dëshmitarin apo për të përdorur deklaratën e tij i është komunikuar qartë palës kundërshtare,

²⁵ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 2, 7.

²⁶ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 8.

²⁷ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 9, 11.

²⁸ Përgjigjja e Thaçit, para. 2, 43.

dhe se duhet bërë dallim midis termave “*dokument konfidencial*” dhe “*informacion konfidencial*” (theksimet në origjinal).²⁹

20. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, ZPS-ja po kërkon masa mbrojtëse në bazë të rregullës 80 të Rregullores, ndonëse afati për ta bërë këtë ka kaluar.³⁰ Ajo shton se në kundërshtim me këtë rregull, masat e propozuara në lidhje me kontaktet me dëshmitarët e palës kundërshtare janë të papajtueshme me të drejtat e të akuzuarve, të cilave duhet t’u jepet përparësi kryesore.³¹

21. Mbrojtja e Thaçit parashtron së pari se kërkesat sistematike që intervista të incizohet me video dhe mundësia që ZPS-ja të jetë e pranishme gjatë intervistës së dëshmitarit cenon të drejtën e të akuzuarit për barazi dhe më përgjithësisht parimin e barazisë së palëve.³² Mbrojtja e Thaçit pretendon se, sikurse është konstatuar nga Tribunali Penal për Ish-Jugosllavinë (“TPNJ”), dëshmitarët nuk i përkasin ZPS-së.³³ Ajo shton se të akuzuarit nuk iu dha e drejta të ishte i pranishëm gjatë intervistave të ZPS-së dhe se, duke përpiluar një listë tepër të zgjeruar me mbi 300 dëshmitarë, ZPS-ja është në gjendje që dëshmitarët e mundshëm të Mbrojtjes t’i klasifikojë si dëshmitarë të mundshëm të ZPS-së, me qëllim që të sigurojë praninë e saj gjatë intervistave të Mbrojtjes me dëshmitarë shfajësues.³⁴

22. Së dyti, Mbrojtja e Thaçit parashtron se, sipas rregullës 111(1) dhe (2) të Rregullores, marrja në pyetje e dëshmitarëve nga Mbrojtja para gjykimit është e privilegjuar dhe nuk është objekt i nxjerrjes së materialeve, dhe se rregullat 104 dhe 106 të Rregullores nuk kërkojnë nga Mbrojtja që të mbajë shënime apo të incizojë intervistat e dëshmitarëve dhe as që të nxjerrë produktet e punës së saj – përveç nëse synon t’i paraqesë si prova materiale gjatë gjykimit.³⁵ Ajo është e

²⁹ Përgjigjja e Thaçit, para. 10-11.

³⁰ Përgjigjja e Thaçit, para. 13, 24.

³¹ Përgjigjja e Thaçit, para. 13-14.

³² Përgjigjja e Thaçit, para. 2, 3, 16, 17.

³³ Përgjigjja e Thaçit, para. 12, 17.

³⁴ Përgjigjja e Thaçit, para. 17.

³⁵ Përgjigjja e Thaçit, para. 2, 18-20.

mendimit se mosmbrojtja e konfidencialitetit të hetimeve të Mbrojtjes është shkelje e rëndë e të drejtave të të akuzuarit sipas nenit 21(4)(h) (e drejta për të mos dëshmuar kundër vetes), ose (c) (e drejta për të përgatitur mbrojtjen e vet) të Ligjit.³⁶ Në qoftë se të akuzuarit i kërkohet që ZPS-ja të jetë e pranishme në intervistat e tij me dëshmitarët e ZPS-së dhe t'i incizojë ato, dhe ekziston rreziku që pyetjet shitesë të rezultojnë në dëshmi të tjera fajësuese kundër të akuzuarit ose në linja të reja hetimi, atëherë i akuzuari do të vihet në pozitën që, ose të heqë dorë nga e drejta për të përgatitur në mënyrë të plotë mbrojtjen e tij, ose të ndër marrë rrezikun të bëjë pyetje që çojnë në krijimin e më shumë provave vetinkriminuese të cilat mund të përdoren nga ZPS-ja.³⁷

23. Së treti, Mbrojtja e Thaçit parashtron se ZPS-ja tani po kërkon masa mbrojtëse për të gjithë dëshmitarët, pa pasur asnjë bazë ligjore për këtë miratim kaq të gjerë masash mbrojtëse.³⁸ Sipas saj, kjo është për arsye se: (i) ZPS-ja nuk citon jurisprudencë nga ndonjë gjykatë tjetër;³⁹ (ii) Urdhri në Çështjen Gucati dhe Haradinaj nuk mund të zbatohet *mutatis mutandis* në çështjen gjyqësore aktuale, sepse ajo çështje ka të bëjë me vepra kundër administrimit të drejtësisë që pretendohet se të akuzuarit i kryen para një viti, dhe me pretendime për shkeljen e urdhrave për mbrojtjen e dëshmitarëve;⁴⁰ (iii) Urdhri në Çështjen Gucati dhe Haradinaj u lëshua *proprio motu* nga Trupi Gjykses II pesë ditë pas caktimit të tij për gjykimin e asaj çështjeje, pa u mbështetur në ndonjë bazë ligjore konkrete apo precedent dhe pa ndonjë debat paraprak midis palëve;⁴¹ (iv) Trupi Gjykses I në çështjen DHSK-BC-2020-05 nuk e gjykoi të nevojshme të jepte udhëzime konkrete në lidhje me kontaktet dhe intervistat me dëshmitarët e pretenduar të palës

³⁶ Përgjigja e Thaçit, para. 21-22.

³⁷ Përgjigja e Thaçit, para. 21.

³⁸ Përgjigja e Thaçit, para. 25.

³⁹ Përgjigja e Thaçit, para. 25.

⁴⁰ Përgjigja e Thaçit, para. 26.

⁴¹ Përgjigja e Thaçit, para. 27.

kundërshtare;⁴² (v) TPNJ-ja dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën (“TPNR”) nuk kanë nxjerrë ndonjëherë rregulla të rrepta lidhur me kontaktet dhe intervistat me dëshmitarët e pretenduar të palës kundërshtare; madje edhe Protokoli i Gjykatës Penale Ndërkombëtare mbi Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar (“GJPN” dhe “Protokoli i GJPN-së”)⁴³ nuk përmban ndonjë dispozitë sipas të cilës intervistimi i një dëshmitari të ZPS-së nga Mbrojtja duhet të organizohet dhe incizohet me video nga sekretari i gjykatës në praninë e tij,⁴⁴ dhe (vi) ndonëse për disa viktimadëshmitarë mund të kërkohet trajtim i veçantë, ZPS-ja nuk shpjegon se përse është e nevojshme korniza e propozuar në rastin e figurave të njohura publike.⁴⁵

24. Së katërti, Mbrojtja e Thaçit argumenton se – në shkelje të së drejtës për të pasur kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për përgatitje për gjykim – korniza e ZPS-së do të pengonte seriozisht përgatitjet e Mbrojtjes, sepse ekipi i Mbrojtjes dhe dëshmitarët e tij janë të shpërndarë nëpër botë dhe dëshmitarët nuk ka gjasa të udhëtojnë për në Hagë.⁴⁶ Mbrojtja e Thaçit shton se kushtet e sugjeruara nga ZPS-ja për intervistat janë edhe më të rrepta se sa ato që zbatohen për paraqitjen e dëshmitarëve në gjykatë dhe se çdo dëshmitar i intervistuar në ato rrethana do të vihej nën një trysni të jashtëzakonshme, gjë që ia bën praktikisht të pamundur Mbrojtjes t’i intervistojë dëshmitarët pa shpenzime tejet të mëdha në kohë dhe burime.⁴⁷

25. Së fundi, Mbrojtja e Thaçit kundërshton fuqimisht kërkesën e ZPS-së se “në rast se beson se siguria e dëshmitarit mund të jetë të rrezikuar, ose për arsye të tjera legjitime, pala thirrëse mund t’i kërkojë panelit ta lejojë të jetë e pranishme

⁴² Përgjigjja e Thaçit, para. 28.

⁴³ ICC, Chambers Practice Manual, Fifth Edition, 25 March 2022, Annex.

⁴⁴ Përgjigjja e Thaçit, para. 28, 34.

⁴⁵ Përgjigjja e Thaçit, para. 29-31.

⁴⁶ Përgjigjja e Thaçit, para. 32.

⁴⁷ Përgjigjja e Thaçit, para. 33.

në takimet mes palës kundërshtare dhe dëshmitarit, pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit”, sepse Protokolli i GJPN-së nuk përmban ndonjë dispozitë të ngjashme dhe ZPS-ja nuk ka fituar të drejtën t’i japë vetes kompetencën të përcaktojë se çfarë është mirë për dëshmitarët.⁴⁸

26. Sa i takon trajtimit të informacionit konfidencial, Mbrojtja e Thaçit parashtron se korniza e propozuar është e panevojshme, sepse mbrojtësit dhe anëtarët e ekipeve të tyre janë profesionistë që kanë detyrimin të zbatojnë kode të etikës dhe/ose kanë nënshkruar marrëveshje të tjera konfidencialiteti me Dhomat e Specializuara (“DHS” ose “DHSK”).⁴⁹ Mbrojtja e Thaçit argumenton se, në rast se Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton kornizën e propozuar, ndalimi i përgjithshëm i përdorimit të 22 000 dokumenteve të nxjerra nga ZPS-ja do të kufizonte në mënyrë të papërligjur hetimet e Mbrojtjes dhe do të ishte në kundërshtim me qëllimin e rregullave 102(3) dhe 103 të Rregullores.⁵⁰ Mbrojtja e Thaçit propozon që në vend të saj të miratohet dispozita gjegjëse nga Protokolli i GJPN-së.⁵¹ Mbrojtja e Thaçit parashtron gjithashtu se kufizimet ndaj nxjerrjes së identitetit të një dëshmitari për një palë të tretë nuk duhet të jenë aq të rrepta sa ta bëjnë nxjerrjen praktikisht të pamundur dhe nuk duhet të zbatohen në rastin e figurave ndërkombëtare dhe dëshmitarëve për të cilët nuk janë miratuar masa mbrojtëse.⁵²

2. Përgjigjja e Selimit

27. Mbrojtja e Selimit i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të hedhë poshtë kornizën e propozuar ose, si alternativë, t’i zbatojë dispozitat e propozuara

⁴⁸ Përgjigjja e Thaçit, para. 35.

⁴⁹ Përgjigjja e Thaçit, para. 36.

⁵⁰ Përgjigjja e Thaçit, para. 39.

⁵¹ Përgjigjja e Thaçit, para. 40.

⁵² Përgjigjja e Thaçit, para. 41.

vetëm për dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së për të cilët ZPS-ja ka vërtetuar se janë të rrezikuar dhe të cilët i kërkojnë specifikisht ato masa.⁵³

28. Mbrojtja e Selimit parashtron se në pajtim me nenin 40(2) të Ligjit, rregullën 80 të Rregullores dhe jurisprudencën e TPNJ-së, duhet t'u jepet përparësi garancive të gjyqimit të drejtë, dhe se masat që cenojnë ato garanci duhet të rrëzohen ose, më së paku, duhet të modifikohen me kujdes.⁵⁴ Mbrojtja e Selimit shton se korniza e propozuar i drejtohet pothuaj tërësisht, në mos krejt tërësisht, Mbrojtjes dhe se ajo do të ketë ndikim negativ joproporcional mbi të drejtën e z. Selimi për gjykim të drejtë, sepse: (i) ZPS-ja për shumë vite ka kryer hetime pa përfshirjen e Mbrojtjes dhe ka pasur lirinë për t'i nxjerrë informacionet siç e ka gjykuar të përshtatshme; (ii) parimi i barazisë së palëve kërkon që secilës palë t'i jepet mundësi e arsyeshme të paraqesë provat e veta në kushte që nuk e vënë atë në disavantazh të konsiderueshëm krahasuar me kundërshtarin; (iii) detyrimi i vërtetimit i takon vetëm ZPS-së dhe Mbrojtja nuk është e detyruar të thërrasë dëshmitarë apo të paraqesë prova; dhe (iv) koha për kryerjen e hetimeve nga Mbrojtja është mjaft e shkurtër dhe çdo hap i panevojshëm burokratik që i vendoset Mbrojtjes në kryerjen e hetimeve cenon të drejtën e të akuzuarit për të pasur kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.⁵⁵

29. Mbrojtja e Selimit parashtron më tej se ZPS-ja nuk ka evidentuar se cilët prej dëshmitarëve të saj, përveç atyre për të cilët tashmë janë miratuar masa mbrojtëse, janë të rrezikuar; se përse masat e propozuara janë të domosdoshme për secilin dëshmitar në listën e saj; dhe se cilat rreziqe konkrete për secilin dëshmitar synojnë të zvogëlojnë ato masa.⁵⁶ Bazuar në këtë, ajo është e mendimit se korniza e propozuar është një masë e palejueshme gjithëpërfshirëse së cilës i mungon konkretësia dhe që nuk i përmbush kushtet e rregullës 80 të Rregullores dhe se

⁵³ Përgjigjja e Selimit, para. 2-5, 50-52.

⁵⁴ Përgjigjja e Selimit, para. 6-9.

⁵⁵ Përgjigjja e Selimit, para. 10-16.

⁵⁶ Përgjigjja e Selimit, para. 17-18.

duhet hedhur poshtë për vetën natyrën që ka.⁵⁷ Mbrojtja e Selimit është gjithashtu e mendimit se Urdhri në Çështjen Gucati dhe Haradinaj nuk ka fuqi ligjore detyruese; ai u miratua rreth tri javë përpara fillimit të gjykimit në një çështje gjyqësore që nuk i afrohet nivelit të kompleksitetit apo shtrirjes së çështjes aktuale dhe kishte të bënte me pretendime specifike për pengim të procesit, frikësim, dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës në lidhje me dëshmitarë që i kanë dhënë informacion ZPS-së.⁵⁸ Mbrojtja e Selimit kundërshton gjithashtu përkufizimin e zgjeruar të ZPS-së të termit “dëshmitar”, ku përfshin personat “që pala ose pjesëmarrësi synon t’i thërrasë për të dëshmuar apo në deklaratat e të cilëve pala ose pjesëmarrësi synon të mbështetet, për sa kohë që synimi i palës ose pjesëmarrësit është i njohur ose i qartë për palën kundërshtare”, mbi bazën se palës tjetër ose i jepet, ose nuk i jepet njoftim për dëshmitarin.⁵⁹

30. Gjithashtu, Mbrojtja e Selimit pretendon se ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë argument që sugjeron se Kodi i Etikës është i mangët dhe duhet të plotësohet apo përfordhet me anë të një urdhri të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.⁶⁰ Rrjedhimisht, ajo mendon se, duke qenë se korniza e propozuar trajtohet në Kodin e Etikës, ajo duhet të hidhet poshtë si e panevojshme.⁶¹

31. Mbrojtja e Selimit kundërshton gjithashtu dispozitat vijuese të kornizës së propozuar ose, si alternativë, kërkon modifikim të konsiderueshëm të tyre, me qëllim që të mbrohen të drejtat e të akuzuarve.

32. Së pari, Mbrojtja e Selimit parashtron se përfshirja e palës thirrëse në procesin e intervistimit duhet të zbatohet vetëm në lidhje me sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarëve që përballen me rrezik objektivisht të arsyetueshëm: (i) asnjë dispozitë në Ligj dhe Rregullore nuk trajton aspektin nëse një palë në një çështje

⁵⁷ Përgjigjja e Selimit, para. 18-21.

⁵⁸ Përgjigjja e Selimit, para. 22-23.

⁵⁹ Përgjigjja e Selimit, para. 24-25.

⁶⁰ Përgjigjja e Selimit, para. 27.

⁶¹ Përgjigjja e Selimit, para. 27-33.

gjqësore mund të intervistojë dëshmitarët që synon të thërrasë apo në deklaratat e të cilëve synon të mbështetet pala tjetër, përpara paraqitjes së tyre në gjykatë;⁶² (ii) përfshirja e palës thirrëse në kërkimin e pëlqimit të dëshmitarit që do të intervistohet është e tepruar, ngre shqetësimin e ushtrimit të trysnisë së palejueshme, dhe [pëlqimi] mund të kërkohet nga ZMMD-ja;⁶³ (iii) intervistimi i dëshmitarit në prani të ZPS-së, sidomos në rastet kur ajo kërkon t'i jepet e drejta të anashkalojë parapëlqimin e shprehur prej dëshmitarit, mund të shkelë të drejtën e përgatitjes së një mbrojtjeje të efektshme, sepse intervista mund të zbulojë, ndër të tjera, hollësi të linjave dhe/ose strategjisë së hetimit, të pyetjeve që mund t'i bëhen dëshmitarit në gjykim nga pala jothirrëse, dhe/ose të personave që nuk janë në listën e dëshmitarëve të palës thirrëse të cilët me gjasë mund të japin dëshmi shfajësuese/në dobi të palës intervistuese;⁶⁴ dhe (iv) dispozitat lidhur me kontaktet e paqëllimshme me dëshmitarët e palës apo pjesëmarrësit kundërshtar duhet të zbatohen vetëm në lidhje me dëshmitarët e rrezikuar.⁶⁵

33. Së dyti, Mbrojtja e Selimit parashtron se Zyra Administrative duhet të përfshihet në procesin e intervistimit vetëm kur përfshirja është rreptësisht e domosdoshme, sepse Mbrojtja duhet të ketë lirinë t'i organizojë dhe kryejë hetimet pa pasur frikën e ngecjes në një proces të ngarkuar burokratik, që pa dyshim do të shkaktonte vonesa të mëdha dhe rrjedhimisht do të ishte në shkelje të parimit të barazisë së palëve.⁶⁶

34. Së treti, Mbrojtja e Selimit pretendon se propozimi që çdo intervistë të incizohet me audio dhe video nga Zyra Administrative dhe mundësia që të gjitha incizimet të përfshihen në prova nga paneli ose nga ZPS-ja, vetvetiu cenon të drejtat e të akuzuarit sepse kjo masë nuk ka kurrfarë lidhje me mbrojtjen e

⁶² Përgjigjja e Selimit, para. 35-37.

⁶³ Përgjigjja e Selimit, para. 38-39.

⁶⁴ Përgjigjja e Selimit, para. 40-42.

⁶⁵ Përgjigjja e Selimit, para. 43.

⁶⁶ Përgjigjja e Selimit, para. 45-46.

dëshmitarëve, por, edhe nëse do të kishte, ndikimi dëmtues i saj tek i akuzuari do të kërkonte përjashtimin e saj nga çdo kornizë për kryerjen e hetimeve.⁶⁷ Ajo shton se mundësia që incizimet me audio dhe video të përdoren si material provues faktikisht do ta detyronte Mbrojtjen të thërriste dëshmitarë në emër të të akuzuarit, kur nuk është e detyruar ta bëjë këtë.⁶⁸

3. Përgjigjja e Krasniqit

35. Mbrojtja e Krasniqit i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të hedhë poshtë kornizën e propozuar ose t'i ftojë palët dhe pjesëmarrësit të angazhohen në diskutime *inter partes* në përpjekje për të hartuar një protokoll të përbashkët.⁶⁹

36. Sipas Mbrojtjes së Krasniqit, korniza e propozuar është e parakohshme sepse: (i) ZPS-ja nuk ka bërë asnjë përpjekje të angazhohet për të filluar diskutimet *inter partes* me Mbrojtjen lidhur hartimin e një protokollit mbi mosnxjerrjen e materialit, megjithëse ndërkohë ka pasur zhvillime relevante; (ii) qasja e ZPS-së faktikisht i lë Mbrojtjes më pak se dy javë që të shqyrtojë dhe vlerësojë kornizën e propozuar, të kryejë hulumtimet e nevojshme dhe diskutimet e brendshme të katër ekipeve të Mbrojtjes, dhe të përpiqet të arrijë marrëveshje për një protokoll që trajton çështje të rëndësishme; (iii) ZPS-ja nuk ka paraqitur ndonjë arsye apo qëllim se përse duhet një sistem i ri për trajtimin e informacionit konfidencial apo përse është e nevojshme të ndryshohet sistemi ekzistues në këtë fazë të procesit; dhe (iv) ZPS-ja nuk paraqet asnjë bazë ligjore për kornizën e propozuar, por mbështetet vetëm në dispozita të përgjithshme lidhur me sigurinë dhe dinjitetin, mirëqenien fizike dhe psikologjike dhe privatësinë e dëshmitarëve, dhe Mbrojtja nuk sheh të ketë ndonjë bazë ligjore për këtë në Rregullore.⁷⁰

⁶⁷ Përgjigjja e Selimit, para. 48.

⁶⁸ Përgjigjja e Selimit, para. 49.

⁶⁹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 2-3, 24.

⁷⁰ Përgjigjja e Krasniqit, para. 4-7.

37. Mbrojtja e Krasniqit argumenton më tej se korniza e propozuar është e panevojshme, duke pasur parasysh se: (i) Mbrojtja, ashtu si ZPS-ja, duhet t'u përmbahet detyrimeve të rrepta profesionale për ruajtjen e konfidencialitetit që burojnë nga Kodi i Etikës; (ii) trupi gjykues të cilit do t'i kalojë dosja e çështjes gjyqësore do të lëshojë në kohën e duhur urdhrin për zhvillimin e gjykimit, sikurse veprohet në gjykata dhe tribunalë të tjerë; (iii) korniza e propozuar nuk ka bazë faktike dhe ligjore dhe ZPS-ja nuk ofron hollësi për të sqaruar sistemet e propozuara; (iv) mbështetja e ZPS-së në praktikën e ndjekur në çështjen Gucati dhe Haradinaj, dhe në ato të GJPN-së, TPNJ-së, TPNR-së dhe të Tribunalit Special për Libanin ("TSL") është qartësisht e pamjaftueshme, duke pasur parasysh parimin se dëshmitarët nuk janë pronë as e ZPS-së dhe as e Mbrojtjes, si dhe faktin që numri i dëshmitarëve në dispozicion të Mbrojtjes është i vogël; (v) Urdhri në Çështjen Gucati dhe Haradinaj nuk mund të zbatohet në këtë çështje, sepse protokollet duhet të hartohen dhe t'u përshtaten rrethanave konkrete të secilës çështje gjyqësore në kohën e duhur; dhe (vi) nuk ka asnjë justifikim për t'i vendosur kufizime aftësisë së Mbrojtjes për kontaktimin e dëshmitarëve që nuk kanë shqetësime objektive të arsyetueshme për sigurinë e tyre, siç janë dëshmitarët ndërkombëtarë.⁷¹

38. Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit, parashtron se shumë dispozita të propozuara nga ZPS-ja përmbajnë kushte tejet të rënda dhe do të cenojnë konsiderueshëm të drejtën e z. Krasniqi për gjykim të drejtë, përfshirë të drejtën ligjore për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, për arsye se: (i) ZPS-ja nuk shpjegon se përse e ka bërë materialin pamor dhe/ose pa tekst objekt të një sistemi nxjerrjeje të kaq të ngarkuar, kur i gjithë informacioni konfidencial duhet të jetë objekt i mbrojtjes së rreptë; (ii) kur është në terren, Mbrojtja nuk mund të kërkojë tërë kohën këshillën e ZMMD-së dhe të presë përgjigjen e saj nëse identiteti i një dëshmitari të mbrojtur mund t'i nxirret një pale të tretë ose jo; (iii) mundësia që ZPS-ja të kërkojë të jetë e

⁷¹Përgjigjja e Krasniqit, para. 9-14.

pranishme në takimin midis një dëshmitari dhe Mbrojtjes në kundërshtim me parapëlqimin e dëshmitarit dhe nevoja që pala intervistuese të kërkojë leje për të treguar dokumente (rreptësisht) konfidenciale, do të vonojnë procesin dhe hetimet e Mbrojtjes dhe ZPS-ja nuk shpjegon përse nxjerrja e të dhënave konfidenciale dhe rreptësisht konfidenciale duhet të trajtohet në këtë mënyrë; (iv) në kornizën e propozuar nuk përshkruhen qëllimi dhe objekti i synuar i saj dhe nuk janë përdorur përkufizime përputhëse në të gjithë tekstin; dhe (v) korniza e propozuar pengon Mbrojtjen që t'i intervistojë dëshmitarët në të njëjtat kushte si i ka intervistuar ZPS-ja, bart rrezikun që Mbrojtja të duhet t'i zbulojë ZPS-së linjat dhe përmbajtjen e hetimeve të veta, dhe kufizon aftësitë e saj për të kryer hetime dhe për t'u përgatitur për gjykim.⁷²

4. Përgjigjja e Veselit

39. Mbrojtja e Veselit i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të hedhë poshtë kornizën e propozuar dhe t'i udhëzojë palët të angazhohen në diskutime lidhur me një protokoll të përshtatshëm për këtë çështje gjyqësore.⁷³

40. Sipas Mbrojtjes së Veselit, korniza e propozuar nuk mbështetet nga asnjë precedent apo nga dispozitat ligjore të zbatueshme në DHS.⁷⁴ Ajo parashton se Urdhri në Çështjen Gucati dhe Haradinaj nuk përbën precedent të zbatueshëm për arsye se: (i) ai u lëshua nga Trupi Gjykses përkatës pasi Mbrojtja kishte përfunduar hetimet dhe kishte dorëzuar listën me dëshmitarët e pritshëm të saj; (ii) protokollin i rreptë lidhur me kontaktet me dëshmitarët dhe informacionin konfidencial lidhej drejtpërdrejt me akuzat bazë në çështjen Gucati dhe Haradinaj; (iii) madhësia e çështjes gjyqësore aktuale krahasuar me çështjen Gucati dhe Haradinaj e bën çdo përpjekje për t'i zbatuar kushtet e tij shumë më të ndërlikuar

⁷²Përgjigjja e Krasniqit, para. 15-23.

⁷³ Përgjigjja e Veselit, para. 4, 34-35.

⁷⁴ Përgjigjja e Veselit, para. 2, 5.

dhe të vështirë; dhe (iv) në fazat paraprake të çështjeve gjyqësore KSC-BC-2020-04 dhe KSC-BC-2020-05, që kanë të bëjnë me akuza dhe dëshmitarë të ngjashëm me ato të çështjes gjyqësore aktuale, nuk u zbatua ndonjë protokoll i tillë.⁷⁵

41. Mbrojtja e Veselit shton se asnjë nga dispozitat që citon ZPS-ja nuk mbështet kornizën e propozuar në këtë fazë të procesit sepse: (i) logjikisht pritet që një protokoll me kushte kaq të rënda do të ishte parashikuar në tekstet ligjore të zbatueshme, duke pasur parasysh se të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21(4) të Ligjit mund të kufizohen vetëm me ligj; (ii) neni 23 i Ligjit dhe rregullat 80 dhe 95(2) të Rregullores duhen zbatuar mbi baza individuale për çdo dëshmitar dhe nuk e lejojnë Gjykatësin e Procedurës Paraprake të nxjerrë një protokoll të përgjithshëm për të gjithë dëshmitarët, pa marrë parasysh rrethanat specifike të tyre; (iii) masat e marra apo të kërkuara nga ZPS-ja në bazë të nenit 35 të Ligjit duhet të jenë në përputhje me Ligjin, ndërsa korniza e propozuar nuk është në përputhje me të; (iv) neni 38 i Ligjit nuk ka të bëjë me fazën aktuale të procesit; (v) neni 39(1) i Ligjit nuk shfuqizon kriterin që çdo urdhër apo vendim duhet të jetë njëherazi i domosdoshëm ashtu edhe proporcional, dhe korniza e propozuar, në vend që ta përshpejtojë, do ta vonojë ndjeshëm procedurën paraprake; dhe (vi) nenet 6, 12, 14 dhe 17 të Kodit të Etikës nuk mbështesin, madje as në mënyrë të nënkuptuar, kornizën e propozuar; përkundrazi, duket se e kundërta është e vërtetë.⁷⁶

42. Mbrojtja e Veselit parashtron gjithashtu se korniza ligjore ekzistuese realizon me efektivitet pikërisht atë mbrojtje që pretendon se kërkon ZPS-ja në lidhje me dëshmitarët dhe viktimat e mbrojtura dhe trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve të Mbrojtjes.⁷⁷

⁷⁵ Përgjigjja e Veselit, para. 6-12.

⁷⁶ Përgjigjja e Veselit, para. 13-15.

⁷⁷ Përgjigjja e Veselit, para. 16-17.

43. Gjithashtu, sipas Mbrojtjes së Veselit, korniza e propozuar do të ishte në shkelje të drejtpërdrejtë të së drejtës së barazisë midis palëve, sepse ZPS-ja ka pasur më shumë se dhjetë vjet për të hetuar akuzat e ngritura kundër z. Veseli, bashkë me lirinë për të zgjedhur metodologjinë e kontaktimit dhe intervistimit të dëshmitarëve, dhe ZPS-ja do të informohet për çdo hap hetimor të Mbrojtjes, sepse Mbrojtjes do t'i duhet që dëshmitarët të cilët i gjykon me rëndësi strategjike t'i kontaktojë domosdoshmërisht nëpërmjet ZPS-së.⁷⁸ Ajo shton se korniza e propozuar do të cenonte edhe të drejtën e të akuzuarit për të përgatitur mbrojtjen e vet, sepse prania e një pale tjetër gjatë intervistës me dëshmitarin do të komprometonte efikasitetin e intervistës.⁷⁹ Gjithashtu, Mbrojtja e Veselit parashtron se korniza e propozuar nuk është hartuar specifikisht për avancimin e qëllimit të shprehur të ZPS-së, sepse nuk bën aspak dallim midis dëshmitarëve që kanë shprehur frikë ose dëshirë që të mos kontaktohen nga Mbrojtja dhe atyre që vullnetarisht dhe pa hezitim do të ishin të gatshëm të flisnin me çdo palë në proces.⁸⁰

44. Së fundi, Mbrojtja e Veselit parashtron se korniza e propozuar do të krijonte vështirësi të mëdha logjistike dhe do të rezultonte në vonesa të konsiderueshme, sepse: (i) Zyra Administrative theksoi përgatitjet logjistike të konsiderueshme që kërkohen për zbatimin e një protokollit të tillë, madje edhe në rastin kur bëhej fjalë vetëm për tre dëshmitarë, në çështjen Gucati dhe Haradinaj; dhe (ii) kërkesa që dëshmitari të vijë në Hagë pasi është intervistuar më parë nga ZPS-ja do të kishte ndikim dekurajues të konsiderueshëm tek ai.⁸¹

⁷⁸ Përgjigjja e Veselit, para. 20-22.

⁷⁹ Përgjigjja e Veselit, para. 2, 23-25.

⁸⁰ Përgjigjja e Veselit, para. 3, 26-28.

⁸¹ Përgjigjja e Veselit, para. 29-33.

D. PARASHTRIMET E ZYRËS ADMINISTRATIVE

45. Zyra Administrative argumenton se parashtrimet e saj në çështjen Gucati dhe Haradinaj trajtonin posaçërisht veçoritë e asaj çështjeje dhe se, rrjedhimisht, nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme në një çështje tjetër gjyqësore në DHS.⁸²

46. Sipas Zyrës Administrative, me burimet ekzistuese, ZMMD-ja mund të kryejë konsultime dhe të këshillojë palët dhe pjesëmarrësit lidhur me trajtimin e informacionit konfidencial në mënyrën e parashikuar në parashtrimet e ZPS-së.⁸³

47. Për t'i dhënë Gjykatësit të Procedurës Paraprake informacion të saktë lidhur me realizueshmërinë, ndikimin dhe pasojat e propozimeve të ZPS-së lidhur me kontaktet me dëshmitarët e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, Zyra Administrative kërkon të dhëna të mëtejshme për të vlerësuar dhe përcaktuar saktë rrjedhojat që do të ketë realizimi i disa ose i të gjitha shërbimeve të propozuara për burimet financiare dhe njerëzore, si dhe për të siguruar njëkohësisht ofrimin e shpejtë të këtyre shërbimeve, ndër të cilat: (i) numri i përafërt i dëshmitarëve që do të intervistohen; (ii) nëse secili dëshmitar do të intervistohet një herë, apo ekziston mundësia që dëshmitarët të intervistohen disa herë; (iii) shteti ku do të kryhen intervistat; (iv) kohëzgjatja e përafërt e secilës intervistë; dhe (v) periudha e përafërt gjatë të cilës do të nevojiten burimet e Zyrës Administrative për zbatimin e propozimeve.⁸⁴

E. PËRGJIGJET E MËTEJSHME

1. Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave

48. Mbrojtësi i Viktimave e mbështet kornizën e propozuar sepse ajo mbron sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve dhe në të njëjtën kohë garanton të drejtat

⁸² Përgjigjja e Zyrës Administrative, para. 8.

⁸³ Përgjigjja e Zyrës Administrative, para. 9.

⁸⁴ Përgjigjja e Zyrës Administrative, para. 11.

e të akuzuarve për gjykim të drejtë dhe siguron komunikim të shpejtë dhe transparent midis palëve dhe pjesëmarrësve.⁸⁵ Sipas Mbrojtësit të Viktimave, kjo temë duhet parë në kuadër të atmosferës shumë reale të frikës në të cilën jetojnë dëshmitarët, ndër të cilët edhe dëshmitarët me status të dyfishtë, çka e bën të pamendueshme që të mos ketë një kornizë për rregullimin e kontakteve të Mbrojtjes me ta.⁸⁶ Mbrojtësi i Viktimave parashtron se njoftimi nga pala kundërshtare se dëshiron të intervistojë një dëshmitar të palës thirrëse ndihmon që të shmangen pretendimet për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve, sikurse ka vënë në dukje TPNJ-ja, dhe përfshihet edhe në Protokollin e GJPN-së.⁸⁷ Mbrojtësi i Viktimave argumenton më tej se dëshmitari, sidomos një dëshmitar me status të dyfishtë, duhet të lejohet të vendosë mbi bazën e informacionit nëse pranon të intervistohet nga pala kundërshtare apo jo, dhe duhet t'i jepet kohë e mjaftueshme për ta marrë atë vendim – kusht që përcaktohet edhe në Protokollin e GJPN-së.⁸⁸ Gjithashtu, sipas Mbrojtësit të Viktimave, ndonëse në shumicën e rasteve prania e palës thirrëse është e mjaftueshme për të mbrojtur interesat e dëshmitarit, kur bëhet fjalë për dëshmitarët me status të dyfishtë, korniza duhet të marrë parasysh edhe mundësinë e pranisë së Mbrojtësit të Viktimave apo të ndonjë personi tjetër mbështetës, nëse kjo kërkohet nga dëshmitari, sikurse veprohet edhe në GJPN.⁸⁹ Mbrojtësi i Viktimave parashtron gjithashtu se të mirat e incizimit me audio dhe video (që e përmban edhe Protokollin e GJPN-së) janë: transparencja, saktësia e dokumentimit, dhe pakësimi i nevojës që dëshmitarit t'i bëhen intervista të tjera.⁹⁰ Mbrojtësi i Viktimave shton se për disa dëshmitarë (dhe veçanërisht për ata me status të dyfishtë) mundësia e intervistimit nga pala kundërshtare nën kujdesin e Zyrës Administrative mund të jetë shumë më e pranueshme se sa intervistimi pa

⁸⁵ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 8, 35.

⁸⁶ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 9-11.

⁸⁷ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 13-14.

⁸⁸ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 15.

⁸⁹ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 16-17.

⁹⁰ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 18-19.

këtë mbikëqyrje.⁹¹ Së fundi, sipas Mbrojtësit të Viktimave, korniza e propozuar duhet të përfshijë edhe praktikën e GJPN-së sipas së cilës pala/pjesëmarrësi thirrës ka detyrimin të garantojë që dëshmitarët, në veçanti ata të cënueshëm apo që kanë nevojë për ndihmë gjatë intervistës, të marrin mbështetjen e duhur, përfshirë edhe nga ZMMD-ja.⁹²

49. Mbrojtësi i Viktimave gjithashtu parashtron se korniza e propozuar është shumë e ngjashme me Protokollin e GJPN-së dhe sugjeron se kritika e Mbrojtjes është e ekzagjeruar dhe e pavend.⁹³ Mbrojtësi i Viktimave parashtron në veçanti se argumenti i Mbrojtjes se ZPS-ja ka kryer intervista me dëshmitarët pa praninë e Mbrojtjes nuk merr parasysh se: (i) nuk ka si të sugjerohet që ZPS-ja duhet t'i kishte ftuar të akuzuarit të ishin të pranishëm në intervistat hetimore të saj; (ii) ZPS-ja do të pranojë që në intervistat e saj me dëshmitarët e Mbrojtjes të jetë i pranishëm një përfaqësues i Mbrojtjes, megjithëse nuk do të ketë qenë e ftuar në takimet e mëhershme të Mbrojtjes me ta; dhe (iii) edhe Mbrojtja do të mësojë për qasjen e ZPS-së ndaj dëshmitarëve të Mbrojtjes, kështu që disavantazhi i pretenduar i Mbrojtjes duhet të peshohet kundrejt idesë që kontaktet me dëshmitarët duhet të jenë të pakufizuara.⁹⁴ Mbrojtësi i Viktimave parashtron gjithashtu korniza e propozuar nuk cenon privilegjin e Mbrojtjes, sepse Mbrojtja zgjedh të heqë dorë nga ai privilegj kur ia bën të ditur një informacion të mbrojtur një pale të tretë dhe, krahas kësaj, rregullat 111(1) dhe (2) të Rregullores nuk janë të zbatueshme sepse nuk kanë të bëjnë me heqjen dorë nga privilegji në rastin kur informacioni i mbrojtur i komunikohet një pale të tretë.⁹⁵ Së fundi, Mbrojtësi i Viktimave argumenton se, duke qenë se pala thirrëse lejohet ta diskutojë

⁹¹ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 20.

⁹² Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 21.

⁹³ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 2, 22-24.

⁹⁴ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 2, 26-28.

⁹⁵ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 2, 29-32.

përmbajtjen e intervistës me dëshmitarin, atëherë nuk mund të ketë kundërshtim parimor që pala thirrëse të marrë incizimin e saj.⁹⁶

2. Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së

50. ZPS-ja thekson përsëri rëndësinë e ekzistencës së një procedure për rregullimin e kontakteve me dëshmitarët e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë dhe parashtron se në rrethanat e veçanta të DHS-së dhe të kësaj çështjeje gjyqësore, kjo procedurë duhet të marrë parasysh atmosferën tashmë të vërtetuar dhe të vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”).⁹⁷

51. Sipas ZPS-së, parashtrimet e Zyrës Administrative vënë në dukje vështirësitë që mund të krijojë korniza e propozuar për burimet e Zyrës Administrative dhe ndikimin e mundshëm të saj në shpejtësinë e procesit.⁹⁸ Rrjedhimisht, ZPS-ja propozon modifikimet e mëposhtme në kornizën e propozuar:

- a. Zyrës Administrative nuk i kërkohet të bëjë organizimet logjistike për intervistat dhe prania e përfaqësuesit të Zyrës Administrative në intervistë nuk është e detyrueshme. Gjithsesi, pala thirrëse duhet të jetë e pranishme. Ky kusht është thelbësor duke marrë parasysh trysninë shumë reale që ndiejnë dëshmitarët në këtë çështje. Në rrethana të veçanta, pala ose pjesëmarrësi mund t’i drejtohet panelit që të kërkojë edhe praninë e përfaqësuesit (përfaqësuesve) të Zyrës Administrative. Megjithatë, si rregull, edhe nëse dëshmitari “pranon” që ZPS-ja të mos jetë e pranishme, kjo nuk përben arsye të mjaftueshme që intervista të kryhet në mungesë të ZPS-së, duke pasur parasysh detyrimin shumë real që do të ndiejnë dëshmitarët që të pranojnë ta kryejnë intervistën pa praninë e ZPS-së. Në rastet kur do të jetë i pranishëm një përfaqësues i Zyrës Administrative, paneli, sipas nevojës dhe rastit, urdhëron gjithashtu që Zyra Administrative ose përfaqësuesi ose përfaqësuesit e saj të përmbushin detyrimet e përcaktuara në paragrafin 6(h)-6(k) dhe (n) të kornizës së propozuar.

⁹⁶ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 33-34.

⁹⁷ Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së, para. 2-3.

⁹⁸ Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së, para. 4.

- b. Në mungesë të përfaqësuesit të Zyrës Administrative dhe përveç nëse paneli urdhëron ndryshe:
- i. Pala intervistuese merr të gjitha masat e nevojshme logjistike në përputhje me praktikat më të mira. Pala thirrëse mbulon shpenzimet e pranisë së saj në intervistë.
 - ii. Në konsultim me palët dhe bazuar në informacionin e dhënë sipas paragrafit 6(e)-(g), si edhe nëse është e realizueshme, Zyra Administrative mundëson përgatitjen e procesit. Gjithashtu, sikurse përcaktohet në paragrafin 6(h)(iv), kur ZMMD-ja e gjykon të nevojshme, Zyra Administrative siguron që një përfaqësues ZMMD-së të jetë i pranishëm në vendin ku do të kryhet intervista ose ndryshe i disponueshëm.
 - iii. Nëse ka kundërshtim për ndonjë pjesë të procedurës së ndjekur apo për linjë apo mënyrë të caktuar të marrjes në pyetje gjatë intervistës, pala thirrëse e ngre këtë problem me palën intervistuese, jo në prani të dëshmitarit. Çdo mosmarrëveshje evidentohet në dokumentacion dhe nuk pengon apo ndërpret në mënyrë të papërligjur intervistën.⁹⁹

3. Përgjigjja e Mëtejshme e Selimit

52. Sipas Mbrojtjes së Selimit, në qendër të vëmendjes së Gjykatësit të Procedurës Paraprake duhet të jenë të drejtat themelore të të akuzuarve dhe, në këtë kuadër, realizueshmëria e përgjithshme e masave logjistike të propozuara nga ZPS-ja nuk është relevante.¹⁰⁰

53. Mbrojtja e Selimit parashtron se, duke qenë se korniza e propozuar përmban dispozita që në thelb u kërkojnë palëve të ndërmarrin dhe/ose të kryejnë bashkërisht rolin e përcaktuar me ligj të ZMMD-së për mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët, mendimi i Administratores për këtë aspekt do të ishte i dobishëm për Gjykatësin e Procedurës Paraprake.¹⁰¹ Mbrojtja e Selimit shton se synimi i ZPS-së është që ta zgjerojë kornizën e propozuar, që ajo mundësisht të

⁹⁹ Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së, para. 5-6.

¹⁰⁰ Përgjigjja e Mëtejshme e Selimit, para. 2.

¹⁰¹ Përgjigjja e Mëtejshme e Selimit, par për kornizën e a. 5-6.

përfshijë më shumë individë se ata që janë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe ky është një faktor që Administratorja duhet ta mbajë parasysh në çdo rrethanë.¹⁰² Ajo gjithashtu parashtron se çdo përlllogaritje duhet të mbajë parasysh faktin se, me gjasë, data, ora (dhe, në një shkallë më të vogël, vendi) në të cilat do të duan t'i kryejnë intervistat me dëshmitarët ekipet e Mbrojtjes, nuk do të përputhen, për shkak të natyrës dhe detyrave të pavarura të këtyre ekipeve.¹⁰³

54. Mbrojtja e Selimit parashtron se: (i) rezervon të drejtën të kërkojë të intervistojë çdo dëshmitar në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së që është gjallë; (ii) nuk është në gjendje të përcaktojë me siguri nëse do t'i duhet të kryejë me dëshmitarët disa intervista, por gjasat janë të mëdha që në shumë raste mund të ndodhë ashtu; (iii) nuk është në gjendje të përcaktojë konkretisht vendin e intervistave, megjithëse ka të ngjarë që intervistat do të duhen të kryhen në vende të ndryshme jashtë Holandës dhe Kosovës; (iv) nuk është në gjendje të japë vlerësim për kohëzgjatjen e secilës intervistë, por vë në dukje se intervistat e ZPS-së me dëshmitarë të ndryshëm kanë zgjatur shumë orë dhe, në disa rase, disa ditë; dhe (v) mendon se është e arsyeshme që Zyra Administrative të supozojë se burimet e saj do nevojiten gjatë gjithë fazës së procedurës paraprake dhe gjykimit, sepse ZPS-ja nuk jep ndonjë afat konkret për kornizën e propozuar.¹⁰⁴

55. Lidhur me trajtimin e informacionit konfidencial, Mbrojtja e Selimit argumenton se fakti që përfshirja e ZMMD-së në mënyrën e përshkruar në kornizën e propozuar është e realizueshme, nuk duhet të përdoret për të shpërfillur shqetësimet e mirëbazuara të Mbrojtjes për natyrën e panevojshme dhe akuzuese të këtyre propozimeve, të cilat i drejtohen pothuaj tërësisht Mbrojtjes.¹⁰⁵

¹⁰² Përgjigjja e Mëtejshme e Selimit, para. 7.

¹⁰³ Përgjigjja e Mëtejshme e Selimit, para. 8.

¹⁰⁴ Përgjigjja e Mëtejshme e Selimit, para. 9-15.

¹⁰⁵ Përgjigjja e Mëtejshme e Selimit, para. 16.

4. Përgjigjja e Mëtejshme e Thaçit

56. Mbrojtja e Thaçit parashtron se, ndonëse Zyra Administrative konfirmoi se është e realizueshme të kryejë konsultime dhe t'i këshillojë palët/pjesëmarrësit në lidhje me trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve në mënyrën e propozuar nga ZPS-ja, nuk është e nevojshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të nxjerrë protokoll për këtë, duke qenë se anëtarët e ekipeve të Mbrojtjes kanë detyrimin të respektojnë kodet e etikës dhe/ose marrëveshjet e konfidencialitetit.¹⁰⁶ Ajo shton se Zyra Administrative ende nuk ka shprehur qëndrimin e saj lidhur me realizueshmërinë e kornizës së propozuar sa i përket kontakteve me dëshmitarët dhe se u përmbahet parashtrimeve të paraqitura në Përgjigjen e Thaçit.¹⁰⁷

5. Përgjigjja e Mëtejshme e Veselit

57. Mbrojtja e Veselit vlerëson se gjatë hetimeve të saj do të intervistojë rreth 25% deri 33% të dëshmitarëve të ZPS-së, megjithëse kjo shifër mund të rritet.¹⁰⁸ Ajo parashikon gjithashtu se ka të ngjarë që të kryhen disa intervista me të njëjtin dëshmitar dhe që të ketë edhe intervista vijuese.¹⁰⁹ Mbrojtja e Veselit vë në dukje se hetimet e Mbrojtjes bazohen tërësisht në dëshmitarë të cilët do të takohen dhe flasin me Mbrojtjen vullnetarisht, dhe se ajo synon të kryejë sa më shumë intervista në Kosovë apo në cilindo shtet ku banojnë aktualisht dëshmitarët.¹¹⁰ Gjithashtu, sipas Mbrojtjes së Veselit, intervistat materiale më të shkurtra mund të zgjasin nga një deri në tri orë, ndërsa intervistat më të hollësishme do të zgjasin më shumë.¹¹¹ Së fundi, Mbrojtja e Veselit parashtron se periudha gjatë së cilës do të nevojiten burimet e Zyrës Administrative do të vazhdojë edhe më tutje, sepse është

¹⁰⁶ Përgjigjja e mëtejshme e Thaçit, para. 9.

¹⁰⁷ Përgjigjja e mëtejshme e Thaçit, para. 1, 10, 11.

¹⁰⁸ Përgjigjja e Mëtejshme e Veselit, para. 7.

¹⁰⁹ Përgjigjja e Mëtejshme e Veselit, para. 8.

¹¹⁰ Përgjigjja e Mëtejshme e Veselit, para. 9-10.

¹¹¹ Përgjigjja e Mëtejshme e Veselit, para. 11.

sugjeruar që gjykimi mund të fillojë përpara se Mbrojtja të përfundojë hetimet e saj.¹¹²

6. Përgjigjja e Mëtejshme e Krasniqit

58. Mbrojtja e Krasniqit informon se i ka filluar hetimet, por se pjesa më e madhe e tyre ende nuk është kryer dhe pengohet nga disa faktorë.¹¹³ Ajo mendon se është e parakohshme që asaj t'i kërkohet numri i përafërt i dëshmitarëve që synon të intervistojë.¹¹⁴ Megjithatë, Mbrojtja parashtron se përllogarit që mund të kërkojë të intervistojë afërsisht 75 dëshmitarë *viva voce*.¹¹⁵ Mbrojtja gjithashtu parashtron se e mendon të parakohshme dhe se në këtë fazë nuk është në gjendje të vlerësojë e të paraqesë parashtrime të njëmendta lidhur me aspektet e tjera për të cilat kërkoi informacion Administratorja.¹¹⁶

F. KUNDËRPËRGJIGJJA E THAÇIT NDAJ MBROJTËSIT TË VIKTIMAVE DHE PARASHTRIME LIDHUR ME TË

59. Mbrojtja e Thaçit i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave të hiqet nga dokumentacioni i çështjes gjyqësore dhe që t'i kujtojë Mbrojtësit të Viktimave detyrimin e respektimit të afateve të vendosura në Rregullore.¹¹⁷ Mbrojtja e Thaçit parashtron se në Urdhrin e 21 Janarit 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ftoi palët dhe pjesëmarrësit t'u përgjigjeshin vetëm parashtrimeve të Zyrës Administrative, kurse Mbrojtësi i

¹¹² Përgjigjja e Mëtejshme e Veselit, para. 12.

¹¹³ Përgjigjja e Mëtejshme e Krasniqit, para. 7.

¹¹⁴ Përgjigjja e Mëtejshme e Krasniqit, para. 8-10.

¹¹⁵ Përgjigjja e Mëtejshme e Krasniqit, para. 11.

¹¹⁶ Përgjigjja e Mëtejshme e Krasniqit, para. 12.

¹¹⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj Mbrojtësit të Viktimave, para. 1, 16, 18.

Viktimave e përdori atë mundësi për t'iu kundërpërgjigjur dhe për të kundërshtuar Përgjigjet e Mbrojtjes.¹¹⁸

60. Mbrojtësi i Viktimave nuk e pranon Kundërpërgjigjen e Thaçit ndaj Mbrojtësit të Viktimave.¹¹⁹ Sipas Mbrojtësit të Viktimave, Urdhri i 21 Janarit 2022 përcaktoi afatin e dorëzimit të përgjigjeve, jo të kundërpërgjigjeve, dhe për rrjedhojë, dorëzimi i Përgjigjes së Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave u bë brenda afatit.¹²⁰ Mbrojtësi i Viktimave argumenton gjithashtu se, si rregull, palëve u lejohej të bëjnë parashtrime në lidhje me vendime gjyqësore që nuk kanë dalë ende, sidomos kur ato janë kaq të rëndësishme sa vendimi aktual.¹²¹

61. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Mbrojtësi i Viktimave e keqkupton Kundërpërgjigjen e Thaçit ndaj Mbrojtësit të Viktimave, në të cilën parashtrioi se Mbrojtësi i Viktimave shkoi shumë përtej asaj që kishte kërkuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake, konkretisht që të dorëzoheshin përgjigje ndaj parashtrimeve të Zyrës Administrative, dhe se ai nuk e dorëzoi përgjigjen brenda afatit.¹²²

G. KUNDËRPËRGJIGJJA E THAÇIT NDAJ ZPS-SË

62. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, në qoftë se Prokurori i Specializuar vërtet do të besonte që hedhja poshtë e kornizës së propozuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të krijonte rreziqe shumë të mëdha për integritetin e provave materiale në këtë çështje gjyqësore, atëherë ai ose: (i) neglizhoi detyrat e tij si Prokuror i Specializuar, sepse i lejoi Mbrojtjes të dëmtonte “integritetin e provave” duke intervistuar dëshmitarët e ZPS-së për trembëdhjetë muaj, nga nëntori 2020 deri në dhjetor 2021, para se të kërkonte vendosjen e kornizës së propozuar; ose

¹¹⁸ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj Mbrojtësit të Viktimave, para. 10, 14-15.

¹¹⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 960.

¹²⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 961-962.

¹²¹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 962-963.

¹²² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 963-964.

(ii) nuk beson se intervistat e Mbrojtjes përbëjnë kërcënim për integritetin e procesit, që është e vërteta.¹²³

63. Sa i përket pretendimit në Përgjigjen e Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave se korniza e propozuar është e nevojshme sepse disa nga dëshmitarët me status të dyfishtë kanë frikë se do të vriten, Mbrojtja e Thaçit argumenton se neni 16 i Kodit të Etikës garanton që të mos ketë kontakte të drejtpërdrejta midis Mbrojtjes dhe dëshmitarëve me status të dyfishtë.¹²⁴ Mbrojtja e Thaçit parashtron gjithashtu se, ndonëse nuk ka dijeni për ndonjë ankesë nga dëshmitarë të ZPS-së për përvojat e tyre gjatë intervistave me Mbrojtjen në pesëmbëdhjetë muajt e fundit, shumë dëshmitarë të ZPS-së u bënë të ndihen se ZPS-ja mund të ngrinte aktakuzë kundër tyre nëse përgjigjet që do të jepnin nuk ishin të kënaqshme për ZPS-në, ndërsa një dëshmitar tjetër u shpreh se deklarata e tij në tërësi duket se pasqyron që interesi për informacione shfajësuese ishte më i vogël se sa për ato inkriminuese.¹²⁵ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit parashtron se ZPS-ja nuk ofron asnjë provë në mbështetje të supozimeve në të cilat mbështet kërkesën e saj, sa i përket trytnisë së ushtruar ndaj dëshmitarëve dhe deklaratave të Mbrojtjes lidhur me ZPS-në.¹²⁶

64. Më tej, Mbrojtja e Thaçit përsërit disa nga parashtrimet e paraqitura në Përgjigjen e Thaçit¹²⁷ dhe i kërkon përsëri Gjykatësit të Procedurës Paraprake që ta hedhë poshtë kornizën e propozuar.¹²⁸

¹²³ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së, para. 2.

¹²⁴ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së, para. 7.

¹²⁵ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së, para. 14-17.

¹²⁶ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së, para. 18-21.

¹²⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së, para. 4-5, 8-13.

¹²⁸ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së, para. 3, 4, 6, 22.

H. SEANCA E 22 SHKURTIT 2022

1. ZPS-ja

65. Sipas ZPS-së, korniza e propozuar është hartuar në bazë të kornizave të ngjashme të zbatuara në një çështje tjetër gjyqësore në DHS dhe në një numër çështjesh gjyqësore në GJPN dhe në tribunalë të tjerë ndërkombëtarë.¹²⁹ ZPS-ja thekson gjithashtu rëndësinë e kornizës së propozuar, duke pasur parasysh ekzistencën prej kohësh të atmosferës së frikësimit në kuadër të proceseve gjyqësore kundër anëtarëve të UÇK-së.¹³⁰

66. ZPS-ja parashtron se korniza e propozuar mund të urdhërohet në bazë të nenit 23 të Ligjit dhe rregullës 80 të Rregullores për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, për zbatimin e së cilës nuk mund të vihet afat kohor vetëm ngaqë më parë ishte caktuar një afat në kontekstin specifik të nxjerrjes së informacionit; në bazë të nenit 39(1), (3), (11) dhe (13) të Ligjit lidhur me kryerjen e shpejtë dhe të drejtë të procesit dhe integritetin e provave, si dhe në bazë të rregullave 82 dhe 83 të Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial.¹³¹ ZPS-ja shton se korniza e propozuar vlen për të gjithë dëshmitarët, sepse shërben për qëllimet e lartpërmendura dhe sepse ka gjasa që ndaj disa dëshmitarëve pa masa mbrojtëse të ushtrohet trysni e madhe.¹³²

67. Sa u takon argumenteve të Mbrojtjes lidhur me gjykimin e drejtë, ZPS-ja argumenton se Mbrojtja bën vetëm pohime të përgjithshme dhe se këto argumente janë paraqitur vazhdimisht në TPNJ dhe GJPN dhe janë hedhur poshtë prej tyre.¹³³ ZPS-ja parashtron më tej se mbrojtja e produktit të punës së brendshme, e konfidencialitetit të komunikimit midis mbrojtësit dhe klientit, apo e së drejtës së mosinkriminimit të vetes, nuk zbatohen në rastet kur Mbrojtja ia nxjerr

¹²⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 964-965, 969-970, 973-974.

¹³⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 965-966, 973, 1040-1042.

¹³¹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 966.

¹³² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 967.

¹³³ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 967, 1040.

vullnetarisht informacionin një pale të tretë.¹³⁴ Gjithashtu, sipas saj, e drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët nuk përfshin të drejtën për t'i intervistuar dëshmitarët e palës kundërshtare pa mbikëqyrje apo rregulla. Në këtë kuadër ajo përmend një vendim të TPNJ-së që nuk e lejoji Mbrojtjen t'i thërriste dëshmitarët e Prokurorisë së TPNJ-së, sepse Mbrojtja do të kishte mundësinë t'i pyeste ata gjatë gjyqimit; vendime të TPNR-së dhe GJPN-së që i lejuan palës thirrëse të ishte e pranishme në intervistat para fillimit të gjyqimit; si edhe sisteme ligjore shtetërore që përcaktojnë se, pas identifikimit të dëshmitarëve që do të merren në pyetje në gjykim, intervistat e mëtejshme me ata dëshmitarë kryhen vetëm në qoftë se jep urdhër nga gjykata.¹³⁵

68. ZPS-ja parashtron gjithashtu se ekipet e Mbrojtjes duhet të nxiten të kryejnë intervista të përbashkëta dhe, në rastin e dëshmitarëve viktimë, duhet të kenë detyrimin ta bëjnë këtë.¹³⁶

69. Sa i takon mundësisë që pala thirrëse të jetë e pranishme në intervistë kundër dëshirës së dëshmitarit dhe duke mbajtur parasysh trysninë që ushtrohet në këtë çështje gjyqësore, ZPS-ja parashtron se, sikurse është vepruar në tribunalë të tjerë, prania e palës kundërshtare duhet të jetë e drejtë e vetvetishme dhe vetëm paneli mund të urdhërojë përjashtim nga ky rregull.¹³⁷

70. ZPS-ja gjithashtu parashtron se është më mirë që korniza e propozuar të miratohet tani dhe në vijim palët të kryejnë konsultime, sipas nevojës dhe rastit, brenda kësaj kornize.¹³⁸ Gjithashtu, ajo i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të specifikojë se korniza e propozuar duhet të zbatohet edhe për kontaktet që kanë nisur më parë, t'i urdhërojë ekipet e Mbrojtjes të raportojnë se cilët dëshmitarë të ZPS-së kanë kontaktuar dhe intervistuar përpara se të

¹³⁴ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 967.

¹³⁵ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 967-969.

¹³⁶ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 969.

¹³⁷ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 974-975.

¹³⁸ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 970.

urdhërohej korniza, si dhe të nxjerrin dokumentet dhe incizimet e disponueshme të atyre kontakteve dhe intervistave.¹³⁹ Si alternativë, në qoftë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos se duhen mbajtur diskutime mes palëve, ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të urdhërojë që të mos ketë kontakte me dëshmitarët e palës kundërshtare deri në marrjen e vendimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹⁴⁰

71. Së fundi, ZPS-ja është e mendimit se përmendja e Kodit të Etikës nga Mbrojtja nuk qëndron si argument, sepse të dhënat tregojnë qartë se Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Veselit vazhdimisht nuk i respektojnë ato standarde.¹⁴¹

2. Mbrojtësi i Viktimave

72. Sipas Mbrojtësit të Viktimave, korniza e propozuar duhet të zbatohet për të gjithë dëshmitarët, sepse shërben që të ketë transparencë dhe siguri për çka është thënë, shmang keqkuptimet apo edhe akuzat e bëra në këtë apo atë drejtim, dhe zbatohet njësoj për të dyja palët.¹⁴² Mbrojtësi i Viktimave është gjithashtu i mendimit se për dëshmitarët me status të dyfishtë nevojiten masa të veçanta, konkretisht, njoftimi i Mbrojtësit të Viktimave – masë për të cilën nuk mund të ketë kundërshtime sepse e përmban edhe Kodi i Etikës – si edhe që Mbrojtësi i Viktimave duhet të lejohet të jetë i pranishëm në intervistë nëse kërkohet nga dëshmitari.¹⁴³

73. Për sa u takon aspekteve të gjykimit të drejtë të ngritura nga Mbrojtja, Mbrojtësi i Viktimave u qëndron parashtrimeve në Përgjigjen e Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave.¹⁴⁴

¹³⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 970-971.

¹⁴⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 971.

¹⁴¹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 971-972, 989-990.

¹⁴² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 976.

¹⁴³ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 976-978.

¹⁴⁴ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 978.

74. Mbrojtësi i Viktimave parashtron gjithashtu se ekipet e Mbrojtjes duhet të organizojnë intervista të përbashkëta me dëshmitarët kur planifikojnë të intervistojnë dëshmitarë që janë njëkohësisht edhe viktimë në proces, apo çdo kategori tjetër dëshmitarësh të cenueshëm, sepse nuk mund të lejohet që një dëshmitar të intervistohet katër herë nga ekipet e Mbrojtjes, përveçse në rrethana shumë të veçanta.¹⁴⁵

75. Mbrojtësi i Viktimave nuk ka kundërshtime për ndryshimet e propozuara në Përgjigjen e Mëtejshme të ZPS-së, megjithatë mendon se korniza e propozuar duhet të jetë më elastike sa i përket pranisë e Zyrës Administrative në rrethana të veçanta, si për shembull, kur intervista e një dëshmitari të cenueshëm nuk shkon sipas planit dhe nevojitet mbikëqyrje më e madhe nga Zyra Administrative.¹⁴⁶

76. Më tej, Mbrojtësi i Viktimave mendon se modeli i GJPN-së është model i mirë dhe ai është zbatuar në çështje gjyqësore mjaft komplekse, dhe se ai mund të përdoret varësisht cilësimeve në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë dhe përfshirjen e ZMMD-së, të formuluar në Përgjigjen e Mëtejshme të ZPS-së.¹⁴⁷ Mbrojtësi i Viktimave shton se, në të kundërt, do të duhet të paraqitet kërkesë me shkrim për të përligjur çdo herë që paraqitet kërkesë për intervistë, për praninë e ZPS-së në intervistë, apo për leje për incizimin e saj me video.¹⁴⁸

77. Së fundi, Mbrojtësi i Viktimave është i gatshëm të marrë pjesë në diskutime midis palëve dhe të ndihmojë në arritjen e një rezultati përfundimtar më të pranueshëm për të gjitha palët.¹⁴⁹

¹⁴⁵ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 978.

¹⁴⁶ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 979-980, 1043.

¹⁴⁷ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 980, 1043.

¹⁴⁸ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1043-1044.

¹⁴⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 980.

3. Mbrojtja e Thaçit

78. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, integriteti i sistemit ishte cenuar sepse Mbrojtja nuk qe e pranishme gjatë intervistave të ZPS-së me dëshmitarët.¹⁵⁰

79. Mbrojtja e Thaçit parashtron më tej që, ndryshe nga GJPN-ja, DHS-ja si gjykatë e Kosovës duhet të orientohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") e cila ka konstatuar se mbrojtësi duhet të jetë në gjendje të sigurojë pa kufizime aspektet themelore të mbrojtjes së personit dhe se GJPN-ja nuk ka konstatuar shprehimisht se Protokolle i GJPN-së është në përputhje me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("KEDNJ").¹⁵¹ Sipas Mbrojtjes së Thaçit, korniza e propozuar është në shkelje të së drejtës për mbrojtës, që përfshin të drejtën për të kryer hetime; së drejtës për gjykim të drejtë, që përfshin aftësinë për të marrë në pyetje në cilësinë e palës jothirrëse; dhe së drejtës për mosinkriminimin e vetes sipas KEDNJ-së, sepse prania e ZPS-së do të kërkonte që Mbrojtja të zgjidhte midis mundësisë së vetinkriminimit të të akuzuarit dhe moskryerjes së hetimeve.¹⁵² Mbrojtja e Thaçit është gjithashtu e mendimit se prania e ZPS-së mund të ishte në shkelje të rregullës 104 të Rregullores, sepse ZPS-ja mund të vendosë të mos e thërrasë një dëshmitar pasi intervistimit nga Mbrojtja. Kjo do ta detyronte Mbrojtjen ta thërriste atë dëshmitar dhe rrjedhimisht ZPS-ja do të ishte në zotërim të një deklaratë të cilën përndryshe nuk do të kishte të drejtë ta merrte para paraqitjes së provave nga Mbrojtja.¹⁵³ Ajo parashtron gjithashtu se korniza e propozuar do të shkaktonte vonesa të konsiderueshme.¹⁵⁴ Sa i takon faktit që në disa sisteme me gjykatës hetues Mbrojtja nuk ka të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët para gjykimit, Mbrojtja e Thaçit parashtron se në DHS i akuzuari ka të drejtë të kryejë

¹⁵⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 981-982, 988-989.

¹⁵¹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 982-983, 987-988, 992, 993, 994-996.

¹⁵² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 994, 995, 1051-1052.

¹⁵³ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 996, 999, 1047.

¹⁵⁴ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1048.

hetime për çështjen e vet dhe se nuk duhet të vihet në pozitën që të rrezikojë të krijojë prova kundër vetes, ose të mos kryejë fare hetime.¹⁵⁵ Ajo shton se në themel të kornizës së propozuar qëndron pretendimi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet t'i shohë me dyshim mbrojtësit, megjithëse ata janë të akredituar.¹⁵⁶ Sa i takon sugjerimit se korniza e propozuar i trajton të dy palët në mënyrë të barabartë, Mbrojtja e Thaçit parashtron se Rregullorja është hartuar në mënyrë të tillë që detyrimet për nxjerrjen e materialit të mos jenë të barabarta, sepse detyrimi i ZPS-së për nxjerrjen e materialit është shumë më i madh se ai i të akuzuarit, kurse sipas kornizës së propozuar, Mbrojtja duhet të nxjerrë deklaratat dhe shënime që përndryshe nuk do ishte e detyruar t'i nxirrte.¹⁵⁷

80. Mbrojtja e Thaçit argumenton se dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së nuk janë dëshmitarë të ZPS-së, se rreth 50% të këtyre dëshmitarëve kanë tashmë masa mbrojtëse, dhe se ZPS-ja dëshiron që masat mbrojtëse të vendosen për të gjithë dëshmitarët, përfshirë edhe për diplomatë dhe zyrtarë ndërkombëtarë, pa paraqitur ndonjë kërkesë apo justifikim dhe pas përfundimit të afatit, me qëllim që të parandalojë intervistimin e tyre nga Mbrojtja.¹⁵⁸ Sipas Mbrojtjes së Thaçit, ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me pretendimet e saj për trysni ndaj dëshmitarëve dhe se nuk është ngritur asnjë pretendim kundër Mbrojtjes për intervistat e kryera prej saj gjatë 15 muajve të fundit.¹⁵⁹ Mbrojtja e Thaçit shton se nuk përbën problem rasti i dëshmitarëve që përfaqësohen nga Mbrojtësi i Viktimave apo i atyre me shëndet veçanërisht të dobët dhe janë veçanërisht të dëmtuar emocionalisht dhe mendërisht.¹⁶⁰

¹⁵⁵ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 997-998, 1051.

¹⁵⁶ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 990-991.

¹⁵⁷ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 992-993, 996-997.

¹⁵⁸ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 983-984, 985-986, 1047-1048.

¹⁵⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 984-985, 991, 1044-1047, 1049-1051.

¹⁶⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 986-987, 1048-1049.

4. Mbrojtja e Veselit

81. Mbrojtja e Veselit është e mendimit se korniza e propozuar shkel prezumimin e pafajësisë sepse bazohet në premisat se të akuzuarit do të duan të ndërhyjnë në procesin e drejtësisë përmes mbrojtësve dhe se mbrojtësve nuk mund t'u besohet, megjithëse është ZPS-ja ajo që është përfshirë në sjellje prokuroriale kundërvajtëse.¹⁶¹ Ajo shton se korniza e propozuar nuk është proporcionale dhe se duhet të zbatohet për dëshmitarët e mbrojtur në bazë të urdhrave të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ndërsa rasti i personave që nuk kanë kërkuar mbrojtje të identitetit mund të trajtohet përmes njoftimit të Mbrojtësit të Viktimave, kurse personat e tjerë duhet të përjashtohen nga ky rregull, përveç nëse ZPS-ja paraqet kërkesë.¹⁶²

82. Mbrojtja e Veselit argumenton gjithashtu se proceset në sistemet gjyqësore ballafaqese nuk mund të huazojnë aspekte nga proceset sipas sistemit me gjykatës hetues, sepse lloji i parë bazohet në premisën që secila palë paraqet prova dhe korniza e propozuar do ta përmbyste këtë sistem.¹⁶³ Ajo parashtrohet më tej se GJEDNJ-ja e shqyrton çdo çështje gjyqësore si rast më vete dhe nuk bën deklaratë kategorike se çfarë është apo nuk është e drejtë në përgjithësi.¹⁶⁴

83. Për më tepër, sipas Mbrojtjes së Veselit, huazimi i protokolleve të ndryshme nga GJPN-ja dhe interpretimi tejet i ngurtë i tyre krijon sistemin më të ashpër të mundshëm dhe dëmton proporcionalitetin në çështjen aktuale.¹⁶⁵ Ajo parashtrohet gjithashtu se në çështjet gjyqësore ku janë zbatuar protokollat e GJPN-së, numri i dëshmitarëve ishte i vogël krahasuar me çështjen aktuale.¹⁶⁶ Më tej, Mbrojtja e Veselit përmend praktikën e TPNJ-së, e cila është praktikë e zakonshme në

¹⁶¹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1000-1001, 1005-1006, 1058-1059.

¹⁶² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1002-1003, 1006-1008, 1011-1012, 1053-1056.

¹⁶³ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1003-1005.

¹⁶⁴ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1052-1053.

¹⁶⁵ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1008.

¹⁶⁶ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1008-1009.

sistemet gjyqësore anglosaksone dhe përputhet me procesin në Kosovë, sipas së cilës dëshmitarët nuk janë pronë as e Prokurorisë dhe as e Mbrojtjes dhe se të dyja palët kanë të drejta të barabarta për t'i intervistuar ata, ndryshe nga praktika e GJPN-së ku pala thirrëse ka njëfarë pronësie mbi dëshmitarin.¹⁶⁷

84. Mbrojtja e Veselit parashtron se Mbrojtja duhet të organizojë intervista të përbashkëta sa herë që është e mundshme dhe që dëshmitarët të intervistohen më shumë se një herë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.¹⁶⁸

85. Gjithashtu, Mbrojtja e Veselit parashtron se, megjithëse ka pasur raste të shumta që dëshmitarët u frikësuan ose nuk dhanë dëshmi pas konfliktit, situata në Kosovë ka ndryshuar dhe në çështjen gjyqësore kundër Ramush Haradinajt në TPNJ shumë dëshmitarë dhanë dëshmi të ndryshme për arsye të ndryshme.¹⁶⁹

5. Mbrojtja e Selimit

86. Mbrojtja e Selimit parashtron se rregulla më e rëndësishme që citohet në mbështetje të kornizës së propozuar është rregulla 80 e Rregullores.¹⁷⁰ Sipas saj, masat mbrojtëse miratohen në raste të jashtëzakonshme dhe, në rast konflikti, peshorja duhet të anojë në favor të të akuzuarit.¹⁷¹ Mbrojtja e Selimit parashtron se ZPS-ja nuk i ka përmbushur kërkesat ligjore të rregullës 80 të Rregullores, sepse nuk ka bërë absolutisht asnjë përpjekje për të dhënë arsye për masat mbrojtëse.¹⁷² Gjithashtu ajo parashtron se përmendja nga ZPS-ja e integritetit të procedurave është një orvatje e momentit të fundit për të përligjur zbatimin e rregullës 80, duke bërë akuza të pabaza dhe të pambështetura në prova, që duket se drejtohen kundër

¹⁶⁷ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1009-1010.

¹⁶⁸ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1011.

¹⁶⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1056-1058.

¹⁷⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1013-1014.

¹⁷¹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1014-1015.

¹⁷² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1015-1016, 1060.

Mbrojtjes në tërësi.¹⁷³ Edhe Mbrojtja e Selimit ka shqetësimin se korniza e propozuar do të zbatohet për çdo person në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe parashtron se duhet bërë vlerësim objektiv i rrezikut për secilin individ dhe se masat duhet të arsyetohen rast pas rasti.¹⁷⁴

87. Gjithashtu, Mbrojtja e Selimit ka të njëjtat shqetësime edhe në lidhje me të drejtën e mosinkriminimit të vetes dhe të drejtën e përgatitjes së mbrojtjes.¹⁷⁵ Në lidhje me parimin e barazisë së palëve, ajo shton se korniza e propozuar drejtohet pothuaj tërësisht kundër Mbrojtjes.¹⁷⁶ Mbrojtja e Selimit rikujton gjithashtu se detyrimi i vërtetimit i takon ZPS-së, sikurse pasqyrohet edhe në rregullën 104(5) të Rregullores.¹⁷⁷

88. Mbrojtja e Selimit vë në dukje gjithashtu se për intervistat e përbashkëta duhet të merret vendim nga secili ekip i Mbrojtjes dhe ato nuk duhet t'i imponohen Mbrojtjes për shkak të faktorëve logjistikë.¹⁷⁸

89. Sa i takon Përgjigjes së Mëtejshme të ZPS-së, Mbrojtja e Selimit shpreh shqetësimin se prania e detyruar e ZPS-së në intervistat me dëshmitarët do të kishte ndikim dekurajues tek dëshmitarët.¹⁷⁹ Mbrojtja e Selimit shton se incizimi me video i intervistës do të zbulonte hetimet e Mbrojtjes dhe linjat e pyetjeve të saj, dhe nuk ka ndonjë lidhje të dukshme me mbrojtjen e dëshmitarëve.¹⁸⁰ Së fundi, Mbrojtja e Selimit mbështet qëndrimin e Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Protokollin e GJPN-së, si edhe në lidhje me KEDNJ-në.¹⁸¹

¹⁷³ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1016-1017.

¹⁷⁴ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1017-1018.

¹⁷⁵ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1018.

¹⁷⁶ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1018-1019, 1020-1022.

¹⁷⁷ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1019-1020.

¹⁷⁸ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1022.

¹⁷⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1023.

¹⁸⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1024.

¹⁸¹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1024-1025.

6. Mbrojtja e Krasniqit

90. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se problemi kyç është fakti që ZPS-ja kërkon të imponojë një protokoll të përgjithshëm për të gjithë dëshmitarët e ZPS-së, pa bërë asnjë përpjekje për të vërtetuar se të gjithë ata apo ndonjë prej tyre – pas vlerësimit të rrethanave personale – ka vërtet nevojë të mbrohet me anë të kornizës së propozuar.¹⁸² Ajo është e mendimit se rregulla 80 e Rregullores mund të ofrojë bazën për vendosjen e masave mbrojtëse për dëshmitarë të caktuar, kur domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i këtyre masave është vërtetuar në mënyrë objektive sipas standardit të kërkuar.¹⁸³ Sipas Mbrojtjes, ZPS-ja ose Mbrojtësi i Viktimave duhet që të paraqesin kërkesë të re për masa mbrojtëse, ose dëshmitarët duhet të ndahen në kategori.¹⁸⁴ Gjithashtu, Mbrojtja e Krasniqit mendon se prania e detyrueshme e ZPS-së do të kishte ndikim dekurajues tek dëshmitari dhe se nuk është e nevojshme që ZPS-ja të jetë e pranishme nëse dëshmitari jep pëlqimin të intervistohet.¹⁸⁵

91. Mbrojtja e Krasniqit parashtron më tej se kërkesa që ZPS-ja të jetë e pranishme në të gjitha intervistat me dëshmitarët e ZPS-së është faktikisht një mënyrë për t'i dhënë ZPS-së qasje të shpejtë në të gjitha linjat e hetimit, dokumentet dhe provat me gjasë inkriminuese të Mbrojtjes, tek të cilat ZPS-ja normalisht nuk do të kishte qasje ose do të kishte qasje në një fazë të mëvonshme të procesit, pavarësisht nga fakti që detyrimet për nxjerrje të informacionit në Rregullore janë asimetrike.¹⁸⁶

92. Gjithashtu, Mbrojtja e Krasniqit parashtron se ekipet e Mbrojtjes me gjasë do të kenë përparësi dhe interesa hetimore të ndryshme, që do të thotë se numri i intervistave të përbashkëta ka të ngjarë të jetë relativisht i kufizuar.¹⁸⁷

¹⁸² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1026, 1027-1028, 1029-1030, 1033, 1061.

¹⁸³ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1026-1028.

¹⁸⁴ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1028-1029, 1061-1062.

¹⁸⁵ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1030-1031, 1033.

¹⁸⁶ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1032.

¹⁸⁷ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1032.

93. Mbrojtja e Krasniqit është e mendimit se zbatimi i drejtpërdrejtë në Dhomat e Specializuara i modeleve të marra nga gjykata të tjera bart një rrezik, sepse është e pashmangshme që gjykata të ndryshme të kenë qëndrimet e tyre të bazuara në statutet dhe rregulloret përkatëse dhe rrethanat e çështjeve që gjykojnë.¹⁸⁸ Ajo shton se, ndërsa GJPN-ja duhet të jetë në gjendje të veprojë në të gjitha shtetet – ndonjëherë edhe pavarësisht nëse shteti bashkëpunon me gjykatën ose jo dhe pavarësisht nëse konflikti vazhdon ose jo në atë rast – DHS-ja funksionin kryesisht në lidhje me Kosovën, u themelua në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës, trajton një konflikt që përfundoi rreth 20 vjet më parë dhe përmasat e kësaj çështjeje gjyqësore e dallojnë atë nga çdo çështje që është gjykuar më parë në GJPN.¹⁸⁹ Mbrojtja e Krasniqit parashtron gjithashtu se TSL-ja nuk kishte ndonjë protokoll detyrues, dhe se TPNJ-ja në përgjithësi i njohu të drejtat e përgjithshme për të intervistuar dëshmitarët e palës tjetër, me kusht që të pala thirrëse të kishte mundësinë të kërkonte masa mbrojtëse nëse ishin të nevojshme.¹⁹⁰

94. Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit parashtron se është e gatshme të përfshihet në diskutime *inter partes*, por nëse qëndrimi i ZPS-së do të vazhdojë të jetë se korniza e propozuar duhet zbatuar për të gjithë dëshmitarët, ka mundësi që diskutimet të mos arrijnë ndonjë rezultat.¹⁹¹

7. Zyra Administrative

95. Zyra Administrative parashtron se duhet t'i jepet informacion mjaft i saktë për të bërë planifikimin e duhur për intervistat dhe për të administruar burimet ekzistuese dhe ato shtesë që mund të nevojiten, por, fatkeqësisht, për momentin nuk ka informacion të saktë.¹⁹² Zyra Administrative parashtron më tej se ajo mund

¹⁸⁸ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1035.

¹⁸⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1035-1036.

¹⁹⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1036.

¹⁹¹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1036-1037.

¹⁹² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1037-1038.

të ndihmojë për realizimin e propozimeve në Përgjigjen e Mëtejshme të ZPS-së dhe kërkon që të shihet mundësia e dhënies së një periudhe të përshtatshme njoftimi paraprak.¹⁹³

I. PARASHTRIMET PLOTËSUESE TË THAÇIT DHE PARASHTRIME TË LIDHURA ME TO

96. Mbrojtja e Thaçit parashtron se gjatë hetimeve të saj ka zbuluar se disa dëshmitarë të identifikuar në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së nuk kishin dijeni që ZPS-ja kishte vendosur dhe kishte njoftuar zyrtarisht Gjykatësin e Procedurës Paraprake, palët dhe Mbrojtësin e Viktimave, se synon t'i thërrasë ata si dëshmitarë në çështjen aktuale.¹⁹⁴ Sipas Mbrojtjes së Thaçit, në kërkimin e masave mbrojtëse shtesë, ZPS-ja nuk ka përmbushur rregullën 80(2) të Rregullores, sepse nuk ka marrë pëlqimin e dëshmitarëve për masat shtesë të propozuara prej saj.¹⁹⁵

97. ZPS-ja përgjigjet se Parashtrimet Plotësuese të Thaçit duhen hedhur poshtë menjëherë.¹⁹⁶ Sipas ZPS-së, këto parashtrime u dorëzuan jashtë afateve ligjore për dorëzimin e parashtrimeve dhe kalendarit të seancave.¹⁹⁷ ZPS-ja shton se nuk ka informacion se për kë e ka fjalën Mbrojtja e Thaçit dhe se ZPS-ja nuk e paraqet kornizën e propozuar vetëm si masë mbrojtëse.¹⁹⁸

98. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk mund të pretendojë se po kërkon imponimin e kornizës së propozuar “për të shmangur ritraumatizimin e viktimave-dëshmitarë dhe për të mbrojtur privatësinë, dinjitetin dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike të tyre,” ndërkohë që nuk i ka pyetur dëshmitarët nëse pranojnë që ZPS-ja të jetë e pranishme gjatë intervistimit të tyre nga Mbrojtja,

¹⁹³ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1038-1039.

¹⁹⁴ Parashtrimet Plotësuese të Thaçit, para. 10.

¹⁹⁵ Parashtrimet Plotësuese të Thaçit, para. 12.

¹⁹⁶ Parashtrimet e ZPS-së ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, para. 1.

¹⁹⁷ Parashtrimet e ZPS-së ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, para. 2.

¹⁹⁸ Parashtrimet e ZPS-së ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, para. 4-5.

madje as nuk u ka thënë se janë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së.¹⁹⁹ Ajo shton se ZPS-ja mbështetet në *lex generalis*, konkretisht në nenin 39(1) të Ligjit, i cili nuk mund të zëvendësojë *lex specialis*, konkretisht nenin 23 të Ligjit, i cili e bën të qartë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të zbatojë rregullën 80 të Rregullores.²⁰⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

99. Sipas nenit 21(2) të Ligjit, në përcaktimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën për seanca të drejta dhe publike, në varësi të nenit 23 të Ligjit dhe masave të urdhëruara nga Dhomat e Specializuara për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

100. Sipas nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullës 80(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave dhe, *proprio motu* ose në bazë të kërkesës, mund të urdhërojë masa të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë nga dëshmitarët, me kusht që masat të jenë në pajtim me të drejtat e të akuzuarit.

101. Sipas nenit 35(2)(f) të Ligjit, kompetencat dhe përgjegjësitë e Prokurorit të Specializuar dhe të prokurorëve të tjerë të ZPS-së përfshijnë marrjen e masave të nevojshme, apo kërkimin e marrjes së masave të nevojshme, për të siguruar konfidencialitetin e informacionit, mbrojtjen e çdo personi, ose ruajtjen e provave.

102. Sipas nenit 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë të nxjerrë çdo urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

¹⁹⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, para. 1.

²⁰⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, para. 2-7.

103. Sipas nenit 39(11) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, mund të sigurojë mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe të dëshmitarëve, dhe ruajtjen e provave.

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTE PARAPRAKE

1. Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj Mbrojtësit të Viktimave

104. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Urdhrin e 21 Janarit 2022, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave u urdhëruan konkretisht që t'u përgjigjeshin Parashtrimeve të Zyrës Administrative nëse dëshironin.²⁰¹ Rrjedhimisht, Urdhri i 21 Janarit 2022 nuk u dha palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave mundësinë që të paraqitnin parashtrime të mëtejshme në lidhje me parashtrimet e ZPS-së, Përgjigjen e Mbrojtësit të Viktimave dhe/ose Përgjigjet e Mbrojtjes. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, që trajton disa parashtrime të caktuara që rrjedhin nga Përgjigjet e Mbrojtjes dhe nuk u përgjigjet Parashtrimeve të Zyrës Administrative, i tejkalon parametrat e përcaktuar në Urdhrin e 21 Janarit 2022.

105. Gjithashtu, në Vendimin e 16 Shkurtit 2022 për mbajtjen e një seance, krahas urdhrit që palët të jepnin përgjigje për disa pyetje të caktuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u lejoi palëve dhe pjesëmarrësve të paraqisnin parashtrime edhe për aspekte të tjera që buronin drejtpërdrejt nga parashtrimet e ZPS-së, me kusht që ato të mos ishin trajtuar më parë në parashtrimet me shkrim të tyre.²⁰² Kjo do të thotë se argumentet e paraqitura në Përgjigjen e Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave mund të ishin paraqitur në mënyrë të vlefshme në seancën e 22 shkurtit 2022.

²⁰¹ Urdhri i 21 Janarit 2022, para. 6.

²⁰² Vendimi i 16 Shkurtit 2022, para. 12.

106. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është e nevojshme që Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave të hiqet nga dokumentacioni i çështjes dhe hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për këtë. Megjithatë, duke marrë parasysh se Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave i tejkalon parametrat e Urdhrit të 21 Janarit 2022, argumentet e paraqitura në të nuk do të merren parasysh në kuadër të vendimit aktual, përveç nëse Mbrojtësi i Viktimave i paraqiti ose u pajtua konkretisht me to gjatë seancës së 22 shkurtit 2022.

2. Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së

107. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, krahas përgjigjeve ndaj disa aspekteve të caktuara të Përgjigjes së Mëtejshme të ZPS-së dhe Përgjigjes së Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave,²⁰³ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së përsërit dhe/ose specifikon parashtrime të caktuara të paraqitura në Përgjigjen e Thaçit në lidhje me Parashtrimet e ZPS-së.²⁰⁴

108. Bazuar në arsyet e përmendura në lidhje me Përgjigjen e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se edhe Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së i tejkalon parametrat e Urdhrit të 21 Janarit 2022. Megjithatë, për të njëjtat arsye të evidentuara në lidhje me Përgjigjen e Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, ndonëse nuk është e nevojshme që Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së të hiqet nga dokumentacioni i çështjes, parashtrimet përkatëse nuk do të merren parasysh në kuadër të vendimit aktual, përveç nëse Mbrojtja e Thaçit i paraqiti ose u pajtua konkretisht me to gjatë seancës së 22 shkurtit 2022.

²⁰³ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së, para. 7, 18-21.

²⁰⁴ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj ZPS-së, para. 4-5, 8-17; Përgjigjja e Thaçit, para. 12-13, 18-24, 33, 35.

3. Parashtrimet Plotësuese të Thaçit

109. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se Mbrojtja e Thaçit: (i) iu përgjigj parashtrimeve të ZPS-së në përputhje me rregullën 76 të Rregullores; (ii) iu përgjigj parashtrimeve të Zyrës Administrative në pajtim me Urdhrin e 21 Janarit 2022; dhe (iii) u autorizua të bënte parashtrime me gojë në vijim të Vendimit të 16 Shkurtit 2022.

110. Mbrojtja e Thaçit nuk ka paraqitur bazën ligjore ku e mbështet paraqitjen e parashtrimeve plotësuese dhe as nuk ka kërkuar lejen e nevojshme për paraqitjen e tyre.²⁰⁵ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Parashtrimet Plotësuese të Thaçit nuk do të shqyrtohen më tej sepse nuk bazohen në tekstet ligjore të DHS-së dhe nuk u përmbahen afateve të lartpërmendura për dorëzimin e parashtrimeve. Kjo vlen, rrjedhimisht, edhe për Përgjigjen e ZPS-së ndaj Parashtrimeve Shtesë të Thaçit dhe për Kundërpërgjigjen e Thaçit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, për aq sa këto dy parashtrime lidhen me themelësinë e aspektit nën shqyrtim.

B. KORNIZA E PROPOZUAR

111. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në Përgjigjen e Mëtejshme të saj, ZPS-ja propozon disa ndryshime në kornizën e propozuar në Parashtrimet e ZPS-së.²⁰⁶ Ndërsa Mbrojtësi i Viktimave dhe Zyra Administrative nuk kanë kundërshtime për ndryshimet e propozuara,²⁰⁷ ekipet e Mbrojtjes nuk kanë shprehur qëndrimin e tyre konkretisht në lidhje me to dhe përgjithësisht u përmbahet kundërshtimeve të paraqitura ndaj kornizës së propozuar. Në këto rrethana, në kuadër të këtij vendimi Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta

²⁰⁵ *Shih për shembull, KSC-BC-2020-06, F00326, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Leje për Kundërpërgjigje Shtesë, 28 maj 2021, publik, para. 5-6.*

²⁰⁶ Përgjigja e Mëtejshme e ZPS-së, para. 5-6.

²⁰⁷ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 979-980, 1038-1039, 1043.

shqyrtojë kornizën e propozuar vetëm mbi bazën e ndryshimeve të propozuara. Kjo do të thotë gjithashtu që Gjykatësi i Procedurës do të shqyrtojë vetëm ato pjesë të Parashtrimeve të Mbrojtjes që lidhen me kornizën e propozuar në kuadër të Përgjigjes së Mëtejshme të ZPS-së.²⁰⁸

112. Gjithashtu, sa i takon Kërkesës së Mbrojtjes që palët të udhëzohen të kryejnë diskutime *inter partes* lidhur me kornizën e propozuar,²⁰⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse ZPS-ja, Mbrojtësi i Viktimave dhe disa ekipe të Mbrojtjes informojnë se në parim janë të gatshëm të bëjnë diskutime *inter partes*, qëndrimet përkatëse të tyre janë shumë larg njëri-tjetrit.²¹⁰ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të nevojshme të nxjerrë vendim mbi Parashtrimet e ZPS-së dhe, për këtë arsye, hedh poshtë Kërkesën e Mbrojtjes.

113. Pasi ka bërë këto sqarime, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të trajtojë: (i) bazën ligjore dhe fushëveprimin e kornizës së propozuar; (ii) argumentet e Mbrojtjes për rrjedhojat e kornizës së propozuar mbi të drejtën për gjykim të drejtë; dhe (iii) aspektet specifike të kornizës së propozuar që nuk u trajtuan gjatë diskutimeve të lartpërmendura dhe të cilat ose janë objekt mospajtimi, ose kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm.

1. Baza ligjore dhe fushëveprimi

114. ZPS-ja parashtron se korniza e propozuar: (i) bazohet në nenet 21(4), 23, 35, 38, dhe 39(1), (3), (11) dhe (13) të Ligjit, rregullat 80, 82, 83 dhe 95(2) të Rregullores, dhe nenet 6, 12, 14 dhe 17 të Kodit të Etikës; dhe (ii) përfshin të gjithë dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së.²¹¹ Nga ana tjetër, Mbrojtja parashtron: (i) ose që korniza e propozuar nuk ka bazë ligjore, ose që ZPS-ja e bazon atë në

²⁰⁸ Përgjigjja e Thaçit, para. 33; Përgjigjja e Selimit, para. 45-46; Përgjigjja e Veselit, para. 31.

²⁰⁹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 4-5, 8, 24; Përgjigjja e Veselit, para. 4, 34-35.

²¹⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 970, 980, 1036-1037.

²¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 3, 4, 6, 7; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 965-967, 969-970, 973, 1040-1042.

rregullën 80 të Rregullores; dhe/ose (ii) korniza e propozuar duhet të hidhet poshtë, ose duhet të zbatohet vetëm për dëshmitarët (me status të dyfishtë) në lidhje me të cilët janë autorizuar masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores.²¹² Rrjedhimisht, në fillim Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të përcaktojë bazën ligjore dhe fushëveprimin e kornizës së propozuar.

115. Në bazë të nenit 35(2)(f) të Ligjit, ZPS-ja ka kompetencë dhe përgjegjësi të kërkojë marrjen e masave të nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e informacionit, mbrojtjen e çdo personi, apo ruajtjen e provave. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetenca dhe funksione për lëshimin e urdhrave të nevojshëm për të siguruar përgatitjen siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë të çështjes për gjykim sipas nenit 39(1) të Ligjit, si edhe mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave sipas nenit 39(11) të Ligjit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se këto dispozita ofrojnë bazën ligjore për urdhërimin e masave të përgjithshme lidhur me trajtimin e informacionit konfidencial dhe rregullimin e kontakteve me dëshmitarët, siç përcaktohet në vijim.

(a) Funksionet e kornizës së propozuar

(i) Funksioni mbrojtës

116. Korniza e propozuar siguron mbrojtjen e dëshmitarëve përmes përcaktimit të procedurës së përshtatshme për kontaktet midis Mbrojtjes dhe dëshmitarëve në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarëve të tjerë të njoftuar,²¹³ dhe mundësimin që dëshmitarët të kërkojnë ndihmë në lidhje me ato kontakte. Duke qenë se Mbrojtja ngre argumente lidhur me kontaktet e saj me dëshmitarët e ZPS-

²¹² Përgjigjja e Thaçit, para. 3, 13, 24, 25; Përgjigjja e Selimit, para. 2, 7, 17-21; Përgjigjja e Krasniqit, para. 7, 11, 14; Përgjigjja e Veselit, para. 15; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 986-987, 1001-1002, 1003, 1006-1008, 1013-1018, 1026-1030, 1033, 1053-1056, 1060, 1061-1062.

²¹³ *Shih* paragrafët 183-185 më poshtë.

së, vendimi aktual e shqyrton kornizën e propozuar veçanërisht në lidhje me Mbrojtjen. Megjithatë, duke qenë se mbrojtja e dëshmitarëve ka të bëjë në parim të gjithë dëshmitarët, korniza e propozuar do të zbatohet në lidhje me të gjithë dëshmitarët në këtë çështje dhe kontaktet e tyre me palët dhe pjesëmarrësit jothirrës.

117. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se përgjegjësia e përgjithshme e ZPS-së dhe funksioni i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarëve sipas nenit 39(11) të Ligjit nuk përfundon me masat e urdhëruara sipas rregullës 80 të Rregullores. Sipas këtij neni, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të urdhërojë masa për mbrojtjen dhe privatësinë e dëshmitarëve “kur është e nevojshme”, duke përcaktuar shprehimisht se ky funksion përfshin ushtrimin e diskrecionit gjyqësor. Rrjedhimisht, korniza e propozuar nuk përbën një kërkesë të tërthortë për masa shtesë apo të reja në bazë të rregullës 80 të Rregullores.

118. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimet e përsëritura për ekzistencën e atmosferës së frikësimit dhe ndërhyrjeve ndaj dëshmitarëve në lidhje me proceset penale që kanë të bëjnë me ish-anëtarë të UÇK-së,²¹⁴ dhe se të akuzuarit në çështjen aktuale, që kanë qenë anëtarë me funksione të larta në UÇK dhe kanë mbajtur poste të tjera me ndikim, vazhdojnë të kenë influencë të konsiderueshme.²¹⁵ Korniza e propozuar shërben për të siguruar që, në këto

²¹⁴ *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07, F00611, Trupi Gjyqësor II, Aktgjykim, 18 maj 2022, konfidencial, me Shtojcat 1-3, publike, para. 576-578 (versioni i redaktuar publik doli po atë ditë, F00611/RED).

²¹⁵ *Shih për shembull*, KSC-BC-2020-06, F00818, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin Periodik të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 26 maj 2022, konfidencial, para. 37, 45 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 qershor 2022, F00818/RED); F00819, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin Periodik të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 26 maj 2022, konfidencial, para. 27, 33 (versioni i redaktuar publik doli më 8 qershor 2022, F00819/RED); F00801, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin Periodik të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 13 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 42, 50 (versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik dolën përkatësisht më 13 maj 2022 dhe 24 maj 2022, F00801/CONF/RED dhe F00801/RED); F00802, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin Periodik të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 13 maj 2022, konfidencial, para. 27, 32 (versioni i redaktuar publik doli më 24 maj 2022, F00802/RED).

rrethana, kontaktet midis Mbrojtjes dhe dëshmitarëve në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe të dëshmitarëve të tjerë të njoftuar të rregullohen në mënyrën e duhur. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh masat mbrojtëse të individualizuara, të urdhëruara për një numër të konsiderueshëm dëshmitarësh në këtë çështje gjyqësore. Korniza e propozuar ofron gjithashtu një shkallë mbrojtjeje të përshtatshme për këta individë edhe pas heqjes së masave dhe në vijim, duke pasur parasysh atmosferën e ndërhyrjeve dhe faktin që të akuzuarit vazhdojnë të kenë influencë.

119. Gjithashtu, është me rëndësi të posaçme që korniza e propozuar të zbatohet vetëm me kërkesë të dëshmitarëve dhe se, sikurse përcaktohet më poshtë, mundësia që ZPS-ja të veprojë në kundërshtim me parapëlqimin e dëshmitarëve të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor. Këto masa do të sigurojnë që mbrojtja e ofruar nga korniza e propozuar të përfshijë vetëm personat që do ta kërkojnë vetë atë mbrojtje.

120. Mbrojtja argumenton në veçanti se dëshmitarët ndërkombëtarë (në poste të larta) apo ata që nuk janë të rrezikuar, nuk duhet të përfshihen në kornizën e propozuar.²¹⁶ Megjithatë, thjesht fakti që dëshmitari nuk ka shprehur frikë deri tani, ose se ka profil ndërkombëtar dhe/ose ka pasur post të lartë, nuk vërteton në vetvete se personi nuk duhet të lejohet të kërkojë mbrojtje sipas kushteve të kornizës së propozuar, duke pasur parasysh faktorët e lartpërmendur. Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm dëshmitarësh ndërkombëtarë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së, në fakt nuk kishin poste të larta në periudhën në fjalë. Në këto rrethana, korniza e propozuar ofron një shkallë mbrojtjeje që është proporcionale me shqetësimet e sigurisë të konstatuara në çështjen në fjalë, me garancitë e përshtatshme mbrojtëse.

²¹⁶ Përgjigja e Thaçit, para. 29-30; Përgjigja e Krasniqit, para. 14; Përgjigja e Veselit, para. 26-28; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 983-985, 1003, 1017, 1028-1030.

(ii) Privatësia

121. Krahas kësaj, korniza e propozuar mbron edhe privatësinë e të gjithë dëshmitarëve në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe të dëshmitarëve të tjerë të njoftuar. Në këtë kuadër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se neni 39(11) i Ligjit nuk përcakton vetëm garantimin e mbrojtjes së dëshmitarëve, por edhe të privatësisë së tyre. Rrjedhimisht, fushëveprimi i kësaj dispozite përrupthet me dispozitën parësore mbi mbrojtjen e dëshmitarëve, konkretisht, nenin 23(1) të Ligjit, ku përkufizimi i vlerave të mbrojtura është lënë i hapur (“përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre”) dhe jepet një listë joshteruese masash mbrojtëse (“këto masa mbrojtëse përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në mjetet e përcaktuara në nenet 221-226 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123, nenet 5-13 të Ligjit nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, zhvillimin e procedurave me dyer të mbyllura, paraqitjen e provave me mjete elektronike ose mjete të tjera të veçanta, dhe mbrojtjen e identitetit”).

122. Rregulla 30(2)(b) e Rregullores përcakton që gjatë hetimit të një vepre penale, Prokurori i Specializuar garanton, ndër të tjera, mbrojtjen e privatësisë së cilitdo personi. Marrja në pyetje e individëve nga ZPS-ja, në veçanti e atyre që pretendojnë se kanë qenë viktimë të krimeve dhe atyre që dyshohen se kanë kryer krime brenda juridiksionit të DHS-së, mund të zbulojë të dhëna personale, si edhe informacion të ndjeshëm lidhur me veprimtari kriminale të pretenduara, që kanë ose jo lidhje me çështjen konkrete. Individët që kanë dhënë informacion që mund të përdoret në procesin aktual pasi janë marrë në pyetje nga ZPS-ja, rrjedhimisht kanë të drejtën e pritshmërisë së arsyeshme që ZPS-ja të mbrojë privatësinë e tyre në lidhje me atë informacion. Në të njëjtën kohë, kjo pritshmëri duhet balancuar me të drejtën e të akuzuarve për gjykim të drejtë.

123. Rrjedhimisht, korniza e propozuar, duke përcaktuar që kontaktet midis dëshmitarëve dhe Mbrojtjes iniciohen përmes ZPS-së dhe duke përcaktuar rolin e ZPS-së në çdo intervistë vijuese të kryer nga Mbrojtja, garanton që dëshmitarët të vazhdojnë të kenë pritshmërinë e mbrojtjes së privatësisë së tyre nga ZPS-ja si edhe që çdo kufizim i privatësisë së tyre i shërben qëllimit legjitim që të akuzuarit të lejohen të ushtrojnë të drejtën e tyre për gjykim të drejtë.

(iii) Ruajtja e provave

124. Korniza e propozuar mundëson gjithashtu ruajtjen e provave, krijon dokumentacion transparent dhe të disponueshëm të intervistave të kryera nga Mbrojtja me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar, si edhe të intervistave të kryera nga ZPS-ja me dëshmitarët në listat e dëshmitarëve të Mbrojtjes. Duke pasur parasysh rreziqet e konstatuara se Mbrojtjes mund t'i nxirren të dhëna të caktuara në lidhje me dëshmitarë për të cilët janë miratuar masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, si edhe atmosferën e ndërhyrjeve, ky dokumentacion ndihmon në vlerësimin e pretendimeve për ndërhyrje.

(iv) Kryerja e shpejtë e procesit

125. Së fundi, duke marrë parasysh se trajtimi i informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontakteve me dëshmitarët që do të thirren nga pala kundërshtare nuk janë përcaktuar konkretisht në tekstet ligjore të zbatueshme në DHS, korniza e propozuar kontribuon në kryerjen e shpejtë të procesit, sepse konkretizon detyrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve, përcakton një procedurë të parashikueshme dhe përputhëse për t'u ndjekur, si dhe qartëson rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha njësive dhe organeve të DHS-së të përfshira në proces.

(b) Protokoll i GJPN-së

126. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se interpretimi i mësipërm i kornizës ligjore të DHS-së mbështetet nga Protokoll i GJPN-së. Arsyeja është se, në ndryshim nga TPNJ-ja, TPNR-ja dhe TSL-ja, Protokoll i GJPN-së mbështetet në një bazë ligjore pothuaj identike. Zbatimi i nenit 57(3)(c) të Statutit të Romës – që i jep kompetencë Dhomës së Procedurës Paraprake, ndër të tjera, të sigurojë mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave – së bashku me nenin 68(1) të Statutit të Romës – që përcakton detyrimin e mbarë gjykatës për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e viktimave dhe të dëshmitarëve – tregon se edhe Protokoll i GJPN-së i tejkalon kufijtë e zbatimit të masave mbrojtëse të kornizës ligjore të GJPN-së.²¹⁷ Kjo konfirmohet nga qëllimi i shprehur i Protokollit të GJPN-së, konkretisht, mbrojtja e sigurisë së dëshmitarëve, viktimave dhe individëve të tjerë të rrezikuar, si edhe e integritetit të hetimeve.²¹⁸

127. Në këto rrethana, ndonëse i vetëdijshëm për dallimet relevante, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në përgjithësi, Protokoll i GJPN-së ofron një

²¹⁷ *Shih gjithashtu*, Guariglia, F. dhe Hochmayr, G., “Article 57. Functions and Powers of the Pre-Trial Chamber” in Triffterer, O. and Ambos, K. (eds.), *The Rome Statute of the International Criminal Court. A Commentary*, Beck/Hart 2022, p. 1703 (“një krahasim me formulimin e nënparagrafëve (a) dhe (b) [të nenit 57(3) të Statutit të Romës], sipas të cilëve Prokurori ose respektivisht Mbrojtja duhet të paraqesin kërkesë, së bashku me përdorimin e fjalëve ‘kur është e nevojshme’, sugjeron se të paktën disa prej këtyre funksioneve Dhoma e Procedurës Paraprake mund t’i kryejë *ex officio*”); Donat Cattin, D., “Article 68. Protection of Victims and Witnesses and their Participation in the Proceedings” in Triffterer O. and Ambos K. (eds.), *The Rome Statute of the International Criminal Court. A Commentary*, Beck/Hart 2022, pp. 2010-2011: (“termi *masa të përshtatshme*, ndër të tjera, interpretohet se përfshin të gjitha masat e renditura në rregullën 87 (*Masat mbrojtëse*), në rregullën 88 (*Masat e posaçme*) dhe në rregullën 112(4) (*Incizimi i marrjes në pyetje në raste të veçanta*) të Rregullores së Procedurës dhe Provave, në rregullat 21, 41, 42 dhe 101 të Rregullores së Punës të Gjykatës dhe në rregullat 79 dhe 100 të Rregullores së Zyrës Administrative, si edhe çdo organizim tjetër me përdorim të teknologjisë novatore apo që bazohet në metodat e mbrojtjes së viktimave të eksperimentuara në sistemet gjyqësore shtetërore. Karakteri joshterues i kësaj dispozite lidhur me masat e përshtatshme përfordhet nga fakti që ky paragraf u njeh individëve një numër të drejtash të individëve që duhen mbrojtur, ku secila prej tyre përfshin një spektër të gjerë rrethanash. *Siguria, mirëqenia fizike dhe psikologjike* dhe, në veçanti, *dinjiteti* i secilës viktimë apo dëshmitar mbulojnë të gjitha fushat e të drejtave njerëzore të patjetërsueshme të përcaktuara në instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare” [theksimi në origjinal).

²¹⁸ ICC Protocol, para. 1.

model të përshtatshëm udhëzues për kornizën e propozuar, varësisht modifikimeve të nevojshme që burojnë nga veçoritë e procesit aktual.

(c) Argumentet e Mbrojtjes

128. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se përfundimet e mësipërme nuk ndikohen nga pjesa tjetër e argumenteve të Mbrojtjes.

129. Së pari, Mbrojtja parashtron se është e arsyeshme të pritet që korniza e propozuar të ishte parashikuar në kornizën ligjore të zbatueshme, sepse garancitë minimale që u akordohen të akuzuarve në bazë të nenit 21(4) të Ligjit mund të kufizohet vetëm me ligj.²¹⁹ Megjithëse aspekti nëse korniza e propozuar është në përputhje me të drejtën e të akuzuarve për gjykim të drejtë do të trajtohet më hollësisht më poshtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se tashmë është konstatuar se korniza e propozuar ka bazë konkrete në Ligj. Gjithashtu, ashtu si në vendime të tjera kornizë,²²⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencën të konkretizojë disa procedura të caktuara që nuk janë përcaktuar shprehimisht në Ligj apo në Rregullore. Në këto rrethana, fakti që korniza e propozuar nuk përfshihet shprehimisht në tekstet ligjore nuk ka rëndësi.

130. Së dyti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se argumenti i Mbrojtjes se korniza ligjore ekzistuese e DHS-së e bën të panevojshme kornizën e propozuar, nuk qëndron.²²¹ Sa u takon argumenteve që bazohen në Kodin e Etikës apo zotime të ngjashme,²²² neni 3(1) i Kodit të Etikës përcakton shprehimisht se ai interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Kushtetutën, Ligjin dhe Rregulloren.

²¹⁹ Përgjigjja e Veselit, para. 14.

²²⁰ *Shih për shembull*, KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me Të*, 23 nëntor 2020, publik; F00159, *Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 4 janar 2021, publik.

²²¹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 9; Përgjigjja e Veselit, para. 16-17.

²²² Përgjigjja e Thaçit, para. 36; Përgjigjja e Selimit, para. 3, 26-33; Përgjigjja e Krasniqit, para. 9; Përgjigjja e Mëtejshme e Thaçit, para. 9.

Nuk mund të mbështetesh *a fortiori* në zotime të ngjashme për të devijuar nga burimet e lartpërmendura. Rrjedhimisht, duhet që detyrimet e palëve dhe pjesëmarrësve në fushat nën shqyrtim të specifikohen në bazë të burimeve ligjore parësore në kontekstin e procesit aktual. Gjithashtu, dhe më përgjithësisht, është me rëndësi thelbësore të sigurohet që të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve në lidhje me këto aspekte të jenë mjaftueshmërisht të mirëpërkufizuara, për shkak të rëndësisë që kanë.

131. Së treti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është bindur nga parashtrimet e Mbrojtjes se: (i) Urdhri në Çështjen Guçati dhe Haradinaj nuk është i zbatueshëm në këtë çështje; (ii) as në çështje të tjera në DHS, dhe as në TPNJ, TPNR dhe/ose TSL nuk është miratuar ndonjë variant i kornizës së propozuar; dhe/ose (iii) tribunalët në fjalë kanë miratuar vetëm disa kufizime të caktuara lidhur me intervistat me dëshmitarët në kontekstin e kërkesave për masa mbrojtëse.²²³ Qasjet e përdorura në procese të tjera të DHS-së dhe/ose tribunalë të tjerë janë specifike për çështjet gjyqësore në ata tribunalë dhe, si të tilla, nuk zhvleftësojnë përfundimin se korniza ligjore e DHS-së lejon miratimin e kornizës së propozuar nga ZPS-ja, aq më tepër sepse, siç u përmend, neni 39(11) i Ligjit përfshin edhe ushtrimin e diskrecionit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në lidhje me sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

132. Së katërti, sa i takon parashtrimin të Mbrojtjes se vendimi lidhur me miratimin e kornizës së propozuar duhet të merret nga Trupi Gjyqësor,²²⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se kalimi i kësaj kompetence tek Trupi Gjyqësor do të ishte në kundërshtim me nevojën për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim sipas nenit 39(1) të Ligjit, duke pasur parasysh faktin që emrat e dëshmitarëve, ndër të cilët edhe një numër

²²³ Përgjigjja e Thaçit, para. 25-28; Përgjigjja e Selimit, para. 22-23; Përgjigjja e Krasniqit, para. 6, 12-13; Përgjigjja e Veselit, para. 6-12; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1009-1010, 1036.

²²⁴Përgjigjja e Krasniqit, para. 6, 10.

dëshmitarësh të mbrojtur, tashmë i janë bërë të ditur Mbrojtjes e cila ka konfirmuar se ka filluar hetimet e saj.²²⁵

133. Së pesti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se argumenti i Mbrojtjes që dëshmitarët nuk i përkasin ZPS-së nuk është relevant.²²⁶ Mbrojtja bazohet në një vendim të TPNJ-së mbi kërkesën e një ekipi të mbrojtjes për qasje në të dhënat e kontaktit të individëve që prokuroria e TPNJ-së kishte vendosur të mos i thërriste si dëshmitarë,²²⁷ që nuk është rasti në procesin aktual. Më përgjithësisht, pyetja relevante është nëse nenet 35(2)(f) dhe 39(1) dhe (11) të Ligjit ofrojnë bazën për të urdhëruar kornizën e propozuar dhe, rrjedhimisht, ekzistenca apo mungesa e ‘pronësisë’ mbi dëshmitarin nuk është përcaktuese.

134. Së fundi, kundërshtimi i Protokollit të GJPN-së nga Mbrojtja nuk i shërben asnjë qëllimi. Kushtet e Protokollit të GJPN-së nuk përmbajnë asnjë tregues se ai u hartua posaçërisht për t’u përdorur vetëm në çështje gjyqësore më të vogla krahasuar me çështjen aktuale, apo vetëm në kontekstin e një konflikti të armatosur që vazhdon dhe jo si në këtë rast, pas përfundimit të konfliktit.²²⁸ Gjithashtu, parashtrimi i Mbrojtjes se GJPN-ja nuk ka detyrimin të respektojë KEDNJ-në nuk është tërësisht i saktë, duke marrë parasysh se interpretimi dhe zbatimi i kornizës ligjore të saj duhet të jetë në përputhje me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht në bazë të nenit 21(3) të Statutit të Romës.²²⁹ Gjithashtu, kur argumenton se Protokollit i GJPN-së funksionon në kontekstin e një sistemi

²²⁵Përgjigjja e Krasniqit, para. 9; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 985, 1020.

²²⁶Përgjigjja e Thaçit, para. 12; Përgjigjja e Selimit, para. 35-36; Përgjigjja e Krasniqit, para. 12; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 983, 1009-1010, 1036.

²²⁷ ICTY, *Prosecutor v. Lukić and Lukić*, IT-98-3211-T, Decision on Milan Lukić's Motion to Compel Disclosure of Contact Information and on the Prosecution's Urgent Motion to Compel Production of Contact Information, 30 March 2009, para. 23-24.

²²⁸ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1008-1009, 1035-1036.

²²⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 992, 993, 994-995. *Shih*, në veçanti, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-772, Judgment on the Appeal of Mr. Thomas Lubanga Dyilo against the Decision on the Defence Challenge of the Jurisdiction to the Court Pursuant to Article 19(2) of the Statute of 3 October 2006, 14 December 2006, para. 37.

ligjor në të cilin ka “pronësi” të pretenduar mbi dëshmitarët,²³⁰ Mbrojtja nuk merr parasysh se GJPN-ja ka konstatuar shprehimisht që dëshmitarët nuk i përkasin asnjë pale.²³¹ Sidoqoftë, sikundër u përmend, ky faktor nuk është relevant.

(d) Përfundim

135. Në përfundim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se korniza e propozuar: (i) e ka bazën në efektin e përbashkët të neneve 35(2)(f) dhe 39(1) dhe (11) të Ligjit; dhe (ii) përfshin të gjithë dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar, si dhe dëshmitarët në listën e Mbrojtjes, në qoftë se Mbrojtja do të vendosë të paraqesë prova.

136. Nga kjo rrjedh se korniza e propozuar faktikisht nuk përbën kërkesë për masa shtesë apo masa të reja mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores lidhur me dëshmitarët për të cilët tashmë janë miratuar këto masa, apo kërkesë për masë mbrojtëse gjithëpërfshirëse për të gjithë dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar, në bazë të së njëjtës rregull. Nga ky përfundim rrjedh edhe se nuk ka bazë që fushëveprimi i kornizës së propozuar të përfshijë vetëm dëshmitarët për të cilët janë autorizuar masa sipas rregullës 80 të Rregullores.

²³⁰ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1009-1010.

²³¹ *Shih, për shembull, ICC, Prosecutor v. Lubanga, ICC-01/04-01/06-1049, Trial Chamber I, Decision Regarding the Practices Used to prepare and Familiarise Witnesses for Giving Testimony at Trial, 30 November 2007, para. 34; Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui, ICC-01/04-01/07-428-Corre-Trial Chamber I, Corrigendum in the Decision on Evidentiary Scope of the Confirmation Hearing, Preventive Relocation and Disclosure under Article 67(2) of the Statute and Rule 77 of the Rules, 25 April 2008, para. 30; Prosecutor v. Muthaura et al., ICC-01/09-02/11-38, Pre-Trial Chamber II, Decision on Variation of Summons Conditions, 4 April 2011, para. 10.*

2. E drejta për gjykim të drejtë

137. Pavarësisht nga përfundimi se korniza propozuar bazohet në Ligj dhe u shërben qëllimeve të përshkruara më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i vetëdijshëm për faktin se ajo duhet gjithashtu të respektojë të drejtat e të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit dhe sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sikurse përcaktohet në nenin 3(2)(e) të Ligjit.²³² Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të trajtojë tani argumentet e Mbrojtjes që pretendojnë se korniza e propozuar shkel disa përbërës të së drejtës për gjykim të drejtë.

(a) Barazia e palëve

138. GJEDNJ-ja ka konstatuar se, sipas parimit të barazisë së palëve, çdo pale duhet t'i jepet mundësi e arsyeshme të paraqesë provat e veta në kushte që nuk e vënë në pozitë të pafavorshme kundrejt palës kundërshtare.²³³ Mbrojtja bën një numër parashtrimesh bazuar në këtë parim.

139. Së pari, Mbrojtja parashtron se, edhe pse dëshmitarët nuk i përkasin ZPS-së, ZPS-ja ka mundur të kryejë intervista me dëshmitarët pa praninë e përfaqësuesve të Mbrojtjes, ndërsa Mbrojtja nuk do të jetë në të njëjtën pozitë, sepse nuk mund t'i intervistojë dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së në mungesë të përfaqësuesve të ZPS-së.²³⁴

140. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se ky argument keqinterpretton Ligjin sa i përket përgjegjësive të ZPS-së dhe të Mbrojtjes. Sikurse pasqyrohet në nenin 1(2) të Ligjit, akuzat që lidhen Raportin e Këshillit të Evropës u hetuan nga Task Forca Hetimore Speciale ("TFHS"). ZPS-ja mori mandatin e

²³² *Shih* Përgjigjja e Selimit, para. 6-9.

²³³ ECtHR, *Foucher v. France*, no. 22209/43, Judgment, 18 March 1997, para. 34; *Öcalan v. Turkey [GC]*, no. 46221/99, Judgment, 12 May 2005, para. 140.

²³⁴ Përgjigjja e Thaçit, para. 12, 17; Përgjigjja e Selimit, para. 11-13, 35-37; Përgjigjja e Krasniqit, para. 12, 23; Përgjigjja e Veselit, para. 20-21; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 987.

TFHS-së në bazë të nenit 24(2) të Ligjit dhe është përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për krime që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, sipas neneve 35(1) dhe 38(1) të Ligjit. Ky mandat, sidomos gjatë kohës kur u zbatua nga TFHS-ja, domosdoshmërisht përmban elementë të përgjithshëm, sepse përfshin edhe akuza që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës në tërësi. Sikurse nënkuptohet nga nenet 21(4)(e), 38(4) dhe 39(1)-(4) të Ligjit, përgjegjësitë e Mbrojtjes vetvetiu kufizohen brenda kuadrit të një çështjeje gjyqësore të caktuar, dhe ushtrimi i tyre përgjithësisht fillon pas konfirmimit të aktakuzës kundër një të akuzuari të caktuar. Bazuar në këtë ndarje të përgjegjësive, nuk mund të argumentohet se Mbrojtjes duhet t'i ishte dhënë mundësia të ishte e pranishme gjatë intervistave me dëshmitarët në kuadër të hetimeve të TFHS-së dhe/ose të ZPS-së. Për të njëjtën arsye, fakti që hetimet e Mbrojtjes përgjithësisht kanë kuadër të kufizuar, nuk ka rëndësi lidhur me këtë aspekt.²³⁵

141. Fakti që dëshmitarët nuk i përkasin një pale të caktuar nuk ka ndikim në përfundimin e mësipërm. Në këtë kuadër konsiderata kryesore është që, për arsyet e paraqitura më lart, korniza e propozuar shërben, ndër të tjera, për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ruajtjen e privatësisë së tyre. Për rrjedhojë, ekzistenca ose mungesa e 'pronësisë' mbi dëshmitarët nuk mund të mbështesë pretendimin se, sipas parimit të barazisë së palëve, Mbrojtja duhet patjetër të lejohet të intervistojë dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar.

142. Lidhur me këtë argument, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja pretendon gjithashtu që integriteti i sistemit është cenuar ngaqë Mbrojtja nuk ishte e pranishme gjatë intervistave të ZPS-së me dëshmitarët dhe se ZPS-ja mund t'i klasifikojë dëshmitarët e Mbrojtjes si dëshmitarë të mundshëm të ZPS-së me qëllim që të sigurojë praninë e saj në intervistat e Mbrojtjes.²³⁶ Megjithatë, në

²³⁵ Përgjigjja e Selimit, para. 14.

²³⁶ Përgjigjja e Thaçit, para. 17; Përgjigjja e Selimit, para. 11; Përgjigjja e Krasniqit, para. 23; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 981-982, 1047-1048.

mungesë të treguesve specifike dhe konkretë për të kundërtën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, për qëllimet e vendimin aktual, çdo sugjerim për sjellje apo motive të papërshtatshme nga ana e ZPS-së është i pambështetur ose hamendësues.²³⁷

143. Së dyti, Mbrojtja pretendon se përfshirja e ZPS-së në kërkimin e pëlqimit të dëshmitarëve për t'u intervistuar dhe prania e ZPS-së gjatë intervistave të Mbrojtjes me dëshmitarët do të ketë ndikim dekurajues tek ta.²³⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se shqetësimet hipotetike që ngre Mbrojtja nuk vënë në diskutim përfundimin se, bazuar në arsyet e lartpërmendura, korniza e propozuar i lejon ZPS-së të jetë e pranishme në intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar.²³⁹ Sikurse pasqyrohet në kornizën e propozuar, ZPS-ja do të veprojë me ndershmeri dhe në qoftë se do të ketë ndonjë arsye konkrete dhe të qenësishme për të menduar për të kundërtën, Mbrojtja mund t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose Trupit Gjykoës për të kërkuar mjetin e duhur juridik.

144. Së fundi, lidhur me pretendimin se korniza e propozuar drejtohet tërësisht kundër Mbrojtjes,²⁴⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përmendja në përgjithësi nga Mbrojtja e detyrimit të vërtetimit nuk provon se korniza e propozuar drejtohet kundër Mbrojtjes. Parimi se ZPS-ja ka detyrimin e vërtetimit nuk vihet në diskutim dhe korniza e propozuar nuk mund të interpretohet si kalim zhvendosje e këtij detyrimi tek pala tjetër. Rrjedhimisht, ky parim nuk pengon miratimin e masave të llojit dhe qëllimit të përcaktuar në kornizën e propozuar.

²³⁷ Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit ka paraqitur kërkesë tashmë për mjete juridike specifike në lidhje me argumentet e saj për intervistën e ZPS-së me z. Everts, *shih*, F00724, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion i Mbrojtjes së Thaçit për një Vlerësim të Pavarur dhe të Paanshëm të Materialit Shfaqësues*, 7 mars 2022, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 29 mars 2022, F00724/RED).

²³⁸ Përgjigjja e Thaçit, para. 33; Përgjigjja e Selimit, para. 38-39; Përgjigjja e Veselit, para. 33; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1023, 1030, 1033.

²³⁹ *Po ashtu*, ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Decision on Interview of Defence Witnesses by the Prosecution, 8 November 2012, para. 14.

²⁴⁰ Përgjigjja e Selimit, para. 14, 16; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1018-1022.

Çka është më e rëndësishme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se korniza e propozuar është formuluar me terma të përgjithshme dhe, për rrjedhojë, do të zbatohet edhe për intervistat e ZPS-së me dëshmitarët e Mbrojtjes, në qoftë se Mbrojtja do të vendosë të paraqesë prova. Rrjedhimisht, korniza e propozuar është hartuar në mënyrë të tillë që të funksionojë pa dallim në rrethana të krahasueshme, në lidhje me aspektet nën shqyrtim. Për këto arsye, nuk mund të thuhet se ajo drejtohet tërësisht kundër një pale të caktuar aq sa nxirret përfundimi se shkel parimin e barazisë së palëve.

145. Bazuar në argumentet e mësipërme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se Mbrojtjes nuk do t'i mohohet mundësia e arsyeshme për të paraqitur provat e saj në kushte që nuk e vënë në pozitë të pafavorshme kundrejt ZPS-së si pasojë e miratimit dhe zbatimit të kornizës së propozuar.

(b) Privilegji i mosinkriminimit të vetes dhe të drejta të lidhura me të

146. Sipas GJEDNJ-së, e drejta e mosinkriminimit të vetes ka të bëjë kryesisht me respektimin e vullnetit të personit të akuzuar për të heshtur dhe supozon se prokuroria në çështjen penale kërkon të vërtetojë akuzat kundër të akuzuarit jo duke u mbështetur në prova të marra përmes metodave të shtrëngimit apo trysnisë në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit.²⁴¹ Ajo ka sqaruar më tej se gjatë shqyrtimit nëse një procedurë ka bërë të pavlefshëm vetë thelbin e privilegjit të mosinkriminimit të vetes, duhen marrë parasysh faktorët e mëposhtëm: lloji dhe shkalla e detyrimit, ekzistenca ose jo e garancive mbrojtëse në procedura dhe qëllimi për të cilin përdoren materialet e siguruar me këto mënyra.²⁴²

²⁴¹ ECtHR, *Bykov v. Russia* [GC], no. 4378/02, Judgment, 10 March 2009, para. 92 (“ECtHR, *Bykov v. Russia* [GC]”).

²⁴² ECtHR, *Bykov v. Russia* [GC], para. 92.

(i) Balancimi me të drejtat për gjykim të drejtë

147. Mbrojtja parashtron se me gjithë kufizimet që zbatohen për nxjerrjen e materialeve nga Mbrojtja, prania e ZPS-së në intervista dhe kërkesa për incizimin e tyre i vë të akuzuarit në pozitën që, nga njëra anë, të ndërmarrin rrezikun të bëjnë pyetje dhe të krijojnë më shumë prova inkriminuese kundër vetes, të cilat ZPS-ja mund t'i përdorë në shkelje të së drejtës së mosinkriminimit; ose, nga ana tjetër, të heqin dorë nga të drejtat për gjykim të drejtë, përfshirë të drejtën për përgatitjen e plotë të mbrojtjes, të drejtën për të pasur mbrojtës, dhe të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët në cilësinë e palës jothirrëse.²⁴³

148. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në këtë kontekst, Mbrojtja e Thaçit bazohet, ndër të tjera, në të drejtën për të pasur mbrojtës, përfshirë të drejtën për të kryer hetime si e drejtë që buron prej saj, në bazë të nenit 6 të KEDNJ-së.²⁴⁴ Megjithatë, në kuadër të komponentit përkatës të nenit 6(3)(c) të KEDNJ-së, ndonëse diskutoi edhe "tërësinë e shërbimeve që lidhen posaçërisht me ndihmën ligjore" në vlerësimin e drejtësisë së procesit në përgjithësi, GJEDNJ-ja shqyrtoi kryesisht aspektet e së drejtës për të pasur mbrojtës.²⁴⁵ Në fakt, në çështjen gjyqësore që sjell si shembull Mbrojtja e Thaçit, GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6(1) dhe (3)(c) të KEDNJ-së për shkak të kufizimit sistematik të përfaqësimit ligjor gjatë ndalimit në polici,²⁴⁶ që nuk është rasti në procesin gjyqësor aktual. Rrjedhimisht, ky aspekt i argumentit të Mbrojtjes lidhet në fakt me nenin 6(3)(b) të KEDNJ-së. Kjo dispozitë, që përmban një "listë joshteruese" të "të drejtave të Mbrojtjes" lidhur me kohën dhe mjetet dhe mundësitë që duhen për përgatitjen e mbrojtjes, përcakton se "i akuzuari duhet të

²⁴³ Përgjigjja e Thaçit, para. 2, 18-23; Përgjigjja e Selimit, para. 40-41, 47-49; Përgjigjja e Krasniqit, para. 23; Përgjigjja e Veselit, para. 22; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 987-988, 995-996, 1018, 1023-1024, 1032, 1051-1052.

²⁴⁴ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 994, 995.

²⁴⁵ *Shih për shembull* ECtHR, *Beuze v. Belgium [GC]*, no. 71409/10, Judgment, 9 November 2018, para. 131-136.

²⁴⁶ ECtHR, *Dayanan v. Turkey*, no. 7377/03, Judgment, 13 October 2009, para. 33-34.

ketë mundësinë të organizojë mbrojtjen e tij në mënyrën e duhur dhe pa kufizime të mundësisë për t'i paraqitur të gjitha argumentet mbrojtëse relevante para Trupit Gjykyes dhe, rrjedhimisht, për të pasur ndikim në rezultatin e procesit.”²⁴⁷

149. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vlerësojë nëse, sipas kornizës së propozuar, ushtrimi i të drejtave të mbrojtura sipas këtij kuptimi të nenit 6(3)(b) të KEDNJ-së dhe nenit 6(3)(d) të KEDNJ-së bie ndesh me privilegjin e mosinkriminimit të vetes.

150. Lidhur me llojin dhe shkallën e detyrimit të pretenduar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se korniza e propozuar nuk përmban ndonjë element që u kërkon drejtpërdrejt të akuzuarve të bëjnë deklarata vetinkriminuese.²⁴⁸ Gjithashtu, Mbrojtja është e lirë të përcaktojë strategjinë e saj në bazë të vlerësimit se çfarë është në interes të të akuzuarve gjatë intervistave me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e të tjerë të njoftuar dhe, rrjedhimisht, informacionet e zbuluara në këtë mënyrë nuk merren si pasojë e detyrimit. Kjo aq më tepër sepse korniza e propozuar përndryshe nuk cenon të drejtën e Mbrojtjes për të hetuar qoftë aspekte që lidhen me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarë të tjerë të njoftuar me mënyra të tjera, ashtu edhe aspekte që nuk lidhen me këta dëshmitarë, përfshirë mundësinë e intervistimit të personave që nuk janë në listë. Mbështetur në tërësinë e informacionit të mbledhur, Mbrojtja ruan të drejtën t'u bëjë pyetje në cilësinë e palës jothirrëse dëshmitarëve të përfshirë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarëve të tjerë të njoftuar. Vendimi i GJPN-së ku bazohet Mbrojtja ka të bëjë me një kërkesë për dorëzimin e deklaratave të mëparshme të dhëna nga dëshmitarë të Mbrojtjes

²⁴⁷ ECtHR, *Mayzit v. Russia*, no. 63378/00, Judgment, 20 January 2005 (“ECtHR, *Mayzit v. Russia*”), para. 78-79. *Shih gjithashtu*, ECtHR, *Can v. Austria*, no. 9300/81, Report of the Commission, 12 July 1984 (“ECtHR, *Can v. Austria*”), para. 54 (“Ndryshe nga neni 6(3)(b) [garancia në bazë të nenit 6(3)(c) të KEDNJ-së] nuk lidhet posaçërisht me faktorë që lidhen me përgatitjen e gjykimit, por i jep të akuzuarit të drejtën më të përgjithshme për ndihmë dhe mbështetje nga një mbrojtës gjatë gjithë procesit”).

²⁴⁸ ECtHR, *O'Halloran and Francis v. The United Kingdom [GC]*, no. 15809/02 25624/02, Judgment, 29 June 2007, para. 53.

në një proces gjyqësor që kishte lidhje me të dhe, si i tillë dallon nga rrethanat e përshkruara më lart.²⁴⁹

151. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje garancitë mbrojtëse që përmban korniza e propozuar, në veçanti, faktin se ZPS-ja duhet të veprojë me ndershmeri dhe, krahas kësaj, faktin se mundësia e ZPS-së që të jetë e pranishme në intervistë kundër dëshirës së dëshmitarit dhe pranimi në prova i informacioneve që dalin nga intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe të dëshmitarëve të tjerë të njoftuar, varen nga autorizimi gjyqësor. Po kështu, korniza e propozuar nuk ndikon në të drejtën e përgjithshme e palëve për të kërkuar mjet juridik në bazë të kornizës ligjore të DHS-së.

152. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu edhe përdorimin e kufizuar të informacionit në fjalë. Parimi i përgjithshëm i shprehur në kornizën e propozuar është që informacionet që Mbrojtja zgjedh t'i zbulojë gjatë intervistave me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe me dëshmitarë të tjerë të njoftuar, nuk bëhen pjesë e dokumentacionit të çështjes. Të vetmet devijime që lejon korniza e propozuar kërkojnë, siç u përmend, autorizim gjyqësor.

153. Së fundi, Protokollin e GJPN-së përmban udhëzime të mëtejshme për këtë përfundim, sepse parashikon shprehimisht mundësinë e pranisë së palës kundërshtare në intervistë dhe kushtin e videoincizimit.²⁵⁰

154. Rrjedhimisht, ushtrimi i të drejtave të Mbrojtjes sipas nenit 6(3)(b) dhe (e) të KEDNJ-së në bazë të kushteve të përcaktuara në kornizën e propozuar, nuk përbën në vetvete ndonjë formë detyrimi lidhur me privilegjin e mosinkriminimit të vetes. Edhe do të konsiderohej, për hir të argumentit, se në këtë kontekst ekziston njëfarë

²⁴⁹ Përgjigjja e Thaçit, para. 23, që i referohet ICC/GJPN-së, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-907, Trial Chamber VII, Decision on Prosecution Request for Production of Evidence in Possession of the Defence, 15 April 2015, para. 14.

²⁵⁰ ICC Protocol, para. 37, 40, 41.

detyrimi, korniza e propozuar përmban garancitë e duhura dhe përcakton shprehimisht që, përveç në raste të kufizuara që kërkojnë autorizim gjyqësor, çdo informacion i dalë nga intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe me dëshmitarë të tjerë të njoftuar, nuk bëhet pjesë e dokumentacionit të çështjes. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se korniza e propozuar nuk zhvlerëson thelbin e privilegjit të mosinkriminimit të vetes.

(ii) Nxjerrja e materialit

155. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren parashtrimet e Mbrojtjes sipas të cilave korniza e propozuar përfshin nxjerrjen e deklaratave dhe shënimeve nga Mbrojtja, që përndryshe asaj nuk do t'i duhej t'i nxirrte.²⁵¹

156. Sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Mbrojtja në veçanti argumenton, së pari, se kryerja e intervistave të Mbrojtjes sipas kushteve të përcaktuara në kornizën e propozuar mund të çojë në nxjerrjen e informacionit të mbrojtur sipas rregullës 106 të Rregullores dhe/ose të informacionit të dhënë gjatë komunikimeve të privileguara sipas rregullës 111(1) të Rregullores, përfshirë të informacionit inkriminues.

157. Rregulla 111(1)(b) e Rregullores parashikon shprehimisht se informacioni i privileguar nuk përjashtohet nga nxjerrja kur ai i bëhet i njohur vullnetarisht një pale të tretë dhe pala e tretë më pas jep dëshmi për atë nxjerrje. Kjo dispozitë zbatohet për “çdo palë të tretë” dhe, si e tillë, përfshin si individët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së, ashtu edhe ata që nuk janë në atë listë. Rrjedhimisht, Mbrojtja duhet të bëjë të njëjtin vlerësim se çfarë informacioni do të nxjerrë apo do të mbajë të fshehtë lidhur me individët që interviston gjatë hetimeve të veta.

²⁵¹ Përgjigjja e Thaçit, para. 2, 18-20; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 987-988, 992-993, 996-997, 998-999, 1032; 1047.

Bazuar në këtë, nuk ka arsye të mendohet se rregulla 111(1)(b) e Rregullores nuk do të zbatohet për intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët sipas kushteve të kornizës së propozuar. Situata është e ngjashme edhe në lidhje me rregullën 106 të Rregullores. Megjithëse në të nuk ka një barasvlerës të rregullës 111(1)(b) të Rregullores, Mbrojtja, edhe pse nuk ka detyrimin të nxjerrë materiale që përfshihen në rregullën 106 të Rregullores, mund të gjykojë se nxjerrja e informacionit për një palë të tretë do të ishte në interes të të akuzuarve. Për këtë arsye, duke pasur parasysh se, siç u përmend, Mbrojtja është e lirë të përcaktojë strategjinë e saj lidhur me intervistimin e dëshmitarëve në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarëve të tjerë të njoftuar dhe se aspektet e tjera të hetimeve të saj nuk preken, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk pajtohet me argumentin se korniza e propozuar i kërkon Mbrojtjes të nxjerrë informacion në shkelje të rregullave 106 dhe 111(1) të Rregullores.

158. Gjithashtu, sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Mbrojtja së dyti argumenton se korniza e propozuar mund të jetë në shkelje të rregullës 104 të Rregullores, sepse se ZPS-ja mund të vendosë të mos e thërrasë një dëshmitar në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së pasi të jetë intervistuar nga Mbrojtja. Për pasojë, Mbrojtjes do t'i duhet t'i thërrasë këta dëshmitarë të dëshmojnë megjithëse nuk e ka atë detyrim, dhe ZPS-ja do të merrte një deklaratë të cilën përndryshe nuk do të kishte të drejtë ta kishte përpara paraqitjes së provave nga Mbrojtja.²⁵²

159. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ky parashtrim i Mbrojtjes është hamendësues dhe i pabazë. Përfshirja e një individi në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së tregon, në këtë fazë të procesit, synimin e qartë të ZPS-së për ta thirrur atë individ si dëshmitar në gjykim. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se ZPS-ja duhet të veprojë me ndershmëri dhe, nëse konstatohet se nuk ka vepruar kështu, Mbrojtja mund të paraqesë kërkesë të arsyetuar dhe të mbështetur në prova për mjet juridik që e konsideron të

²⁵² Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 996, 999, 1047; Përgjigjja e Selimit, para. 14, 48-49.

përshtatshëm. Kjo do të thotë se korniza e propozuar nuk është në shkelje të rregullës 104 të Rregullores.

160. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se korniza e propozuar në fakt nuk e detyron Mbrojtjen të nxjerrë informacion që lidhet me intervistat me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar në kundërshtim me kornizën ligjore të ZPS-së, e aq më pak që të nxjerrë deklarata inkriminuese në shkelje të privilegjit të mosinkriminimit, apo që të thërrasë dëshmitarë të japin dëshmi në kundërshtim me mungesën e detyrimit për ta bërë këtë. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë nuk mund të nxirret as përfundimi se korniza e propozuar zhvlerëson thelbin e privilegjit të mosinkriminimit të vetes sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së.

(iii) Nenet 6(3)(b) dhe (d) të KEDNJ-së

161. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund të pajtohet as me parashtrimin tjetër të Mbrojtjes, e cila argumenton se në vend të shkaktimit të shkeljes të së drejtës për mosinkriminimin e vetes për shkak të zgjedhjes së supozuar që duhet bërë midis kësaj të drejte dhe elementëve të tjerë të së drejtës për gjykim të drejtë, korniza e propozuar shkel të drejtat sipas nenit 6(3)(b) dhe (d) të KEDNJ-së për shkak të veçorive të diskutuara në lidhje me prezumimin e pafajësisë.

162. GJEDNJ-ja ka konstatuar se neni 6(3)(b) i KEDNJ-së shkelet në rast se të akuzuarit i “bëhet i pamundur” organizimi i mbrojtjes së tij në mënyrën e duhur dhe pa kufizime sa i përket mundësisë për t’i paraqitur trupit gjykues të gjitha argumentet relevante të Mbrojtjes.²⁵³ Kufizimet që rrjedhin nga korniza e propozuar nuk e arrijnë këtë cak. Siç u përmend, Mbrojtja ka lirinë të përcaktojë strategjinë e vet për aspektet që zgjedh t’i bëjë të ditura apo t’i fshehë gjatë intervistave me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarë

²⁵³ ECtHR, *Mayzit v. Russia*, para. 78; ECtHR, *Can v. Austria*, para. 53.

të tjerë të njoftuar, të kryejë hetime, si dhe të marrë në pyetje dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së në cilësinë e palës jothirrëse. Në këto rrethana, ushtrimi i së drejtës së mbrojtur sipas nenit 6(3)(b) të KEDNJ-së, në kushtet e përcaktuara në kornizën e propozuar, nuk bëhet i pamundur.

163. Sa i takon nenit 6(3)(d) të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka konstatuar se kjo dispozitë “mishëron parimin se, përpara se një i akuzuar të shpallet fajtor, të gjitha provat kundër tij normalisht duhet të paraqiten në prani të në seancë publike, me qëllim që të mundësohet paraqitja e argumenteve kundërshtuese” dhe se “të drejtat e mbrojtjes [...], si rregull, kërkojnë që të akuzuarit t’i jepet mundësi e mjaftueshme dhe e duhur për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje dëshmitarin që dëshmon kundër tij, ose në kohën kur ai dëshmitar jep deklaratë, ose në një fazë të mëvonshme të procesit”.²⁵⁴ Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, siç është konstatuar edhe nga TPNJ-ja,²⁵⁵ korniza ligjore të DHS-së apo e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti neni 6(3)(d) të KEDNJ-së, nuk pasqyron të drejtën e kryerjes së intervistave paraprake me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar. Është shumë e rëndësishme të theksohet e që, siç u përmend, e drejta për t’u bërë pyetje këtyre dëshmitarëve në gjykim në cilësinë e palës jothirrëse, nuk vihet në dyshim. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh përmendjen nga Mbrojtja të një vendimi të TPNJ-së që theksonte rëndësia që ka për Mbrojtjen intervistimi i një dëshmitari të pretenduar të prokurorisë përpara dhënies së dëshmisë prej tij.²⁵⁶ Megjithatë, ai vendim nuk mbështet propozimin se Mbrojtja ka të drejtë të vetvetishme t’i kryejë ato intervista, sepse sipas vendimit të Dhomës së Apelit të TPNJ-së, Mbrojtja duhej të paraqiste arsye për kryerjen e intervistës, të cilat duhet të shkonin përtej nevojës për të përgatitur marrjen në pyetje të dëshmitarit në

²⁵⁴ ECtHR, *Al-Khawaja and Tahery v. The United Kingdom [GC]*, no. 26766/05 and 22228/06, Judgment, 15 December 2011, para. 118.

²⁵⁵ ICTY, *Prosecutor v. Kovačević*, IT-97-24, Decision on Prosecution Motion to Protect Victims and Witnesses, 12 May 1998.

²⁵⁶ Përgjigjja e Thaçit, para. 19.

cilësinë e palës jothirrëse.²⁵⁷ Gjithashtu, vendimi TPNJ-së dallon nga çështja aktuale, sepse në çështjen nën shqyrtim në TPNJ Mbrojtja e kishte krejtësisht të ndaluar të kryente intervista të tilla, ndërsa në këtë çështje Mbrojtjes i lejohet shprehimisht të bëjë kërkesë për këtë sipas kushteve të kornizës së propozuar.²⁵⁸ Rrjedhimisht, korniza e propozuar nuk u mohon të akuzuarve mundësinë e mjaftueshme dhe të duhur për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje dëshmitarët që dëshmojnë kundër tyre.

(c) Koha e arsyeshme

164. Sipas GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit duhet përcaktuar në bazë të rrethanave të çështjes, gjë që kërkon kryerjen e një vlerësimi të përgjithshëm.²⁵⁹ Gjithashtu, ajo ka konstatuar se duhet vendosur një balancë e drejtë midis kryerjes së shpejtë të procesit dhe administrimit të duhur të drejtësisë.²⁶⁰

165. Mbrojtja parashton se korniza e propozuar do të cenojë konsiderueshëm të drejtën e të akuzuarit për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, sepse do të ngadalësojë pashmangshmërisht hetimet e Mbrojtjes dhe do të vonojë ndjeshëm fillimin e gjykimit.²⁶¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se Mbrojtja nuk ka demonstruar që korniza e propozuar përbën automatikisht shkelje të së drejtës së të akuzuarve për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, sepse në këtë fazë nuk është e mundshme të përcaktohet ndikimi i saj në vlerësimin e përgjithshëm të kohëzgjatjes së procesit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka

²⁵⁷ ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-AR73, Decision on the Issuance of Subpoenas, 21 June 2004 ("Halilović Subpoenas Decision"), para. 15.

²⁵⁸ Halilović Subpoenas Decision, para. 12-15.

²⁵⁹ ECtHR, *Boddaert v. Belgium*, no. 12919/87, Judgment, 12 October 1992 ("ECtHR, Boddaert v. Belgium"), para. 36.

²⁶⁰ ECtHR, *Boddaert v. Belgium*, para. 39.

²⁶¹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 15; Përgjigjja e Veselit, para. 2, 29-33; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 1048, 1053.

marrë parasysh gjithashtu se, sikurse demonstrohet më lart, korniza e propozuar kontribuon në administrimin e duhur të drejtësisë, veçanërisht sa i takon mbrojtjes së dëshmitarëve në kontekstin e problemeve të mëdha të sigurisë që ndikojnë në procedurat aktuale dhe ruajtjen e provave.

(d) Prezumimi i pafajësisë

166. GJEDNJ-ja ka përcaktuar se prezumimi i pafajësisë sipas nenit 6(2) të KEDNJ-së “kërkon, ndër të tjera, që në kryerjen e detyrave të tyre, anëtarët e gjykatës nuk duhet të nisen nga ideja e parapërcaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet” dhe se ky parim “shkelet nëse vendimi gjyqësor lidhur me personin e akuzuar për një vepër penale pasqyron mendimin se ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajtor sipas ligjit”.²⁶²

167. Mbrojtja është e mendimit se, në shkelje të prezumimit të pafajësisë, korniza e propozuar bazohet në sugjerimet se të akuzuarit do të duan të ndërhyjnë në zhvillimin e procesit të drejtësisë përmes mbrojtësve të tyre dhe se mbrojtësve nuk mund t’u besohet, ndërkohë që mbrojtësit janë të akredituar dhe kundër Mbrojtjes nuk është ngritur asnjë pretendim në lidhje me intervistat e bëra deri tani.²⁶³

168. Për sa i përket përmendjes nga Mbrojtja të ndërhyrjeve në zhvillimin e procesit të drejtësisë, me sa kupton Gjykatësi i Procedurës Paraprake, argumenti i Mbrojtjes është se miratimi i kornizës së propozuar do të shkelte prezumimin e pafajësisë sepse – në mungesë të vendimit gjyqësor për fajësinë e të akuzuarve – ajo do të pasqyronte idenë apo mendimin e parapërcaktuar se ata janë fajtorë për veprat penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, në kuadër të hetimeve në lidhje me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Aktakuzën e Konfirmuar.

²⁶² ECtHR, *Barberà, Messegueé and Jabardo v. Spain*, 10590/83, Judgment, 6 December 1988, para. 77.

²⁶³ Përgjigjja e Thaçit, para. 31; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 984-985, 990-991, 1000-1002, 1004-1006, 1044-1047, 1049-1051, 1058-1059.

169. Duke supozuar se të akuzuarit mund të përfitojnë nga prezumimi i pafajësisë, duke pasur parasysh se nuk janë akuzuar për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe se korniza e propozuar nuk parapërcakton fajësinë e tyre lidhur me akuzat në Aktakuzën Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, siç u përmend, korniza e propozuar e ka bazën, ndër të tjera, në ekzistencën e një atmosfere të vazhdueshme frikësimi të dëshmitarëve në lidhje me procese penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së. Si e tillë, korniza e propozuar nuk pasqyron ndonjë ide apo mendim të parapërcaktuar se të akuzuarit janë fajtorë për veprat penale sipas nenit 15(2) të Ligjit. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk sheh ndonjë shkelje të prezumimit të pafajësisë.

170. Argumenti i Mbrojtjes se deri më tani ajo nuk është akuzuar për ndonjë shkelje, nuk ndikon në këtë konstatim. Kjo kryesisht sepse ajo i ka kryer një pjesë të konsiderueshme të intervistave të saj para se ZPS-ja të dorëzonte Listën e Dëshmitarëve të vet dhe, gjithashtu, shumica e masave mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores do të hiqen vetëm 30 ditë përpara fillimit të gjykimit ose dhënies së dëshmisë nga dëshmitarët. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon gjithashtu se parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me mosbesimin ndaj mbrojtësve dhe faktin se mbrojtësit janë të akredituar, janë pa vend. Duke qenë se të akuzuarit i realizojnë të drejtat e tyre për mbrojtje përmes avokatëve mbrojtës, korniza e propozuar duhet domosdoshmërisht të garantojë që mbrojtësit të veprojnë në përputhje me konstatimet e mësipërme lidhur me rreziqet me të cilat përballen individët në fjalë dhe atmosferën e ndërhyrjeve. Kjo nuk nënkupton apo merr si të qenë se mbrojtësit janë përfshirë ose do të përfshihen në veprimtari të tilla, në mungesë të ndonjë treguesi konkret për të kundërtën.

(e) Koha dhe mjetet e mundësitë e mjaftueshme

171. Sipas GJEDNJ-së, neni 6(3)(b) i KEDNJ-së “i garanton të akuzuarit ‘kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet’ dhe,

rrjedhimisht, nënkupton se veprimtaria mbrojtëse materiale në emër të të akuzuarit mund të përfshijë gjithçka që është e ‘nevojshme’ për përgatitjen e gjykimit”.²⁶⁴ Ajo ka përcaktuar më tej se, “gjatë vlerësimit nëse i akuzuari ka pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, duhet mbajtur parasysh veçanërisht natyra e procesit gjyqësor, si dhe kompleksiteti i çështjes dhe faza në të cilën janë procedurat”.²⁶⁵ Gjithashtu, ajo ka konstatuar se “mjetet dhe mundësitë që duhet t’i jepen të akuzuarit përfshijnë vetëm ato që e ndihmojnë, ose mund ta ndihmojnë atë, për përgatitjen e mbrojtjes së vet”.²⁶⁶

172. Mbrojtja argumenton se korniza e propozuar shkel të drejtën e të akuzuarit për të pasur kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për t’u përgatitur për gjykimin, për shkak të vështirësive logjistike që krijon ajo, ndër të cilat numri i dëshmitarëve dhe fakti që ata gjenden në vende të ndryshme të botës, fakti që Mbrojtjes vetëm kohët e fundit i janë nxjerrë materiale të mjaftueshme për fillimin e hetimeve të saj dhe kushtet tejet të rrepta që propozon ZPS-ja për kryerjen e intervistave.²⁶⁷

173. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se akuzat kundër të akuzuarve, të paraqitura në dhjetë pikat për krime të rënda ndërkombëtare në Aktakuzë, janë jashtëzakonisht të rënda dhe se pretendohet që ata luajtën rol të rëndësishëm në këto krime.²⁶⁸ Gjithashtu, krimet e pretenduara u kryen në një periudhë të gjatë kohe (të paktën që nga marsi 1998 deri në shtator 1999), në një zonë gjeografike të gjerë (vendndodhje të shumta në të gjithë Kosovën dhe disa rrethe në Shqipërinë e Veriut) dhe kishin të bënin me dhjetëra viktime.²⁶⁹ Krahas kësaj, ekziston edhe një vështirësi e veçantë që buron nga nevoja për vendosjen e masave të shumta

²⁶⁴ ECtHR, *Mayzit v. Russia*, para. 78.

²⁶⁵ ECtHR, *Gregačević v. Croatia*, no. 58331/09, *Judgment*, 10 July 2012, para. 51.

²⁶⁶ ECtHR, *Mayzit v. Russia*, para. 79.

²⁶⁷ Përgjigjja e Thaçit, para. 32-33; Përgjigjja e Selimit, para. 15; Përgjigjja e Krasniqit, para. 23; Përgjigjja e Veselit, para. 23-24; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 990-991, 1048.

²⁶⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 1-9, 11-12, 32-52, 172-173.

²⁶⁹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 16, 18, 32, 57-171, Listat A-C.

mbrojtëse për një numër të madh dëshmitarësh, për shkak të faktit se nxjerrja e identitetit të tyre për Mbrojtjen përbën një rrezik objektivisht të arsyetueshëm për këta persona, si edhe për shkak të atmosferës së vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve lidhur me proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së. Po kështu, me rëndësi është edhe se Mbrojtja vazhdon të kryejë hetime, çështja ende nuk i ka kaluar Trupit Gjykses, dhe hetimet e Mbrojtjes mund të vazhdojnë edhe pas fazës paraprake.

174. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, ndonëse korniza e propozuar mund të ketë njëfarë ndikimi mbi kohën dhe mjetet e mundësitë e të akuzuarve për përgatitjen e mbrojtjes së tyre, disa faktorë që ngre Mbrojtja janë të pashmangshëm në procese penale me përmasa të mëdha që lidhen me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Numri i dëshmitarëve pasqyron shkallën dhe kompleksitetin e akuzave të ngritura kundër të akuzuarve, ndërsa vendndodhjet e dëshmitarëve lidhen ose me përfshirjen e dëshmitarëve me profil ndërkombëtar, ose me zhvendosjen e individëve pas konfliktit në fjalë. Faktorë të tjerë rezultojnë nga veçantitë e kornizës ligjore të DHS-së dhe të procesit aktual. Nxjerrja e materialeve që mundësojnë kryerjen e intervistave nga Mbrojtja nuk parashikohet të kryhet përpara konfirmimit të aktakuzës dhe paraqitjes së parë të të akuzuarve, dhe kushtet e vendosura për intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe me dëshmitarët e tjerë të njoftuar janë pasojë e shqetësimeve për sigurinë të përmendura më sipër.

175. Përveç kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja e ka ndryshuar kornizën e propozuar, duke hequr pengesat e mundshme të shkaktuara nga angazhimi i gjerë i Zyrës Administrative. Gjithashtu, disa nga problemet e ngritura si shqetësim nga Mbrojtja mund të zvogëlohen, sidomos përmes kryerjes së intervistave bashkërisht dhe/ose përmes përdorimit të teknologjisë audiovizuale. Për më tepër, Mbrojtjes nuk i ndalohet të dorëzojë kërkesa të

arsyetuara për mjete juridike për aspekte konkrete dhe të identifikueshme që dalin në këtë kontekst, si kërkesat për zgjatje të afatit apo kërkesa të tjera.

176. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, kur vihet në balancë me faktorët e lartpërmendur, ndikimi mbi të drejtën e të akuzuarit për të pasur kohë dhe mjete dhe mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet nuk është i tillë që të çojë në konstatimin se miratimi dhe zbatimi i kornizës së propozuar në fazën aktuale të procesit është në shkelje të nenit 6(3)(b) të KEDNJ-së.

(f) Përfundim

177. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se korniza e propozuar nuk shkel të drejtat e lartpërmendura të të akuzuarve për gjykim të drejtë.

3. Elemente specifike

178. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të trajtojë tani elementet specifike të kornizës së propozuar që kundërshtohen nga palët ose pjesëmarrësit, që nuk u trajtuan në pjesët në lidhje me bazën ligjore dhe të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë.

179. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos që nuk do të trajtojë argumentin e Mbrojtjes se në kornizën e propozuar nuk janë përdorur përkufizime përputhëse, për shkak të natyrës jobindëse të këtij parashtrimi.²⁷⁰

²⁷⁰Përgjigjja e Krasniqit, para. 22.

(a) Informacioni konfidencial (paragrafi 5(a) i Parashtrimeve të ZPS-së)

180. Sipas paragrafit 5(a) të parashtrimeve të ZPS-së, “palët dhe pjesëmarrësit kanë detyrimin e përgjithshëm që të mos nxjerrin informacion konfidencial për palë të treta” dhe, në lidhje me këtë, përcaktohet më tej se informacion konfidencial “do të thotë çdo informacion që përmbahet në një dokument i cili nuk është klasifikuar si ‘publik’ dhe i cili nuk është bërë ndryshe publik në mënyrë legjitime, si dhe çdo informacion për të cilin ndonjë nga panelet e Gjykatës ka urdhëruar që të mos u nxirret palëve të treta.”²⁷¹ Sipas Mbrojtjes, të gjitha dokumentet e nxjerra janë klasifikuar si konfidenciale, ndërkohë që shumë prej tyre e kanë origjinën nga burime publike, janë publikuar në internet, nuk kanë lidhje me dëshmitarë të ZPS-së, dhe/ose nuk përmbajnë informacion konfidencial.²⁷² Ajo propozon që të veprohet sipas Protokollit të GJPN-së në bërjen e dallimit midis “dokumentit konfidencial” dhe “informacionit konfidencial”, si edhe që të miratohen për zbatim nenet e Protokollit të GJPN-së që rregullojnë nxjerrjen e dokumenteve dhe informacionit konfidencial për palë të treta.²⁷³

181. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja nuk ka paraqitur ndonjë arsyetim konkret se përse korniza e propozuar, në mënyrën si është formuluar aktualisht, vendos ndalim pothuaj absolut ndaj përdorimit të informacionit konfidencial. Gjithashtu, pavarësisht nga klasifikimi i tyre, një numër dokumentesh të nxjerra përmbajnë informacion që është i disponueshëm për publikun ose që nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me aspekte konfidenciale. Kjo masë shkon përtej qasjes së Protokollit të GJPN-së lidhur me këto aspekte. Për këtë arsye, ajo mund t’i pengojë hetimet në mënyrë disproporcionale.

182. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se dallimi midis “dokumentit konfidencial” dhe “informacionit konfidencial” në Protokollin e

²⁷¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5(a), poshtëshënimi 13.

²⁷² Përgjigjja e Thaçit, para. 39.

²⁷³ Përgjigjja e Thaçit, para. 11, 40.

GJPN-së – që lejon përdorimin e informacionit të përfshirë në një dokument konfidencial i cili ndryshe është bërë publik në mënyrë legjitime, dhe garancitë e përfshira në nenet 8 dhe 9 të Protokollit të GJPN-së, veçanërisht kushti që nxjerrja lejohet vetëm kur është drejtpërdrejt dhe posaçërisht e domosdoshme për përgatitjen dhe paraqitjen e provave nga një palë dhe ka të bëjë vetëm me ato pjesë të dokumentit që mundësojnë drejtpërdrejt realizimin e atij qëllimi – vendosin balancën e duhur midis respektimit të nevojës për mbrojtjen e konfidencialitetit të materialeve të caktuara dhe mundësitë të hetimeve të palës përkatëse në shkallë të mjaftueshme. Si rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton Kërkesën e Mbrojtjes për ndryshimin e kornizës së propozuar, bazuar në nenet 4(d)-(e) dhe 6-9 të Protokollit të GJPN-së.

(b) Përkufizimi i dëshmitarit (paragrafi 5(b) i Parashtrimeve të ZPS-së)

183. Mbrojtja kundërshton përkufizimin e dëshmitarit në paragrafin 5(b) dhe poshtëshënimin 14 të Parashtrimeve të ZPS-së, ku thuhet si vijon: “‘dëshmitar’ është personi të cilin pala ose pjesëmarrësi synon ta thërrasë për të dëshmuar apo në deklaratat e të cilit pala ose pjesëmarrësi synon të mbështetet, në rast se synimi i palës ose pjesëmarrësit është i njohur ose i qartë për palën kundërshtare”.²⁷⁴

184. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se synimin e saj për të thirrur dëshmitarët për të dëshmuar apo për t’u mbështetur në deklaratat e tyre, ZPS-ja e bën të qartë kryesisht me anë të listës së dëshmitarëve sipas rregullës 95(4)(b) të Rregullores. Megjithatë, në kundërshtim me parashtrimin e Mbrojtjes, lista sipas rregullës 95(4)(b) nuk përbën njoftim përfundimtar.²⁷⁵ Kjo dëshmohet nga përdorimi i fjalës “synon” në rregullën 95(4)(b) të Rregullores, si edhe mundësia për të bërë kërkesë për ndryshime në listën sipas rregullës 95(4)(b), në bazë të

²⁷⁴ Përgjigjja e Thaçit, para. 10; Përgjigjja e Selimit, para. 24-25.

²⁷⁵ Përgjigjja e Selimit, para. 25.

rregullës 118(2) të Rregullores. Në këto rrethana, mund të krijohet një situatë ku Mbrojtja mund të kërkojë të intervistojë një person i cili nuk është në listën e rregullës 95(4)(b), edhe pse ZPS-ja mund të ketë ndër mend të kërkojë ta ndryshojë listën e saj të rregullës 95(4)(b) lidhur me atë person dhe vlerëson se, ndërkohë, korniza e propozuar duhet të zbatohet për intervistën e Mbrojtjes me të. Rrjedhimisht, në këtë kuadër, përkufizimi i dëshmitarit është, në parim, në pajtim me funksionet e kornizës së propozuar, sepse shpreh mundësinë që ZPS-ja ta bëjë të ditur synimin e vet për ta thirrur një dëshmitar të dëshmojë apo për të përdorur deklaratën e tij jo vetëm përmes përfshirjes së personit në fjalë në listën sipas rregullës 95(4)(b).

185. Në të njëjtën kohë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se është e nevojshme të japë më shumë udhëzime në këtë drejtim, për të shmangur zgjerimin e panevojshëm të fushëveprimit të kornizës së propozuar. Rrjedhimisht, referenca “për sa kohë që synimi i palës ose pjesëmarrësit është i njohur ose i qartë për palën kundërshtarë” do të zëvendësohet me “për sa kohë që synimi i palës ose pjesëmarrësit i është njoftuar palës ose pjesëmarrësit kundërshtar”. Për të njëjtat arsye, paragrafi 6(a) i Parashtrimeve të ZPS-së, i cili në pjesën përkatëse thotë se synimi i thirrjes së dëshmitarit për të dëshmuar apo i përdorimit të deklaratës së tij duhet të “komunikohet” apo “të jetë krejt i qartë”, do të ndryshohet në përputhje me këtë. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund të pajtohet me kundërshtimin e Mbrojtjes lidhur me përkufizimin e dëshmitarit siç është paraqitur në paragrafin 5(b) të Parashtrimeve të ZPS-së, por vendos ta ndryshojë këtë përkufizim si më lart, së bashku me paragrafin 6(a) të Parashtrimeve të ZPS-së.

(c) Nxjerrja e identitetit të dëshmitarit (paragrafët 5(b) dhe (c) të Parashtrimeve të ZPS-së)

186. Në lidhje me paragrafët 5(b) dhe (c) të Parashtrimeve të ZPS-së që rregullojnë nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit për palët e treta, Mbrojtja parashtron se kufizimet nuk duhet të jenë aq të rrepta sa ta bëjnë nxjerrjen të pamundur në praktikë dhe se ato nuk duhet të zbatohen për personalitetet dhe dëshmitarët ndërkombëtarë për të cilët nuk janë miratuar masa mbrojtëse.²⁷⁶

187. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se tashmë ka vendosur që korniza e propozuar zbatohet për dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar, përfshirë dëshmitarët ndërkombëtarë. Si rrjedhojë, kjo pikë e parashtrimit të Mbrojtjes nuk do të trajtohet më tej.

188. Gjithashtu, Mbrojtja nuk specifikon se si paragrafët 5(b) dhe (c) të Parashtrimeve të ZPS-së do ta bënin të pamundur nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit për palë të treta. Në fakt, këta paragrafë, të cilët përkojnë me nenet 11 dhe 12 të Protokollit të GJPN-së, e lejojnë shprehimisht këtë nxjerrje me disa kushte të caktuara. Këto kushte, kryesisht nevoja për të informuar ZMMD-në apo për t'u këshilluar me të dhe detyrimi për të mos zbuluar përfshirjen apo llojin e përfshirjes së dëshmitarit në veprimtaritë e DHS-së apo të ZPS-së, janë në përputhje me funksionet mbrojtëse të kornizës së propozuar. Për këtë arsye, parashtrimi i Mbrojtjes rrëzohet.

(d) Materiali pamor dhe/ose pa tekst (paragrafi 5(d) i Parashtrimeve të ZPS-së)

189. Mbrojtja parashtron se, nëse do të ketë detyrimin të zbatojë kushtet për nxjerrjen të materialit pamor dhe/ose pa tekst sipas paragrafit 5(d) të

²⁷⁶ Përgjigjja e Thaçit, para. 41.

Parashtrimeve të ZPS-së, gjasat janë që në më të shumtën e rasteve ajo nuk do të mund ta tregojë atë material gjatë hetimeve të saj.²⁷⁷

190. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo masë, që është e njëjtë me nenin 13 të Protokollit të GJPN-së, synon të zvogëlojë rrezikun e zbulimit të përfshirjes së personit të përshkruar ose pasqyruar në veprimtaritë e DHS-së ose të ZPS-së. Në rastet kur nuk janë të disponueshme mundësi hetimore alternative të përshtatshme, kjo masë gjithsesi lejon përdorimin e materialit ku tregohen ose ndryshe identifikohen dëshmitarët, përveç nëse përmbajnë elemente që mund të zbulojnë përfshirjen në veprimtaritë e DHS-së apo të ZPS-së e personit të treguar. Rrjedhimisht, kjo masë vendos balancën e duhur midis funksioneve mbrojtëse të kornizës së propozuar dhe veprimtarive hetimore të Mbrojtjes. Për këtë arsye, parashtrimi hamendësues i Mbrojtjes se ka gjasa që ajo përgjithësisht nuk do të jetë në gjendje t'i tregojë materiale të tilla është i pabazë.

(e) ZMMD-ja (paragrafët 5(e) dhe (g) të Parashtrimeve të ZPS-së)

191. Sipas Mbrojtjes, detyrimet në paragrafët 5(e) dhe (g) të Parashtrimeve të ZPS-së, konkretisht që, kur nuk është e sigurt nëse identiteti i një dëshmitari të mbrojtur mund të nxirret ose jo për palë të treta, pala ose pjesëmarrësi duhet të kërkojë këshillën e ZMMD-së dhe të informojë ZMMD-në kur zbulon shkelje të informacionit konfidencial, duhet të hidhen poshtë si tepër të rënda, joefikase dhe të parealizueshme në praktikë.²⁷⁸

192. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se qëllimi legjitim i paragrafit 5(e) të Parashtrimeve të ZPS-së është mbrojtja e identitetit të dëshmitarit të mbrojtur gjatë hetimeve dhe, krahas kësaj, zbatohet vetëm në rastet kur pala ose pjesëmarrësi nuk është i sigurt në lidhje me të. Në mënyrë të ngjashme, paragrafi 5(g) i

²⁷⁷Përgjigjja e Krasniqit, para. 16-17.

²⁷⁸Përgjigjja e Krasniqit, para. 18-19.

Parashtrimeve të ZPS-së shërben për ruajtjen e informacionit konfidencial vetëm kur vetë pala ose pjesëmarrësi e nxjerr informacionin gabimisht apo zbulon se ka ndodhur një gjë e tillë. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se këto masa, të cilat përkojnë me nenet 14 dhe 26 të Protokollit të GJPN-së, nuk ndikojnë në mënyrë disproporcionale në veprimtarinë hetimore të palës. Për këto arsye, argumentet e Mbrojtjes rrëzohen.

(f) Kontaktet me dëshmitarët (paragrafi 6(a) i Parashtrimeve të ZPS-së)

193. Mbrojtësi i Viktimave shpreh shqetësimin se duke përcaktuar që “palët dhe pjesëmarrësit nuk kontaktojnë apo intervistojnë dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësit tjetër”, paragrafi 6(a) i Parashtrimeve të ZPS-së cenon në mënyrë të paqëllimshme parimin e komunikimit konfidencial, të papenguar dhe të pakushtëzuar midis Mbrojtësit të Viktimave dhe dëshmitarëve me status të dyfishtë.²⁷⁹ Mbrojtësi i Viktimave propozon shtesën e mëposhtme në poshtëshënimin 17 të Parashtrimeve të ZPS-së: “por nuk zbatohet për kontaktet midis ekipit të Mbrojtësit të Viktimave dhe dëshmitarëve me status të dyfishtë”.²⁸⁰ ZPS-ja nuk e kundërshton modifikimin e propozuar.²⁸¹

194. Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranon se, sipas formulimit aktual, poshtëshënimi 17 i Parashtrimeve të ZPS-së mund të interpretohet se pengon kontaktet midis Mbrojtësit të Viktimave dhe të ekipit të tij me dëshmitarët me status të dyfishtë. Duke pasur parasysh se dëshmitarët me status të dyfishtë janë persona në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe përfaqësohen nga Mbrojtësi i Viktimave në cilësinë e viktimave pjesëmarrëse në proces, për të shmangur çdo dyshim, ky poshtëshënim duhet të sqarohet në përputhje me sugjerimin e Mbrojtësit të Viktimave. Në lidhje me këtë, vihet në dukje se protokollet e

²⁷⁹ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 8-9.

²⁸⁰ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 8-9.

²⁸¹ Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së, poshtëshënimi 11.

miratuara nga GJPN-ja për dëshmitarët me status të dyfishtë përcaktojnë shprehimisht se “përfaqësuesi ligjor mund të kontaktojë klientët e tij në qoftë se ata janë viktimë me status të dyfishtë”.²⁸² Lidhur me këtë aspekt GJPN-ja është shprehur se “marrëdhënia midis klientit dhe mbrojtësit nënkupton vetiu që klienti duhet të jetë në gjendje të kontaktojë lirisht përfaqësuesin e tij ligjor dhe anasjelltas”.²⁸³ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranon parashtrimin e Mbrojtësit të Viktimave dhe vendos të ndryshojë kornizën e propozuar në përputhje me të.

(g) Paragrafi 6(b) i Parashtrimeve të ZPS-së

(i) Njoftimi

195. Mbrojtësi i Viktimave është i mendimit se në detyrimin për njoftim në paragrafin 6(b) të Parashtrimeve të ZPS-së, që përcakton se pala ose pjesëmarrësi kundërshtar që dëshiron të intervistojë dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësit tjetër duhet të njoftojë palën thirrëse dhe NJAGJ-në të paktën dhjetë ditë para intervistës së synuar - duhet të përfshihet edhe Mbrojtësi i Viktimave në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë.²⁸⁴

196. Gjykatësi i Procedurës Paraprake pajtohet se, duke pasur parasysh që dëshmitarët e ZPS-së me status të dyfishtë janë persona të përfshirë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe të përfaqësuar nga Mbrojtësi i Viktimave në cilësinë e viktimave pjesëmarrëse në proces, është me vend që në kornizën e propozuar të

²⁸² *Shih për shembull, ICC, The Prosecutor v. Ali Muhammad Ali Abd-Al-Rahman (“Ali Kushayb”), ICC-02/05-01/20-618-Anx, Trial Chamber I, Annex to the Decision Adopting a Dual Status Witness Protocol, 7 March 2022 (“Ali Kushayb Dual Status Witness Protocol”), para. 6.*

²⁸³ *ICC, The Prosecutor v. Al Hassan Ag Abdoul Aziz Ag Mohamed Ag Mahmoud, ICC-01/12-01/18-674, Trial Chamber X, Decision on the ‘Protocol on the handling of confidential information during investigations and contacts between a party or participant and witnesses of the opposing party or of a participant’, the ‘Dual Status Witness Protocol’, and related matters, 19 March 2020 (“Al Hassan Protocol Decision”), para. 19.*

²⁸⁴ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 976-977.

sqarohet specifikisht se detyrimi për njoftim vlen edhe në lidhje me Mbrojtësin e Viktimave. Në këtë kuadër, vihet në dukje se protokollet e miratuara nga GJPN-ja në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë e përcaktojnë shprehimisht këtë detyrim.²⁸⁵ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e pranon parashtrimin e Mbrojtësit të Viktimave dhe vendos të ndryshojë kornizën e propozuar në përputhje me të.

(ii) Prania e palës thirrëse pavarësisht nga parapëlqimi e dëshmitarit

197. Mbrojtja kundërshton paragrafin 6(b) të parashtrimeve të ZPS-së, sipas të cilit “në rast se beson se siguria e dëshmitarit mund të jetë të rrezikuar, ose për arsye të tjera legjitime, pala thirrëse mund t’i kërkojë panelit që ta lejojë të jetë e pranishme në takimet mes palës kundërshtare dhe dëshmitarit, pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit”.²⁸⁶ ZPS-ja parashtron se, si rregull, dhënia e pëlqimit nga dëshmitari që ZPS-ja të mos jetë e pranishme, nuk është bazë e mjaftueshme që intervista të kryhet pa ZPS-në, duke pasur parasysh detyrimin shumë real që do të ndjejë dëshmitari për ta kryer intervistën pa praninë e ZPS-së.²⁸⁷

198. Sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, mundësia që ZPS-ja të jetë e pranishme në intervistën e Mbrojtjes me një dëshmitar në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarë të tjerë të njoftuar, pavarësisht nga parapëlqimi i dëshmitarit, është masë e përshtatshme dhe e nevojshme në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore. Përndryshe do të pengohej realizimi i funksioneve thelbësore të kornizës së propozuar, konkretisht, sigurimi i mbrojtjes dhe privatësisë së dëshmitarëve dhe ruajtja e provave materiale. Kjo sidomos nëse mbahet parasysh mundësia konkrete që dëshmitari të ndihet nën trysni të thotë se pajtohet ta kryejë

²⁸⁵ *Shih për shembull, Ali Kushayb Dual Status Dëshmitar Protocol*, para. 5(a).

²⁸⁶ Përgjigjja e Thaçit, para. 35; Përgjigjja e Selimit, para. 42; Përgjigjja e Krasniqit, para. 20.

²⁸⁷ Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së, para. 5(a); Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 974-975.

intervistën në mungesë të ZPS-së, për shkak të atmosferës së frikësimit të dëshmitarëve në lidhje me proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së. Rrjedhimisht, duhet të ekzistojë një mekanizëm për të përcaktuar nëse ka arsye legjitime që kërkojnë praninë e ZPS-së pavarësisht nga parapëlqimi i dëshmitarit, sidomos për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se pëlqimi i dëshmitarit për t'u intervistuar pa praninë e ZPS-së nuk është dhënë në mënyrë të vlefshme.

199. Sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, pretendimi i Mbrojtjes se ZPS-ja nuk e ka fituar këtë të drejtë nuk mbështetet në ndonjë informacion konkret. Sa i takon pretendimit se Protokollin e GJPN-së nuk përmban shprehimisht një dispozitë të barasvlershme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se nuk ka asnjë tregues që Protokollin e GJPN-së i ndalon prokurorit të GJPN-së të paraqesë kërkesë për këtë në bazë të nenit 3 të Protokollit të GJPN-së, sipas të cilit palët lejohen të devijojnë nga Protokollin e GJPN-së pas marrjes së autorizimit gjyqësor, ose në bazë të kompetencës së prokurorit të GJPN-së për të kërkuar marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e mbrojtjes së personave apo ruajtjen e provave në kuadër të hetimeve, në bazë të nenit 54(3)(f) të Statutit të Romës.

200. Gjithsesi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ZPS-ja nuk mund të pretendojë të ketë të drejtë të pakufizuar për të qenë e pranishme në intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe me dëshmitarë të tjerë të njoftuar pavarësisht nga parapëlqimi i dëshmitarëve. Në lidhje me këtë konstatohet se, ndërsa fillimisht ZPS-ja parashtroi se “mund t'i kërkojë panelit që ta lejojë të jetë e pranishme në çdo takim midis palës kundërshtare dhe dëshmitarit, pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit”²⁸⁸ më pas ajo parashtroi se “prania e palës kundërshtare [...] duhet të jetë e drejtë e vetvetishme, dhe vetëm Dhoma mund të miratojë përjashtim”.²⁸⁹ ZPS-ja nuk ka paraqitur ndonjë arsyetim konkret për të përligjur këtë ndryshim në qëndrimin e

²⁸⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6(b).

²⁸⁹ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 974-975.

saj. Për më tepër, një e drejtë e tillë e pakufizuar mund të shkaktojë pasoja të konsiderueshme, në veçanti që dëshmitarit t'i mohohet dhënia e pëlqimit të shprehur lirisht dhe në mënyrë të vlefshme.

201. Pasi ka peshuar të gjithë faktorët e mësipërm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, për të pasur mundësinë të jetë e pranishme në intervistën e Mbrojtjes me dëshmitarë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe me dëshmitarë të tjerë të njoftuar pavarësisht nga parapëlqimet e dëshmitarëve, ZPS-ja duhet të marrë paraprakisht autorizim gjyqësor paraprak. Rrjedhimisht, nëse një dëshmitar në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së apo dëshmitar tjetër i njoftuar pranon që intervista me Mbrojtjen të kryhet në mungesë të ZPS-së, ZPS-ja mund të paraqesë kërkesë të arsyetuar dhe të bazuar, ku të paraqesë arsye legjitime se pse duhet të jetë e pranishme në intervistë në kundërshtim me parapëlqimin e dëshmitarit. Sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, kjo shprehet në mënyrën e duhur në paragrafin 6(b) të Parashtrimeve të ZPS-së, i cili në pjesën përkatëse përcakton se “në rast se beson se siguria e dëshmitarit mund të jetë të rrezikuar, ose për arsye të tjera legjitime, pala thirrëse mund t'i paraqesë kërkesë panelit për leje që të jetë e pranishme në takimet mes palës kundërshtare dhe dëshmitarit pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit”. Për hir të qartësisë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shton se, nëse pala thirrëse i drejtohet panelit apo njofton palën kundërshtare për këtë, pala kundërshtare nuk e interviston dëshmitarin deri në dhënien e vendimit nga paneli.

(iii) Prania e Mbrojtësit të Viktimave

202. Mbrojtësi i Viktimave është i mendimit se lidhur me dëshmitarët me status të dyfishtë, korniza e propozuar duhet të parashohë mundësinë e pranisë së

Mbrojtësit të Viktimave apo të ndonjë personi tjetër mbështetës gjatë intervistës me Mbrojtjen, nëse dëshmitari e kërkon këtë.²⁹⁰

203. Sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, për shkak të rolit të dyfishtë të tyre në procesin aktual, dëshmitarët me status të dyfishtë duhet të kenë mundësinë që përveç pranisë së palës thirrëse të kërkojnë edhe praninë e Mbrojtësit të Viktimave gjatë intervistës me Mbrojtjen. Vihet në dukje se protokollet për dëshmitarët me status të dyfishtë të miratuar nga GJPN-ja u lejojnë shprehimisht dëshmitarëve me status të dyfishtë ta bëjnë këtë.²⁹¹ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave dhe vendos të ndryshojë kornizën e propozuar në përputhje me këtë.

(h) Kontaktet e paqëllimshme (paragrafi 6(c) i Parashtrimeve të ZPS-së)

204. Mbrojtja e Selimit argumenton se paragrafi 6(c) i parashtrimeve të ZPS-së, që lidhet me kontaktet e paqëllimshme me dëshmitarët e palës ose pjesëmarrësit kundërshtar, duhet të zbatohet vetëm për dëshmitarët të rrezikuar.²⁹²

205. Duke qenë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake tashmë ka vendosur se korniza e propozuar vlen për të gjithë personat e përfshirë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe për dëshmitarët e tjerë të njoftuar, ky argument nuk do të trajtohet më tej.

²⁹⁰ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 16-17; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 976-978.

²⁹¹ *Shih për shembull, Ali Kushayb Dual Status Witness Protocol*, para. 9. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses X i TPNJ-së konstatoi se, duke marrë parasysh se të gjithë përfaqësuesit ligjorë kanë detyrimin të respektojnë fshehtësinë dhe konfidencialitetin dhe të mos kryejnë akte që mund të vënë në rrezik në ndonjë mënyrë procesin gjyqësor, prania e përfaqësuesve ligjorë apo kontakti me ta nuk shton ndonjë rrezik në kuadër të kryerjes së intervistave me dëshmitarët me status të dyfishtë, *shih Al Hassan Protocol Decision*, para. 20.

²⁹² Përgjigjja e Selimit, para. 43.

(i) Dokumentet konfidenciale (paragrafi 6(m) i Parashtrimeve të ZPS-së)

206. Mbrojtja argumenton se ZPS-ja nuk jep arsye për të përligjur nevojën që pala intervistuese të kërkojë leje nga paneli për të treguar dokumente (rreptësisht) konfidenciale, me përjashtim të deklaratave të vetë dëshmitarit, sikurse përcaktohet në paragrafin 6(m) të parashtrimeve të ZPS-së, dhe se ky kusht do ta vonojë procesin.²⁹³

207. Ashtu si në lidhje me paragrafin 5(a) të Parashtrimeve të ZPS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë arsyetim konkret në mbështetje të kësaj mase me efekt kaq të gjerë, e cila nuk është as në Protokollin e GJPN-së. Për më tepër, pasi ka konstatuar se përdorimi i dokumenteve apo informacioneve konfidenciale gjatë hetimeve duhet lejuar me kushtet e identifikuar më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se palëve dhe pjesëmarrësve duhet t'u jepet mundësia të procedojnë në të njëjtën mënyrë gjatë intervistave me dëshmitarët, *mutatis mutandis*. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton Kërkesën e Mbrojtjes dhe vendos ta ndryshojë kornizën e propozuar në përputhje me të.

(j) Prania e Zyrës Administrative (paragrafi 4(b)(ii) i Përgjigjes së Mëtejshme të ZPS-së)

208. Mbrojtësi i Viktimave parashtron se korniza e propozuar duhet të jetë elastike sa i takon praninë e Zyrës Administrative gjatë intervistave të Mbrojtjes.²⁹⁴

209. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së parashikon se, “në rrethana të jashtëzakonshme, pala ose pjesëmarrësi mund t'i paraqesë kërkesë panelit që të miratojë praninë e përfaqësuesit (përfaqësuesve) të

²⁹³ Mbrojtja e Krasniqit, para. 20-21.

²⁹⁴ Përgjigjja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave, para. 20; Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 979-980, 1043.

Zyrës Administrative".²⁹⁵ Për këtë arsye, nuk është e nevojshme që korniza e propozuar të ndryshohet më tej në këtë aspekt.

4 Efekti prapaveprues

210. ZPS-ja gjithashtu i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të specifikojë se korniza e propozuar vlen edhe për kontaktet me dëshmitarët në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së që Mbrojtja i ka iniciuar, të urdhërojë Mbrojtjen të raportojë se cilët dëshmitarë të ZPS-së ka kontaktuar dhe intervistuar para se të jepej urdhri për kornizën e propozuar, dhe të nxjerrë dokumentet dhe incizimet e disponueshme të këtyre kontakteve dhe intervistave.²⁹⁶

211. Sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ZPS-ja nuk identifikon bazën ligjore të kërkesës së saj për zbatimin në mënyrë prapavepruese të kornizës së propozuar. Gjithashtu, ndonëse mban parasysh se rreziqet me të cilat përballen dëshmitarët (e mundshëm) janë diskutuar që në fazat fillestare të procesit aktual, ZPS-ja nuk ka evidentuar arsye specifike lidhur me ndonjë kontakt të deritanishëm të Mbrojtjes me dëshmitarët, të cilat do të përlligjinin zbatimin me fuqi prapavepruese të kornizës së propozuar. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e hedh poshtë kërkesën e ZPS-së.

C. PËRFUNDIM

212. Bazuar në sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton kërkesën e ZPS-së për miratimin e kornizës së propozuar, me modifikimet e diskutuara në pjesët e mësipërme dhe modifikime shtesë që mund të rrjedhin prej tyre, të cilat janë të nevojshme për hir të saktësisë. Rrjedhimisht, palët dhe pjesëmarrësit duhet të zbatojnë **Kornizën për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve**

²⁹⁵ Përgjigjja e Mëtejshme e ZPS-së, para. 5(a).

²⁹⁶ Transkripti i 22 shkurtit 2022, f. 970-971.

dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi me Dëshmitarët e Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar (“Korniza”) që paraqitet në vijim, lidhur me veprimtaritë hetimore dhe kontakte aktuale dhe në të ardhmen me dëshmitarët.

I. Trajtimi i informacionit konfidencial gjatë hetimeve

- a. Palët dhe pjesëmarrësit kanë detyrimin e përgjithshëm të mos u nxjerrin palëve të treta²⁹⁷ dokumente apo informacione konfidenciale.²⁹⁸ Kjo Kornizë përcakton kushtet dhe procedurat në të cilat, në rrethana të veçanta, është e lejueshme që pala ose pjesëmarrësi të nxjerrë dokumente apo informacion konfidencial për palë të treta në kuadër të veprimtarisë hetimore.
- b. Gjatë gjithë hetimeve dhe procesit gjyqësor, palët dhe pjesëmarrësit zotohen të minimizojnë në shkallën më të madhe të mundshme rrezikun e zbulimit të dokumenteve apo informacioneve konfidenciale.
- c. Pala ose pjesëmarrësi mund t’i zbulojë një pale të tretë dokumentet apo informacionet konfidenciale që i janë vënë në dispozicion vetëm nëse nxjerrja e tyre është drejtpërdrejt dhe posaçërisht e domosdoshme për përgatitjen dhe paraqitjen e provave të veta. Pala ose pjesëmarrësi u nxjerr palëve të treta vetëm ato pjesë të një dokumenti konfidencial nxjerrja e të cilave është drejtpërdrejt dhe posaçërisht e domosdoshme për përgatitjen dhe paraqitjen e provave të veta.
- d. Kur një dokument konfidencial apo informacion konfidencial i nxirret një pale të tretë sipas paragrafit të mësipërm, pala ose pjesëmarrësi i shpjegojnë palës së tretë natyrën konfidenciale të dokumentit apo informacionit dhe e paralajmërojnë palën e tretë se dokumenti apo informacioni nuk duhet riprodhuar dhe nuk duhet t’i nxirret ndokujt tjetër, në tërësi apo pjesërisht. Përveç nëse autorizohet konkretisht nga paneli, pala e tretë nuk mban kopje të dokumentit konfidencial që i është treguar.

²⁹⁷ ‘Palë e tretë’ përfshin çdo person që nuk është palë apo pjesëmarrës në këtë proces, apo një gjykatës apo punonjës të Gjykatës që është i autorizuar të ketë qasje në informacionin në fjalë.

²⁹⁸ ‘Dokument konfidencial’ është çdo dokument i klasifikuar si ‘konfidencial’ apo ‘rreptësisht konfidencial’ sipas rregullës 82(1) të Rregullores. ‘Informacion konfidencial’ do të thotë çdo informacion që përmbahet në një dokument konfidencial, i cili nuk është bërë publik në mënyrë legjitime si dhe çdo informacion për të cilin paneli ka urdhëruar të mos u nxirret palëve të treta.

- e. Pala ose pjesëmarrësi mund të nxjerrë identitetin e një dëshmitari²⁹⁹ për një palë të tretë vetëm kur kjo nxjerrje është drejtpërdrejt dhe posaçërisht e domosdoshme për përgatitjen dhe paraqitjen e provave të veta. Në qoftë se ka dijeni se një dëshmitar është zhvendosur me banim me ndihmën e DHSK/ZPS-së, pala ose pjesëmarrësi informon paraprakisht Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (“ZMMD”) për të dhënat e vendit, kohës dhe, aq sa është e mundshme, për llojet e organizatave, institucioneve dhe, nëse janë të disponueshme, për të dhënat e personit ose personave të cilit ose të cilëve synon t’u nxjerrë identitetin e dëshmitarit, si dhe konsultohet me ZMMD-në për masat konkrete që mund të jenë të nevojshme. Nëse dëshmitari është i mbrojtur nga ZMMD-ja, pala ose pjesëmarrësi e informon ZMMD-në për nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit sa më shpejt që është e mundshme, por gjithsesi, përpara se të bëhet nxjerrja.
- f. Pavarësisht nga nënparagrafi i mësipërm, palët dhe pjesëmarrësit nuk u zbulojnë palëve të treta përfshirjen e një dëshmitari të mbrojtur në veprimtarinë e DHSK-së/ZPS-së, apo llojin e përfshirjes.
- g. Materiali pamor dhe/ose pa tekst që përshkruan apo ndryshe identifikon dëshmitarët i tregohet palës së tretë vetëm kur nuk ka asnjë mundësi tjetër hetimore alternative të përshtatshme. Për të zvogëluar rrezikun e zbulimit të përfshirjes në veprimtarinë e DHSK/ZPS-së të personit të treguar ose pasqyruar në të, pala ose pjesëmarrësi përdor vetëm material pamor dhe/ose pa tekst që nuk përmban elemente që mund të zbulojnë përfshirjen e personit të përshkruar në veprimtarinë e DHSK/ZPS-së. Kur përdoret fotografia e dëshmitarit, ajo tregohet vetëm bashkë me fotografi të tjera të të njëjtit lloj. Përveç nëse autorizohet posaçërisht nga Dhoma, pala e tretë nuk mban kopje të materialit pamor në kuadër të kësaj dispozite.
- h. Në qoftë nuk është e sigurt nëse një veprimtari hetimore e propozuar mund të çojë në nxjerrjen e identitetit të një dëshmitari të mbrojtur për palë të treta, pala ose pjesëmarrësi kërkon këshillën e ZMMD-së.
- i. Pala ose pjesëmarrësi sjell në vëmendje të ZMMD-së sa më shpejt që të jetë e mundur çdo dyshim të arsyeshëm se një dëshmitar i mbrojtur mund të jetë i rrezikuar për çfarëdo arsye, përfshirë dyshimin e arsyeshëm se angazhimi i një dëshmitari me DHSK/ZPS-në apo vendndodhja e mbrojtur e tij u janë bërë të njohura palëve të treta.
- j. Në qoftë se ka nxjerrë gabimisht informacion konfidencial ose ka marrë dijeni për ndonjë shkelje tjetër të konfidencialitetit të dokumenteve apo informacionit, apo në qoftë se zbulon se një palë e tretë është në dijeni të informacionit konfidencial, pala ose pjesëmarrësi informon marrësin për natyrën konfidenciale të

²⁹⁹ ‘Dëshmitar’ është personi të cilin pala ose pjesëmarrësi synon ta thërrisë për të dëshmuar apo deklaratën e të cilit pala ose pjesëmarrësi synon ta përdorë, për sa kohë që synimi i palës ose pjesëmarrësit i është bërë i njohur palës ose pjesëmarrësit kundërshtar.

informacionit dhe e udhëzon të mos e nxjerrë më tej atë. Gjithashtu, pala ose pjesëmarrësi informon menjëherë ZMMD-në.

II. Kontaktet midis një pale ose pjesëmarrësi me dëshmitarët e palës ose pjesëmarrësit kundërshtar

- a. Përveç sipas kushteve të përcaktuara këtu, palët dhe pjesëmarrësit³⁰⁰ nuk kontaktojnë apo intervistojnë dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësit tjetër para dhënies së dëshmisë, në qoftë se palës ose pjesëmarrësit kundërshtar i është njoftuar synimi për ta thirrur dëshmitarin për të dhënë dëshmi ose për t'u mbështetur në deklaratën e tij.
- b. Në qoftë se dëshiron të intervistojë një dëshmitar të palës apo të pjesëmarrësit tjetër, pala ose pjesëmarrësi kundërshtar informon palën thirrëse dhe Njësinë e Administrimit të Gjykatës ("NJAGJ") dhe, në rastin e dëshmitarëve me status të dyfishtë, Mbrojtësin e Viktimave, të paktën dhjetë ditë para intervistës së synuar. Pala thirrëse verifikon me ndershmëri nëse dëshmitari jep pëlqimin të intervistohet nga pala kundërshtare dhe gjithashtu informon dëshmitarin për mundësinë e pranisë në intervistë të përfaqësuesit të palës thirrëse, përfaqësuesit ligjor të dëshmitarit, Mbrojtësit të Viktimave në rastin e dëshmitarëve me status të dyfishtë, dhe/ose të përfaqësuesit të ZMMD-së. Në rrethana të veçanta, pasi të jetë këshilluar mjaftueshëm paraprakisht me Zyrën Administrative, pala ose pjesëmarrësi mund t'i drejtohet panelit që të kërkojë edhe praninë e një përfaqësuesi të Zyrës Administrative. Pala thirrëse informon palën kundërshtare nëse dëshmitari jep pëlqimin. Gjithashtu, në rast se beson se siguria e dëshmitarit mund të jetë të rrezikuar, ose për arsye të tjera legjitime, pala thirrëse mund t'i kërkojë panelit ta lejojë të jetë e pranishme në takimet mes palës kundërshtare dhe dëshmitarit, pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit. Kur pala thirrëse parashtron para panelit apo i vë në dukje palës kundërshtare se do ta bëjë këtë, pala kundërshtare nuk e interviston dëshmitarin para lëshimit të vendimit nga paneli. Procedura e kësaj pjese nuk zbatohet për intervistat e kryera nga ZPS-ja me dëshmitarë të palës kundërshtare që lidhen me çështje të tjera gjyqësore, përveçse kur ZPS-ja planifikon që në ato intervista të bëjë pyetje që kanë lidhje me akuzat në këtë çështje gjyqësore.
- c. Nëse pala ose pjesëmarrësi kontakton dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësit kundërshtar në mënyrë të paqëllimshme apo gjatë takimeve të kortezisë të organizuara prej ZMMD-së, ajo nuk bën asnjë

³⁰⁰ Për qëllimin e këtij paragrafi, kjo përfshin mbrojtësit, klientët dhe ekipet e tyre, sikurse përcaktohet në nenin 2 të Kodit të Etikës, por nuk zbatohet për kontaktet ndërmjet ekipit të Mbrojtësit të Viktimave dhe dëshmitarëve me status të dyfishtë.

diskutim mbi çështjen gjyqësore dhe në asnjë rrethanë nuk kërkon pëlqimin e dëshmitarit për t'u intervistuar drejtpërdrejt. Marrja e pëlqimit të dëshmitarit për t'u intervistuar mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurës së përcaktuar në nënparagrafin e mësipërm.

- d. Pala kundërshtare që kryen intervistën ("pala intervistuese"):
 - i. siguron që intervista të kryhet në mënyrë efektive dhe të shpejtë;
 - ii. përgatit kopje të të gjitha dokumenteve që do t'i tregohen dëshmitarit në një gjuhë që dëshmitari e kupton, së bashku me përkthimin në anglishte, që duhet t'i jepet palës thirrëse;
 - iii. nuk bisedon me dëshmitarin jashtë kuadrit kohor të intervistës dhe të incizimit me video, në mënyrë që të incizohen të gjitha deklaratat dhe çdo gjë që thuhet;
 - iv. nuk ndërmerr asnjë veprim që mund të konsiderohet kërcënues apo provokues; dhe
 - v. respekton urdhrat e lëshuar nga paneli.
- e. Pala intervistuese mundëson përgatitjen dhe kryerjen e intervistave sipas kësaj pjese. Komunikimet midis palës thirrëse dhe palës intervistuese protokollohen si korrespondencë në dosjen e çështjes, në përputhje me Udhëzuesin e Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (DHSK-BD-15). Pala thirrëse përballon shpenzimet që lidhen me praninë e saj në intervistë. Në konsultim me palët dhe/ose pjesëmarrësit, Zyra Administrative mundëson përgatitjen e procesit bazuar në informacionin e dhënë sipas paragrafëve (e)-(g) të pjesës II të Kornizës dhe në qoftë se kjo është e realizueshme. Gjithashtu, sikurse përcaktohet në paragrafin (h) të pjesës II të Kornizës, kur ZMMD-ja e gjykon të nevojshme, Zyra Administrative siguron që një përfaqësues ZMMD-së të jetë i pranishëm në vendin ku do të kryhet intervista ose ndryshe i disponueshëm.
- f. Pasi dëshmitari ka dhënë pëlqimin të intervistohet, pala thirrëse, në konsultim me ZMMD-në, sipas rastit, i jep palës intervistuese informacionin e mëposhtëm:
 - i. datat e preferuara për intervistën dhe kohëzgjatjen e parashikuar të saj;
 - ii. nëse në lidhje me dëshmitarin janë urdhëruar, kërkuar apo do të kërkohen masa mbrojtëse në bazë të rregullës 80 dhe nëse dëshmitari ka nevoja të veçanta sipas përcaktimeve në rregullën 146, ose për të kërkohen masa të posaçme, të renditura në rregullën 80(4)(c);
 - iii. formularin e përditësuar të informacionit mbi dëshmitarin;
 - iv. gjuhën që dëshmitari pritet të përdorë gjatë intervistës;

- v. informacion lidhur me personat që pritet të jenë të pranishëm në intervistë, si edhe informacion nëse për dëshmitarin mund të nevojitet prania e një përfaqësuesi të palës thirrëse, një përfaqësuesi të ZMMD-së, Zyrës Administrative, Mbrojtësit të Viktimave apo e një përfaqësuesi ligjor; dhe
- vi. çfarëdo informacioni tjetër që mund të ndihmojë përgatitjen e intervistës, që kërkohet nga NJAGJ-ja apo ZMMD-ja.
- g. Pala intervistuese mund të kërkojë informacion shtesë, nëse nevojitet për mundësimin e përgatitjes së intervistës. Paneli vendos në lidhje me çdo mosmarrëveshje të pazgjidhur midis palëve, pjesëmarrësve dhe/ose ZMMD-së/NJAGJ-së, në lidhje me masat e rekomanduara nga palët, pjesëmarrësit dhe/ose nga ZMMD-ja/NJAGJ-ja.
- h. Pala intervistuese mundëson kryerjen e procesit nëpërmjet:
 - i. ofrimit të vendit për kryerjen e intervistës dhe të pajisjeve për incizimin me audio dhe video;
 - ii. ofrimit të përkthimit, kur nevojitet.

Gjithashtu, sipas rastit, Zyra Administrative siguron që gjatë intervistës të jetë i pranishëm një sekretar i gjykatës apo një përfaqësues tjetër i caktuar i Zyrës Administrative dhe që në vendin ku do të kryhet intervista të jetë i pranishëm një përfaqësues për mbështetjen e dëshmitarit, në rastet kur ZMMD-ja e gjykon të nevojshme.
- i. Para fillimit të intervistës, pala intervistuese e informon dëshmitarin se:
 - i. nuk e ka të detyrueshme pjesëmarrjen në intervistë dhe se mund të vendosë ta ndërpresë intervistën në çdo moment;
 - ii. mund të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve, veçanërisht nëse mendohet se mund të jenë vetinkriminuese;
 - iii. mund të kërkojë pushim në çdo moment; dhe
 - iv. mund të kërkojë takim me një përfaqësues të ZMMD-së në çdo moment gjatë intervistës.
- j. Gjatë intervistës, pala intervistuese:
 - i. siguron që janë të pranishëm vetëm personat e autorizuar;
 - ii. verifikon identitetin e dëshmitarit;
 - iii. siguron që të gjithë personat e pranishëm të prezantohen për incizimin;
 - iv. siguron që intervista të incizohet me audio dhe video;
 - v. garanton sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarit; dhe

- vi. siguron që elementët proceduralë të intervistës të kryhen në përputhje me Ligjin, Rregulloren dhe çdo urdhër, vendim konstatim apo rekomandim vijues të panelit.
- k. Nëse ka kundërshtim për ndonjë pjesë të procedurës së ndjekur apo për linjë apo mënyrë të caktuar të marrjes në pyetje gjatë intervistës, pala thirrëse e ngre këtë problem me palën intervistuese, jo në prani të dëshmitarit. Çdo mosmarrëveshje evidentohet në dokumentacion dhe nuk pengon apo ndërpret në mënyrë të papërligjur intervistën. Në raste të jashtëzakonshme, pala thirrëse mund t'i paraqesë kërkesë panelit që intervistës t'i jepet fund për shkak të shkeljeve flagrante të kësaj Kornize, në qoftë se palët nuk arrijnë marrëveshje në pajtim me procedurën pararendëse.
- l. Nëse në intervistë është i pranishëm përfaqësuesi i Zyrës Administrative në pajtim me këtë pjesë të Kornizës, palët respektojnë asnjësinë e Zyrës Administrative dhe nuk i kërkojnë përfaqësuesit të saj të përfshihet në procedurë. Nëse dëshmitari do të ketë nevojë të këshillohet me një përfaqësues ligjor gjatë intervistës, intervista pezullohet për ta mundësuar këtë. Zyra Administrative informon Zyrën e Mbrojtjes me qëllim që të merren të gjitha masat e nevojshme për t'i caktuar dëshmitarit mbrojtës.
- m. Nëse pala intervistuese synon t'i tregojë dëshmitarit dokumente konfidenciale apo rreptësisht konfidenciale, me përjashtim të deklaratave të vetë dëshmitarit, ajo vepron, *mutatis mutandis*, në përputhje me paragrafët (c) dhe (d) të pjesës I të kësaj Kornize.
- n. Pas përfundimit të intervistës, pala intervistuese përgatit:
 - i. një memorandum mbi procesin (ku të shënohet koha, vendi, personat e pranishëm, klasifikimi – d.m.th., publik, konfidencial, ose rreptësisht konfidencial – dhe çdo rrethanë tjetër relevante), të cilin ua dorëzon palëve dhe panelit; dhe
 - ii. incizimin me audio dhe video të intervistës, kopje të të cilit ua dorëzon palëve dhe panelit.
- o. As incizimi i intervistës, as materialet e përdorura gjatë intervistës nuk bëhen pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore, përveç nëse paneli i pranon si prova *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, kur përmbushen kushtet për pranimin e tyre sipas Rregullores. Kur bëhet kërkesë për pranimin si provë të incizimit me video, pala intervistuese dorëzon edhe transkriptin e intervistës.

V. VENDIM

213. Për arsyet e lart përmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **RRËZON** kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për heqjen nga dokumentacioni i çështjes gjyqësore të Përgjigjes së Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave dhe **VENDOS** të shqyrtojë vetëm ato parashtrime në Përgjigjen e Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave që ai i paraqiti ose me të cilat u pajtua konkretisht gjatë seancës së 22 shkurtit 2022;
- b) **VENDOS** të shqyrtojë vetëm ato parashtrime në Kundërpërgjigjen e Thaçit ndaj ZPS-së të cilat Mbrojtja e Thaçit i paraqiti ose me të cilat ajo u pajtua konkretisht gjatë seancës së 22 shkurtit 2022;
- c) **VENDOS** të mos shqyrtojë Parashtrimet Plotësuese të Thaçit, si edhe Përgjigjen e ZPS-së ndaj Parashtrimeve Shtesë të Thaçit dhe Kundërpërgjigjen e Thaçit ndaj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me Parashtrimet Plotësuese të Thaçit, sa u takon aspekteve që kanë të bëjnë me themelësinë e aspektit nën shqyrtim;
- d) **RRËZON** kërkesat e Mbrojtjes së Krasniqit dhe të Mbrojtjes së Veselit që palët të udhëzohen të angazhohen në diskutime *inter partes*;
- e) **MIRATON** Kërkesën e ZPS-së për miratimin e kornizës së propozuar, me modifikimet e përshkruara në këtë vendim;
- f) **MIRATON** Kornizën dhe **URDHËRON** palët dhe pjesëmarrësit të respektojnë kornizën e përcaktuar në këtë vendim në lidhje me të gjitha

veprimtaritë hetimore dhe kontaktet aktuale dhe të ardhshme me dëshmitarët; dhe

- g) **RRËZON** Kërkesën e ZPS-së për urdhërimin e zbatimit me fuqi prapavepruese të kornizës.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 24 qershor 2022

Në Hagë, Holandë.